Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (130). SHKURT 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Si më infiltruan komunistët në Konferencën e Zall Herrit

Dëshmon **Ibrahim Kika**


8

Mes veprash të mëdha dhe kolegësh të talentuar

Intervistë me ing. **Shaban Bitri**


21

Shemsi Manjani - njeriu universal i sportit

Nga **Defrim Methasani**


12

NË BRENDËSI: ■ **Koha për bio** ■ **Jalla Iema**... "Lungo Arbrin" ■ **Dita e Verës** ■ **Vlesha**, fshati i njerëzve të mirë dhe punëtorë ■ **Ida Nurçe:** Me punë mund të arrish ku të duash ■ **Erduan Kllobuçishta:** zbuloni pasionin dhe bëni ndryshimin! ■ **Shpërthimi** i gazit në minierë, tre minatorët kinezë gjenden pa jetë ■ **Letër** nga nëntoka ■ **Për vajzat** dibrane dhe jo vetëm! ■ **Dritëro Agolli** dhe "Njeriu me top" i Luznisë ■ **Hamdi Kacani** dhe ambulanca ■ **SPECIALE:** ■ Arsimi në Dibër, nga mësimi i shkronjave shqip, te përdorimi i teknologjisë ■ **Kontributi** i hoxhallarëve në arsimin shqip ■ **Dibër e Madhe,** dashuria për atdheun kalon nga Gjuha shqipe ■ **Tre nga misionarët** e arsimit në Maqellarë ■ **Jahja Domnori**, mësuesi i Allajbegisë ■ **Vahid Kormaku** - mësues e veprimtar shoqëror ■ **Hamit Hodo**, profesori i Bujqësores së Peshkopisë... ■ **Vasfi Cibaku**, mësuesi i përkushtuar i Sohodollit ■ **Nga shkrimi** mbi gur tek universitarët ■ **Dosja** "Gjarpri" ■ **Koha** e triskave ■ Ndahet nga jeta biznesmeni **Preng Llesh Doçi** ■ Iku **Mentori** i Zeralinjëve

Fizibiliteti *i Rrugës së Arbrit* **janë njerëzit,** *jo makinat*

Pasuritë nëntokësore e mbitokësore të rajonit të Dibrës, zhvillimi i biznesit, bujqësisë e frutikulturës bio, ujërat, turizmi, malet, pyjet, komunikimi dhe lidhja e njerëzve nga Shkupi në Tiranë janë fizibiliteti i kësaj rruge, nuk janë makinat që hyjnë në Kukës dhe Qafë Thanë.

Kur flasim për fizibilitetin e Rrugës së Arbrit, specialistët nuk marrin parasysh disa nga faktet e mëposhtme:

- Rruga e Arbrit do të lidhte kryeqytetin, portin dhe aeroportin me një nga minierat më të mëdha dhe më të rëndësishme në vend: minierën e Bulqizës, e cila mendohet se ka së paku edhe 300 milionë ton rezerva kromi;

- Rruga e Arbrit do të ofronte investime të shpejta në gjipse, mermere dhe pasuri të tjera nëntokësore e mbitokësore në rajon;

- Pasuritë ujore do të bëheshin të shfrytëzueshme nga industria e përpunimit të ujërave natyralë;

- Turizmi malor dhe ai dimëror do të shihnin një zhvillim të menjëhershëm. Bora dhe mali do të jenë larg Tiranës vetëm 1 orë larg;

- Bujqësia dhe frutikultura, e orientuar nga prodhimi bio, do të shihte zhvillim të menjëhershëm, duke u bërë një garantues i furnizimit të popullatës me ushqime të shëndetshme dhe me çmime shumë të lira;

Dhe mbi të gjitha, fizibiliteti i Rrugës së Arbrit do të ishte në lidhjen e drejtpërdrejtë të 400 mijë shqiptarëve në Maqedoninë perëndimore me Shqipërinë, si dhe do të ofrojë dalje në lindje në mënyrë të drejtpërdrejtë për 1 milion të tjerë që jetojnë në Tiranë. Do të rrisë trafikun, komunikimin, do hapë hapësira për investime, duke sjellë një zhvillim të dukshëm që në vitin e parë të hapjes së këtij aksi rrugor.

FAQE 2-3



Në foto: Një skicë e e tre akseve që lidhin Tiranën me Shkupin. *(Burimi: revista Monitor)*

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 2 (130). Shkurt 2017

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA

Kontribuan për këtë numër:
Sidorela SHEHU
Klodiana KAPO
Samet ZAGRADI
Arsim KOLARI
Defrim METHASANI
Gafur ZOTA
Zabit LLESHI
Demir OSMANI
Roland MUKA
Selman MËZIU
Mevlud BUCI
Orhan SAKIQI
Bashkim LLESHI

Fotoreporter: Fehmi LLESHI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

FEJTON

JALLA LEMA... “LUNGO ARBRIN”

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Më në fund “Rruga e Arbrit”, aq e lakuar, aq e dëshiruar, nga kjo anë e ajo anë e kufirit shqiptaro-shqiptar; nga tiranasit, matjanët, dibranët këtej e dibranë andej, tetovarët, gostivarasit... doli e para.

Më në fund fleta u përmbys dhe rruga doli në krye të listës...

U tha me gojë të plotë në “Një biliard” dhe u shpërnda në efir nga toka në qiell e nga qielli në tokë, në valë satelitore e tokësore.

Gazeta “Rruga e Arbërit” që ka njëmbëdhjetë vjet që thërret e bërtet, që argumenton se ajo duhet të ishte prioritet i shumë viteve më parë, që ka përcjellë fotografi “prerje shiritash” e fjalime me “rrahje gjoksi” që në fushatën zgjedhore të vitit 2005 (Fatos Nano) e me radhë Berisha në tetë vjet e Rama në tre vjet, në momentin kur do të kalonte në printim ndryshoi faqen e parë...

Titull, mbi titull, nëntitull...

Para zgjedhjeve nisin punimet...

Rruga e Arbrit përfshihet në programin “Një miliardë për ndërtim”...

Kryeministri Edi Rama: Rruga e Arbrit është në procedurë. Është projekti i parë që do të realizohet me Programin “Një miliardë të rindërtimit” dhe kam shumë besim që, në se nuk do të tradhtojnë procedurat, shumë shpejt do të fillojë puna edhe për Rrugën e Arbrit...

Kishte deklaruar se nuk do ta linte karrigen e kryeministrit pa ndërtuar “Rrugën e Arbrit”.

Kishte deklaruar... por “në se nuk do të tradhtojnë procedurat”, hallva dibrane ftohet e lugët mbeten futur në brez.

Kishte deklaruar...por “në se nuk do të tradhtojnë zgjedhësit”... ikën karrigeje, ikën edhe “Rruga e Arbrit”.

Gazeta me emrin e rrugës historike të Dibrës, e tej e tej deri në ultësirat e Detit të Zi, do ti mbushë faqet e saj me dhimbjen e dibranëve për rrugën e tyre që në shekuj e shekuj “rrugë pedonale” mbeti.

Pas pedonaleve...“Lungo Mare”. “Lungo Fiume”, rruga më e gjatë “pedonale” shqiptare është “Rruga e Dibrës”, “Lungo Dibra”, e pa kurorëzuar zyrtarisht në tubime...

“Rruga e Arbrit” ka dalë në krye të listës: ”është projekti i parë që do të realizohet me Programin “Një miliardë të rindërtimit”...

Jemi mësuar të ngopemi me fjalë...

Deri në grykë sa nuk marrim dot frymë...

Ruajna Zotmos përmbyset fleta dhe “Rruga e Arbrit” përfundon jo në fund por “prapa listës”, siç ka qenë në gjithë këto vite.

I vetmi urim është “Ruaje Zot Edi Ramën mos bie nga karrigeje”.

Të paktën kemi “kashtë në lumë” ku të kapemi.

Se deri tani pas kashtërash jemi kapur e na kanë zhyt e mbyt...

Një ish ministër projektin “Një miliardë të rindërtimit” e quajti”: “PASTRIM PARASH!”

Ish ministri me mbiemër Dibre, ve kështu “gurin e parë” nën rrotat e “Rrugës së Arbrit”. E gjeti ditën të flasë kur kaq vite në politikë, kaq vite deputet, e kaq kohë ministër i Ministrisë së Drejtësisë, askush nuk e ka dëgjuar të shqiptojë një herë të vetme dyfjalë-shin “Rruga e Arbrit”.

Dibranët tundin kokën e thonë: “Jalla lema”...

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com



Pasuritë nëntokësore e mbitokësore të rajonit të Dibrës, zhvillimi i biznesit, bujqësisë e frutikulturës bio, ujërat, turizmi, malet, pyjet, komunikimi dhe lidhja e njerëzve nga Shkupi në Tiranë janë fizibiliteti i kësaj rruge, nuk janë makinat që hyjnë në Kukës dhe Qafë Thanë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

“DILEMAT E RRUGËS SË ARBRIT” është një shkrim i botuar në revistën “Monitor” në numrin e botuar javën e parë të shkurtit (799), në të cilën dy protagonistë të projektimit e ndërtimit të rrugëve në Shqipëri japin opinionin e tyre në lidhje me leverdishmërinë e ndërtimit të këtij aksi rrugor.

Njëri prej tyre, ing. Faruk Kaba, i cili ka projektuar disa nga segmentet kryesore të saj, drejtues i grupit të studimit të fizibilitetit në vitin 2004, pranon se “Rruga e Arbrit nuk ka vlera ekonomike, por ndërtimi i saj duhet bërë si shpërblim për shqiptarët në Maqedoni dhe banorët që jetojnë në këto zona”.

Kaba thotë më poshtë në intervistën e “Monitor” se “në vitin 2008, ai i u thirr që të bënte një projekt të ri për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Kosto fillestare që ai nxori në ato vite ishte 150 milionë euro, por pranon që norma e kthimit të fitimit për ekonominë dilte e ulët dhe e bënte rrugën ekonomikisht të padobishme.

Megjithatë, Kaba sqaron për revistën ekonomike “Monitor” se e modifikoi projektin, duke menduar se fluksi i rrugës do të ishte në rritje dhe uli po ashtu edhe vlerën e investimit. “Fluksi mesatar i mjeteve që kalojnë në ditë në këtë rrugë është 1800 deri në 1900 makina, e që kjo rrugë të jetë rentabël, duhet të jetë 3400 makina”, ka theksuar ai për “Monitor”.

Kaba thekson në intervistë se nuk e ka parë ofertën e “Gjoka Konstruksion”, e cila po negociohet aktualisht, ndërsa shprehet se “projekti i kompanisë kineze i dukej cilësor, duke pasur parasysh edhe standardin që vetë këto firma kanë në kompanitë e tyre”.

“Monitor” shkon më tej duke theksuar se oferta e “Gjoka Konstruksion” nuk ka shumë ndryshime nga oferta e kompanisë kineze.

“Gjoka Konstruksion” ka propozuar që të bëjë përfundimin e rrugës për 190 milionë euro ose 203 milion dollarë. Oferta është afërsisht e njëjtë me atë të kompanisë kineze”, shkruan “Monitor”.

“Askush nuk e ka sqaruar ofertën që ka bërë kompania kineze e po ashtu të jepte një vlerë se sa ofroi ajo për ndërtimin e kësaj rruge, - thekson revista që botohet në Tiranë. “Mungesa e transparencës në këtë proces ka qenë e madhe. Por pas hapjes së fushatës së zgjedhjeve në Dibër, përdorimi politik i rrugës zbuloi dhe detaje për rifillimin e punimeve për të”.

“Monitor” ka arritur të sigurojë ofertën që ka bërë kompania “China State Construction”. Sipas saj, oferta për të përfunduar “Rrugën e Arbrit”, e cila përfshinte ndërtimin e dy urave dhe një tuneli nga ana e palës kineze është 215 milionë dollarë.

“Monitor” shkruan se “kompania kineze sjell dhe shqetësimet teknike që ka për ndërtimin e rrugës”, por në këtë citim të sjellë nga revista përmenden Mali Dinara (?!) dhe Jezerca! E para nuk dihet për kë e kanë pasur fjalën kinezët, ndërsa Jezerca nuk ka lidhje me aksin e rrugës së Arbrit.

Një inxhinier tjetër i intervistuar nga “Monitor”, Arben Meçe, thotë se “Rruga e Arbrit nuk duhet të jetë prioritare, pasi nuk sjell leverdi ekonomike, ndërsa mekanizmin e financimit të saj e quan si një borxh që do të rëndojë mbi qeverinë.

Për leverdishmërinë e ndërtimit të kësaj rruge, gazeta jonë ka mbi 11 vite që boton shkrime, artikuj, intervista nga intelektualë e specialistë, mbi nevojën e ndërtimit të saj sa më parë.

Fizibiliteti *i Rrugës së Arbrit* **janë njerëzit,** *jo makinat*

Duke folur për fizibilitetin e Rrugës së Arbrit, Meçe, pranon se "ne sot nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për të bërë këtë gjykim", por nga ana tjetër del në konkluzionin se "që kjo rrugë nuk është fizibile". Ai e konsideron rrugën një "rrugë politike më tepër se një rrugë komerciale".

Qeveria shqiptare deri më tani, përveç premtimit se ky segment rrugor do të finalizohet, nuk ka bërë asnjë transparencë për mënyrën e financimit të saj. Ajo nuk ka shpjeguar as arsyen se pse shoqëria ndërtuese kineze u tërhoq nga ndërtimi, as propozime të tjera të ardhura nga biznesi vendas, mes të cilëve edhe varianti i ndërtimi i saj pa tunel, me një vlerë prej 75 milionë euro, propozuar nga ing. Faruk Kaba

2003-2016, NDRYSHIM PROJEKTESH E STRATEGJISH

Rruga e Arbrit nuk është një rrugë që njerëzit e shohin në ëndërr. Është një aset i munguar i këtij vendi, i cili, çuditërisht, sa herë vjen puna për finalizimin e procesit, gjetjen e financimit dhe nisjen e punimeve, në media dalin shkrime nga inxhinierë dhe specialistë, të cilët e venë në dyshim leverdishmërinë ekonomike të saj. Dhe këta inxhinierë specialistë nuk sjellin asnjë fakt, por bazohen mbi atë që mendojnë, mbi atë që kanë bërë në të kaluarën apo mbi fatin që do të kenë rrugët e ndërtuara më parë.

Me iniciativë të shoqërisë civile (Shoqata *Nisma Dibrane*), Rruga e Arbrit u përfshi në planet strategjike të rrugëve të qeverisë shqiptare në vitin 1995. Për shkak të trazirave të vitit '97, ky proces u pezullua dhe në vitin 2003, me vendim të qeverisë së kohës, u çel fondi për studimin e fizibilitetit, e cila u krye nga firma *Infrastransprojekt*, me drejtues ing. Faruk Kaba. Më 25 korrik 2004, ky studim i miratua në Këshillin Kombëtar të Rrugëve.

Në vitin 2008 kjo rrugë ishte përfshirë në planin strategjik të rrugëve dhe përfundimi i saj në gjithë aksin parashikohej në vitin 2013. Segmenti i parë, Bulqizë – Bllatë – Ura e Cerenecit parashikohej të përfundonte në vitin 2009, Ura e Cerenecit Peshkopi në vitin 2011 dhe Bulqizë – Tiranë në vitin 2013...

Por ata që kanë hartuar nga zyrat e ngrohta të ministrive strategjitë e rrugëve në Shqipëri e kanë ndryshuar strategjinë sa herë u janë dashur nga interesat e ngushta politike e burokratike, aq sa tani përfundimi i saj parashikohet në vitet 2023...

Por për Rrugën e Arbrit nuk janë dashur vetëm ndryshim strategjish, por edhe ndryshim të projekteve, dorëzim projektesh e rikthim për rishikime, shkurtime, devijime, zgjatje rrugësh.

Në shtator 2009 Ministria e Transporteve ktheu për rishqyrtim projektet e Rrugës së Arbrit në segmentet Ura e Brarit - Ura e Vashës, duke urdhëruar që nga 9 metra gjerësia e rrugës të kthehej në 7 metra. Pas përhapjes së lajmit ministria e tërhoqi vendimin, por urdhëroi që të bëhej një projekt i ri, i cili do ta rriste gjerësinë e rrugës në 10,5 metra...

Ndërsa në fillim të vitit 2010, për shkurtimin e shpenzimeve u urdhërua një projekt i ri për tunelin e Qafë Murrizës nga 3.5 km, në 2.7 km, me arsyen e uljes së shpenzimeve.



SKEDA E RRUGËS SË ARBRIT

1. Segmenti Tiranë (qendër) – Ura e Brarit (Tiranë), 7.8 km, rrugë urbane ekzistuese. Në të ardhmen duhet bërë diçka për ta përshtatur, që të jetë e një standardi të pranueshëm.
2. Segmenti Ura e Brarit (Tiranë) – Hyrje Tuneli Qafë Murrizë, 19.3 km:
   2.1. Loti 1, me gjatësi 5 413 ml, në proces ndërtimi duke filluar nga Ura e Brarit në drejtim të Qafë Murrizës, por pa përfunduar plotësisht. Duhet kryer asfaltimi dhe pjesa tjetër (sinjalistikë, siguria rrugore etj.)
   2.2. Loti 2, i gjatë 5 789 ml pa prekur
   2.3. Loti 3, i gjatë 7 784 ml pa prekur
   Gjithsej pa prekur: 13 573 ml
3. Segmenti Hyrje e Tunelit Qafë Murrizë – Ura e Vashës, 13.1 (13+060) km
   Me vlerë rreth 144.9 milionë euro (sipas projekt zbatimit). Ka një tunel (Murrizës) me gjatësi 2 533 ml me një kosto rreth 88.7 milonë euro, pa prekur.
   Gjithsej pa prekur: 13 100 ml
4. Segmenti Ura e Vashës – Bulqizë, 13.2 (13+179) km
   4.1. Në gjatësi nga km 0+000 deri km 10+840 janë kryer punime, por rruga nuk është e përfunduar
   4.2. Segmenti nga km 10+840 deri në km 13+179 (gjatësi 2340 ml rruga është e pa prekur.
   Gjithsej pa prekur: 2 340 ml
5. Segmenti Bulqizë – Ura e Çernecit (3.7 km nga kufiri shtetëror), 16.93 km:
   5.1. Objekti ndërtim Rruga e Arbrit Loti 1, L=6.9km i ndërtuar
   5.2. Objekti ndërtim Rruga e Arbrit Loti 2, L=5.1km i ndërtuar
   5.3. Objekti ndërtim Rruga e Arbrit Loti 3, L=4.52km i ndërtuar
6. Segmenti Ura Çerenecit – Kufiri Shtetëror (Gjoricë), 3.7 km (pa projekt, pa prekur

(Burimi: Revista Monitor, nr. 766, 6 shkurt 2017)

Prej asaj kohe, qeveria shqiptare ka gjetur pretekste në projekt për ta penguar vazhdimin e këtij procesi, me argumentet se "ka probleme gjeologjike", "duhen shkurtuar shpenzimet", "nuk ka para", "nuk kemi financues", dhe plot argumente të tjera, si e si procesi të vonohej dhe punimet të mos niseshin.

Gjithë ky proces është shoqëruar me një mungesë transparence, e cila çon ujë vetëm në një burim: ka segmente në qeveritë shqiptare të këtyre 20 viteve që nuk e duan ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Unë besoj se ndërtimi i saj do të nxjerrë zbuluar gjithë strategjitë e deritanishme të infrastrukturës në vend. Dhe kjo hartë që shoqëron shkrimin e tregon këtë. Rruga e Arbrit shkurton distancën e Shkupit me Tiranë me 138 km në krahasim me rrugën aktuale nga Qafa e Thanës dhe 122 km nga rruga aktuale e kombit.

Ky fakt nuk ka nevojë për më shumë argumente për të kundërshtuar "mungesën e leverdishmërisë ekonomike" që thotë Kaba, apo "mungesën fizibilie" që mbron Meçe.

FIZIBILITETI I MUNGUAR

Çuditërisht, kur flasin për fizibilitet, specialistët dhe inxhinierët i referohen vetëm trafikut. Por nuk thonë se kujt trafik i referohen, pasi kjo rrugë nuk ekziston dhe në një rrugë që nuk ekziston, nuk ka si të ketë trafik.

Te trafiku bazohemi vetëm te një rrugë e cila funksionon dhe rritja e trafikut çon në nevojën e zgjerimit të rrugës. Inxhinierët dhe specialistët tanë kanë gabuar në parashikim

Standardet bashkëkohore të ndërtimit nuk janë respektuar deri më tani në segmentet e konsideruara të ndërtuara. Një rrugë pa standarde është një rrugë jofizibile. Dhe fizibiliteti i Rrugës së Arbrit janë njerëzit nga Tirana në Gostivar, jo makinat nga Kukësi në Qafë-Thanë.

e trafikut, p.sh. në Rrugën Plepa-Rrogozhinë, e cila akoma pa përfunduar pati një rritje të trafikut vetëm në dy vitet e para në 14 mijë mjete në ditë, ndërsa ishte parashikuar se ky trafik do të ishte 6900 mjete pas 20 vitesh... Dhe në qoftë se flasim vetëm për trafikun e makinave në akset hyrëse dhe dalëse që lidhin Dibrën me rajonet e tjera, shoqata *Nisma Dibrane* ka bërë studime në këtë drejtim dhe parashikoi që trafiku i makinave në aksin e ri të Rrugës së Arbrit do të trefishohet brenda vitit të parë. Studimin e plotë do ta botojmë në numrat e ardhshëm.

Çuditërisht, kur flasim për fizibilitetin e Rrugës së Arbrit, specialistët nuk marrin parasysh disa nga faktet e mëposhtme:

- Rruga e Arbrit do të lidhte kryeqytetin, portin dhe aeroportin me një nga minierat më të mëdha dhe më të rëndësishme në vend: minierën e Bulqizës, e cila, mendohet se ka së paku edhe 300 milionë ton rezerva kromi;
- Rruga e Arbrit do të ofronte investime të shpejta në gjipse, mermere dhe pasuri të tjera nëntokësore e mbitokësore në rajon;
- Pasuritë ujore do të bëheshin të shfrytëzueshme nga industria e përpunimit të ujërave natyralë;
- Turizmi malor dhe ai dimëror do të shihnin një zhvillim të menjëhershëm. Bora dhe mali do të jenë larg Tiranës vetëm 1 orë larg;
- Bujqësia dhe frutikultura, e orientuar nga prodhimi bio do të shihte zhvillim të menjëhershëm, duke u bërë një garantues i furnizimit të popullatës me ushqime të shëndetshme dhe me çmime shumë të lira;

Dhe mbi të gjitha, fizibiliteti i Rrugës së Arbrit do të ishte në lidhjen e drejtpërdrejtë të 400 mijë shqiptarëve në Maqedoninë perëndimore me Shqipërinë, si dhe do të ofrojë dalje në lindje në mënyrë të drejtpërdrejtë për 1 milion të tjerë që jetojnë në Tiranë. Do të rrisë trafikun, komunikimin, do hapë hapësira për investime, duke sjellë një zhvillim të dukshëm që në vitin e parë të hapjes së këtij aksi rrugor.

Për leverdishmërinë e ndërtimit të kësaj rruge, gazeta jonë ka mbi 11 vite që boton shkrime, artikuj, intervista nga intelektualë e specialistë, mbi nevojën e ndërtimit të saj sa më parë.

Kohët e fundit, ne kemi këmbëngulur në ndërtimin e saj duke respektuar standardet bashkëkohore të ndërtimit. Këto standarde nuk janë respektuar deri më tani në segmentet e konsideruara të ndërtuara, ndaj kërkojmë që kjo të respektohet në segmentin e mbetur prej 27 km. Sepse besojmë se një rrugë pa standarde është një rrugë jofizibile. Dhe fizibiliteti i Rrugës së Arbrit janë njerëzit nga Tirana në Gostivar, jo makinat nga Kukësi në Qafë-Thanë.

Rruga e Arbërit nr. 130

aktualitet

Në fillim të muajit shkurt, si pasojë e një shpërthimi të fuqishëm gazi hidrogjen dhe metan, u plagosën tre minatorë dhe tre të tjerë mbetën të bllokuar, në thellësitë e nëntokës.

Shpërthimi i gazit *në minierë,* **tre** *minatorët kinezë gjenden* **pa jetë**

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Fillimi i muajit shkurt të këtij viti, përkoi me një aksident të rëndë të ndodhur në Minierën e Bulqizës, ku si pasojë e një shpërthimi të fuqishëm gazi hidrogjen dhe metan, u plagosën tre minatorë dhe tre të tjerë mbetën të bllokuar, në thellësitë e nëntokës. Shpërthimi i gazit ndodhi rreth mesditës së të shtunës më 4 shkurt, ndërsa minatorët po punonin në nivelin 21- të pusit numër 9 i quajtur ndryshe si pusi i thellësisë së minierës. që zotërohet nga kompania konçensionare AlbChrome pjesë e BalfinGrup, e cila do mundësojë lidhjen e nivelit të 16-të me atë të 21-të.

Fillimi i punës për hapjen e pusit nr.9, të ashtuquajtur pusi i thellësisë, ishte një moment i rëndësishëm për vazhdimësinë e punës në Minierën e Kromit Bulqizë, pasi kjo hap perspektivën e mëtejshme të zhvillimit të kësaj miniere. Me përfundimin dhe vënien në punë të këtij pusi bëhet e mundur marrja e rezervave të rëndësishme të mineralit të kromit në thellësi të minierës, në sasi prej rreth 2.126.800 ton, me përmbajtje prej 43.5 % Cr2O3.

Pusi nr.9 ka një gjatësi prej 600 m, duke filluar nga niveli +420 m e përfunduar në nivelin -180 m. Hapja dhe montimi i makinerive e pajisjeve të pusit është marrë përsipër nga kompania kineze Wenzhou Mining Co Ltd, kompani e cila angazhojë për këtë qëllim një personel prej 70 punonjësish. Shpërthimi ndodhi në nivelin e 21-të, i fundit nivel i hapjes së thellësisë, që nisi nga niveli i 16-të nga ana e kompanisë kineze. Menjëherë pas sinjalizimit të aksidentit, që pati si shkak shpërthimin e gazit të hidrogjenit, grupet e gatshme të avarive në ambientet e minierës kanë ndërhyrë. Por gjithçka ka qenë tejet e vështirë për të hyrë në thellësi të galerisë për shkak të pranisë së lartë të gazit. Ndërkohë, nga Tirana u nisën edhe zv.ministri Gëzim Musabelli dhe grupet e Repartit të Inspektim-Shpëtimit të Minierave (RISHM), zi dhe zyrtarë të tjerë. Nga shpërthimit 3 minatorë shtetas kinezë, morën lëndime të lehta dhe u dërguan në spitalin e Bulqizës, jashtë rrezikut për jetën.

Grupet e posaçme të avaro-shpëtimit të minierës dhe ata të ardhura nga Tirana, nisën vazhdimin e kërkimeve edhe për 3 minatorët e tjerë edhe ata shtetas kinezë, të cilët mbetën të bllokuar në brendësi të minierës. Por tre shpërthimet e mesditës së të shtunës, shkaktuan dëmtime serioze edhe të strukturës së minierës, gjë që pengoi mjaft grupet e kërkim-shpëtimit, të mbërrijnë te thellësitë ku mbetën të bllokuar 3 minatorët kinezë.



Kompleksi minerar i Bulqizës është një nga burimet minerare më të rëndësishme të Shqipërisë dhe më gjerë, por kromi i nxjerrë këtu gjatë viteve 1980, kur qeveria e kohës e kishte këtë mineral si burimin kryesor të të ardhurave në valutë, ka bërë që miniera të degradojë dhe të kthehet në burim të vazhdueshëm aksidentesh duke i marrë jetën shumë minatorëve.

Kërkimet vijuan për ditë të tëra nga grupet e kërkim-shpëtimit, ku nëpërmjet kompresorëve injektohej ajri nga sipërfaqja në nivelet e galerisë për pastrimin e tyre nga niveli i lartë i pranisë së gazit. Por, për të shkuar në nivelin e 21-të, rreth 1000 metra thellësi, ku dhe kishin mbetur të bllokuar 3 minatorët kinezë, u deshën plot 6 ditë, gjë e cila veniti dukshëm shpresat e pakta për gjetjen gjallë të tyre. Dhe fatkeqësisht kështu ndodhi, kur trupa operacionale e RISHM-it, mundi të nxjerrë nga rreth 1000 metra thellësi trupat e pajetë të tyre.

Për të parë situatën nga afër në ambjentet e minierës së Bulqizës në ato ditë, ishte edhe Ambasdorja e Kinës Jang Ju dhe zv ministri i MEI-it Gëzim Musabelli ,të cilët realizuan një takim me specialistët e RISHM-it, AKBN-së dhe përfaqësuesit e Alb Chrome, ku u njohën me situatën e krijuar në këtë minierë, pas shpërthimit të gazit hidrogjen.

Në fjalën e saj Ambasdorja kineze shprehu respekt për qeverinë shqiptare për përpjekjet e saj në menaxhimin e situatës të krijuar në minierë pas tre shpërthimeve të fuqishme të gazit të hidrogjenit, duke theksuar se jeta e minatorëve është parësore dhe se duhet të bëjmë përpjekjet maksimale për mbrojtjen e jetës së tyre. Në përfundim të operacionit të kërkim-shpëtimit, strukturat përgjegjëse u ngarkuan të hartojnë raportin përkatës dhe analizojnë shkaqet e dinamikën e aksidentit të ndodhur.

Kompleksi minerar i Bulqizës është një nga burimet minerare më të rëndësishme të Shqipërisë dhe më gjerë, por kromi i nxjerrë këtu gjatë viteve 1980, kur qeveria e kohës e kishte këtë mineral si burimin kryesor të të ardhurave në valutë, ka bërë që miniera të degradojë dhe të kthehet në burim të vazhdueshëm aksidentesh duke i marrë jetën shumë minatorëve. Aq e vërtetë është kjo sa aksidentet me humbje të jetëve të minatorëve, quheshin rëndom si të radhës. Gjithsesi edhe pse bëhet fjalë për forcim të kushteve të sigurisë në punë për minatorët, ende risku i aksidenteve vijon të mbetet i lartë dhe në të gjitha rastet e ndodhjes së tyre, përgjegjësia ka rënë mbi viktimat, pra është mbuluar së bashku me ta.

Fjala e Specialistit

Gazi Metan në minierën e Bulqizës dhe çfarë duhet bërë

Prof. Dr. **Alfred FRASHËRI**
Prof. Dr. **Gjergji FOTO**

Morëm nismën për të shkruar lidhur me gazin e shfaqur në galeritë e nivelit 14 dhe 21, të minierës së kromit në Bulqizë, thjesht se nuk pamë asnjë angazhim të institucioneve shtetërore apo shkencore të ngarkuara me studimet gjeologjike si Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Instituti i Gjeoshkencave dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave të Universitetit Politeknik. Për fat të keq, me një vendim absurd, prej dhjetë vitesh, është "zhdukur" edhe Instituti i Naftës në Fier. Por ky, është tjetër problem madhor. Deri më sot, ne, kemi dëgjuar veç emërtime të medias për gazin e shpërthyer herë me termin"Gaz Hidrogjen" dhe herë gaz "Metan". Nga media gjithashtu, kemi dëgjuar se Ministri Gjiknuri, ka shkuar për të parë situatën në vënd, dhe se një zëvendës Ministër,pohoi rrezikun për punëtorët e shpëtimit të minierave, në se hyninnë nivelin 21, duke parathënë kështu edhe pamundësinë e shpëtimit tëjetës së minatorëve të bllokuar, që siç e kemi kuptuar, ka të bëjë me thellësitë rreth 2000 metër nën sipërfaqen e Tokës. Duket që nuk ka pasur asnjë specialist me përvojë për të parashikuar ndodhitë dhe për të marrë masat paraprake. E njëjta situatëme ndodhitë e shpërthimeve në Marinëz, më 1 Prill 2015. Ne që po shkruajmë, jemi dy gjeologë pensionistë, ish pedagogë të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe për ta ditur, njeri 82 vjeç dhe tjetri 74.

Shkrimin e plotë e lexoni në linkun e mëposhtëm:
http://www.gazetadita.al/gazi-metan-ne-minieren-e-bulqizes-dhe-cfare-duhet-bere

Skicë

Letër nga nëntoka

Bir i dashur,

ti nuk e di se sa të dua. Nëse do ta dije unë kurrsesi nuk do ta shkruaja këtë letër, megjithëkëtë nuk do mundohem të të shpreh dashurinë; nuk ke si t'i shpëtosh kësaj ndjenje kur të bëhesh vetë prind. Po të them fillimisht se kjo letër është prodhuar nga nëntoka: qindra metra nën tokë, aty ku dhe oksigjeni gjendet me pakicë, dhe po shkruhet pjesë-pjesë këtu ku nuk mungon asgjë: as ajër, as dritë, as kohë.

Ta përmenda dashurinë sepse është e vetmja ndjenjë që më mban gjallë, e vetmja energji që më jep forcë të ngjis dhe zbres tërë ato metra i gjysmëkërrusur. Tashmë ti je në një moshë qe kupton dhe shume lehtë mund të kuptosh që yt atë nuk është injorant; as i dorës së parë as i dorës së dytë, por thjesht një njeri që punon me turne të zgjatur andej nga shumë pak e kanë provuar, dhe kur kthehet në shtëpi vetëm ha dhe fle.

Çdo çast i imi në këtë jetë është i falur, dhe ndoshta ndonjë natë unë nuk mund të dal. E kam këtë parandjenjë sa herë i zhytem tokës por ajo zhduket kur kujtoj se ç'kam lënë mbi tokë. Nuk di ç'm'i pardallis ndjenjat e parandjenjat ama besimi qe do dal edhe sonte nuk humbet.

Është mesi i janarit dhe e gjithë njerëzia ankohet për temperaturat e ftohta, ndërsa këtu me këmbë herë nën ujë e herë në gurë, me duar herë në baltë e herë në shkëmb, vetëm për të ftohtë nuk lejohet të flitet. Pak rëndësi ka nëse unë e zgjodha vetë këtë punë apo u detyrova nga rrethanat, ama vetëm diçka është e ditur; unë u rrita dhe u plaka me këtë punë. Ja me në këto skuta e kthesa nëntoke u thinja, për të vetmen arsye: nuk munda të bëj diçka tjetër. Sot e ndjej që jam plakur. Gjunjët kanë zënë të më dridhen. Këto kohët e fundme, kur jemi në radhë për tu zhytur vihem në rresht i fundit, sepse kanë ardhë disa të rinj që të vënë përpara. Nuk e shtyj dot me ta. Ndër kur vjen ora të ngjitemi, nisem dhjetë minuta para, me dëshirën të qes krye në dritë i pari: herë ia arrij, herë jo, kjo varet si ka ec dita.

Nuk më vjen keq për vitet e mia, nuk dua ta mendosh këtë. Ta kam thënë dhe ti e di që unë jam rritur dhe plakur këtu nëntokë: nesër nëntokës do i nënshtrohemi: të gjithë pa përjashtim. Më vjen keq sepse ti sot je mëse njëzet vjeç. Shkollën e ke lënë, në kurbet s'ke qenë kurrë, as në galeri se ke parë kurrë veten, dhe më keq: s'ja ke haberin asnjë lloji pune. Jam në merak biri im, tek më kthehesh natën vonë, herë i dehur, e herë i bërë tapë me hashash. Jam në merak i shtrenjti im sepse ti s'ke prek kurrë një punë me dorë. Jam në merak, se kam frikë që s'jesh në gjendje të krijosh një familje. Jam në merak...dhe meraku më shtohet kur e di që shkaku i gjithë këtyre jam unë. Shpirti më dhemb sepse tashmë nuk mundem të ndryshoj asgjë. Fajet i kam unë se vija natën dhe po natën ikja, dhe ti u rrite pa baba: ashtu siç deshe bëre gjithnjë.

Të kujtohet atë natë kur edhe në shpi pak pas mesnate, ishe i pirë sigurisht, ishte ditëlindja jote e 19. Veç alkoolit kishe tymosur edhe atë të fut shejtanin në bark. I gjithi qoftëlarg ishe bërë biri imi. Të kujtohet? Po atë natë çove dorë mbi tënden nënë, ia ktheve sofrën e datëlindjes tënde përmbys. Këtë s'ta lejova dot. Zorrët në bark mu ngatërruan e zemërimin e tim e shfryva mbi ty. Jo. S'të kujtohet. Vë bast që s'të kujtohet sepse s'ke qenë ti. Në ty ka qenë qoftëlargu. Në ty ka kohë që është ai. Ka kohë që unë nuk të njoh. Nuk dua të jesh ky që je. Kur ishe i vogël ishe i çiltër. Me ty luaja, gëzoja. Ishe i vetmi dhe të gjithë i kishim sytë tek ti. Ndoshta kjo të ka çuar në këtë dorë dite, sepse asgjë s'të mungoi. Ndërsa mua po. Gjithmonë. Ti më ke munguar dhe sot më mungon akoma më shumë kur të shoh se si je bërë. Megjithëkëto, unë dua të të kërkoj falje. I marr përsipër të gjitha fajet, edhe pse kjo s'ka vlerë tek të shoh të degradohesh. Këto janë dobësitë e një prindi. Këto janë efektet e një kohe të çuar dëm.

Kjo letër e njëzetë po paloset mbi të tjerat dhe uroj, nëse një ditë ku t'i lexosh, mos tallesh me dëshirën time për të shkruar. Në u tallsh, edhe këtë do të ta fal.

Në daç ta dish pse unë jam i gatshëm me të fal gjithçka, kjo nuk është prej natyrës sime, por të fal sepse nuk isha i zoti të të edukoja siç duhej. Nuk isha i zoti të të rrisja. Të rrita, ama vetëm di kashtë e kallì. Unë bir, isha i zoti të të ngopja vetëm barkun, e kurrë nuk munda të të ngop mendjen e aq më pak shpirtin.

E di, edhe unë shpesh kam qesh me fjalët e tim eti. Dhe ti ndoshta do qeshësh me fjalët e mia.

Të uroj që të të duan fëmijët! *Alban Tufa*

bujqësi

Arroret, si arra, lajthia, gështenja, janë në "shtëpinë e tyre". Ato janë pothuaj në gjendje natyrore, nuk spërkaten, nuk plehërohen, dhe si të tilla, mund të konsiderohen si prodhim bio.



Koha për Bio

Rrethi i Dibrës do të ishte shumë i përshtatshëm për ngritjen e fermave që synojnë prodhimin bio. Klima e përshtatshme për disa kultura të veçanta, ajri i pastër, lartësia mbi nivelin e detit, e bëjnë shumë të mundur një gjë të tillë.

Nga **OSMAN XHILI**

"Koha për bio" është një thirrje e pak viteve më parë , por që nuk do t'i humbasë vlerat , për aq kohë sa njeriu do të konsumojë ushqim. Është kjo një thirrje për prodhuesit, për konsumatorët, për qeveritë e qeveritarët, për organizata e fondacione të ndryshme. Është një ftesë për të prodhuar gjëra të shëndetshme, për të kënaqur njeriun , e jo për ta helmuar atë.

Sot, në Shqipëri, shumë ferma po orientohen drejt prodhimit bio. Numri i tyre është afër 200, por gjysma e tyre është aktive. Po të llogaritet për nga sipërfaqja, mendohet të jenë 89 mijë hektarë, por dhe nga këta 440 hektarë , janë të certifikuar nga instituti i bujqësisë biologjike (IBB). Kjo sipërfaqe është vazhdimisht në rritje dhe e ardhmja e këtij sektori do të ketë prioritete. Dhe pse ka vetëm pak vite që po flitet e po punohet për bujqësinë organike , rezultatet nuk kanë munguar. Kompani të tilla si " Shkalla", "Gjikondi", "Musaj", apo dhe të tjera kanë fituar dhe çmime ndërkombëtare për prodhimin cilësor të vajit të ullirit.

Rrethi i Dibrës, do të ishte shumë i përshtatshëm për ngritjen e fermave që synojnë prodhimin bio. Klima e përshtatshme për disa kultura të veçanta, ajri i pastër, lartësia mbi nivelin e detit, e bëjnë shumë të mundur një gjë të tillë. Arroret, si arra, lajthia, gështenja, janë si të thuash në shtëpinë e tyre. Ato janë pothuaj në gjendje natyrore, nuk spërkaten,nuk plehërohen, dhe si të tilla, mund të konsiderohen si prodhim bio. Qarku i Dibrës ka rreth 150 hektarë të mbjellë me arra, 45 ha me gështenjë dhe rreth 15 ha me lajthi. Duke parë përshtatjen e këtyre kulturave, shërbimet relativisht të pakta dhe kërkesat në rritje, mendojmë se kjo sipërfaqe duhet shtuar akoma. Patatja, mund të jetë një objekt shumë i rëndësishëm i prodhimit bio. Dibra ka disa zona që i plotësojnë më së miri kushtet për ta certifikuar si të tillë këtë kulturë. Mund të përmendim këtu zonën e Gollobordës, atë të Bellovës, Kalanë e Dodës, Luzninë, apo dhe ndonjë tjetër.

Gjithnjë e më tepër dëgjohet të flitet për bujqësi organike e bujqësi biologjike. Kjo e fundit nënkupton një sistem bujqësie që përdor bazë materiale të padëmshme për njerëz, gjallesa të tjera dhe mjedisin në përgjithësi. Ajo harmonizon interesat ekonomike, ekologjike dhe sociale, për të sotmen dhe gjeneratat që do të pasojnë.

Po të ndjekësh me pak vemendjen tendencat e sotme të shoqërisë njerëzore e konkretisht të prodhuesve, do të shohësh se dhe rruga që ata ndjekin, bie ndesh që në fillim me atë që u citua më sipër. Një uri e paskrupullt për fitime, rregulla të shkelmuara , moral i kalbur. Një miku im, që banon në qytet, më thoshte një ditë , se më ka marrë malli të ha një sallatë me domate fshati. Domate e kastraveca që rriten e marrin ngjyrat respektive,vetëm në pak ditë, falë produkteve e stimuluesve hormonalë me të cilët trajtohen . Por dhe mishi e nënproduktet e tij, nuk janë larg këtyre fallciteteve e lakmisë për fitim. Një dite isha tek ferma e një shoku dhe më pëlqeu një nga viçat e tij, gjë që e shpreha dhe me fjalë.

- Jo doktor,- u përgjigj fermeri, - ka dhe më të mëdhenj, të po kësaj moshe. Një komshi këtu pranë, i injekton viçit të tij një lëng të zi në qafë dhe ai ka shtuar peshë , shumë më tepër se i imi. Mendova me vete, sa të rrezikuar e të riskuar jemi si konsumatorë nga dëshira për të fituar sa më shumë para. Mishin e viçit të atij komshiut, ne do ta konsumonim me shumë dëshirë si produkt i freskët fshati. Bile mund t'jua dërgojmë dhe miqve në Tiranë .Ne dibranët, më parë përmendnim termin "viç Maqedonie", por sot gjërat janë ndërlikuar shumë më tepër.



Qarku i Dibrës ka rreth 150 hektarë të mbjellë me arra, 45 ha me gështenjë dhe rreth 15 ha me lajthi, por ka mundësi për shtimin e tyre në pak kohë. Patatja, mund të jetë një objekt shumë i rëndësishëm i prodhimit bio.

Kur flasim për mishin jo cilësor,po për sallamet e nënproduktet e tjera, çfarë garancie mund të jepet. Ka raste, që lopë kashektike,ndonjëherë dhe më keq se kaq, shërbejnë si lëndë e parë për prodhimin e sallamit e nënprodukteve të tjera. Para disa ditësh, mediat dhe televizioni, ngritën alarmin për një rrezik kancerogjen, që vinte nga mishi i përpunuar. Ka vite, që në dietën time dhe të familjes, nuk përfshihen sallamet, salçiçet e të tilla si këto.

Ministria e bujqësisë dhe drejtoritë e Agjensisë së Mbrojtjes së Konsumatorit po bëjnë një punë të lavdërueshme në mbrojtje të konsumatorit. Ministri i bujqësisë, Panariti, në një takim me fermerë të Kasharit, foli qartë për rëndësinë e prodhimit bio, dhe mbështetjen që do të bëjë qeveria në këtë drejtim. Por, sërish ngelet akoma shumë për tu bërë. Personalisht, mendoj se vepra të tilla duhet të trajtohen si precedente penale, pak më të rrezikshme edhe se krimi ekonomik, pasi kanë të bëjnë direkt me jetën tonë.

Të njëjtin mendim kam për shumicën e pijeve që konsumojmë. Kur jam mik diku, e refuzoj pa mëdyshje gotën me kola, apo me amita të ndryshme që më vihet përpara. Në një rast, shkuan të blejnë një shishe të tillë në dyqan, kur mbi sobë gurgullonte mbi dhjetë kilogramë qumësht i posamjelë.

- Jo, miqtë e mi! - U fola unë, pak i mërzitur, pak i revoltuar,por jo prej tyre, por nga injoranca jonë. Më mbushni një gotë qumësht, u thashë.Të blesh një shishe me ujë të ngjyrosur me më tepër para se një shishe qumësht, kjo është vërtetë për të vënë duart në kokë. Shpesh një shishe amita mund të kushtojë dy dhe tre herë më shumë. Nga qumështi del gjiza, gjalpi, djathi, kosi e hirra, shumë kuruese, kurse ai uji me ngjyrë në shishen e blerë, vetëm dëme shëndetit mund ti shkaktojë. Pa le, po shpesh përdorim dhe fjalën "origjinale", që në fakt, veç emrit, nuk ka asgjë të tillë. Ne kemi mundësi të panumërta për ti zëvendësuar produkte të tilla me ato që i bëjmë me duart tona, shumë më të lira, e shumë më të shijshme. Kompostot e ftoit, të qershisë, vishnjes, kumbullës dhe e frutave të tjerë, janë vërtetë pije princërore. Amvisat prodhojnë shpesh, një lëng thane, që quhet "narden", kaq i shijshëm, sa do kërkosh dhe një gotë të dytë, pasi ke konsumuar të parën. Mos flasim pastaj për çajra të boronicës, të dëllinjës, të blinit, të trandafilit të egër, të cilat na rrethojnë gjithandej dhe janë shumë të shijshme e shumë kuruese. Në qarkun e Dibrës ka plot grupe grash që po punojnë fort në këtë drejtim. Prodhimet e tyre janë ekspozuar në panairin e përvitshëm, që organizohet në Peshkopi, por dhe në vende dhe veprimtari të tjera.

Çajrat e boronicës, dëllinjës, blinit, trëndafilit të egër na rrethojnë gjithandej dhe janë shumë të shijshme e shumë kuruese. Në qarkun e Dibrës ka plot grupe grash që po punojnë fort në këtë drejtim.

Prandaj , ti o njeri, që shkon në hënë e planete të tjerë, që bën aviona e raketa, që krijon robote e bën shpikje të ndryshme, kontrollo së pari atë çfarë konsumon, atë çfarë han dhe pin. Mos u mashtro për kollaj nga etiketat dhe reklamat e bujshme nëpër ambalazhe. Ngado që të hedhësh sytë sheh plot gjëra për të korrigjuar, për të ndryshuar. Gati konsumohet vetëm bukë gruri, kur dihet se misri është shumë më dietik dhe ka vlera sidomos tek diabetikët. Po kështu thekra me cilësitë e saj, mbetet një vlerë e pallogaritshme. Furrat e bukës e përdorin majanë për të fryrë brumin pa hesap. Në fakt, ashtu siç fryhet brumi, ashtu po fryhen dhe njerëzit, duke u shfaqur me dhjetra sëmundje metabolizmi, pikërisht nga mënyra se si ushqehemi dhe çfarë konsumojmë.

Rruga e Arbërit nr. 130



AKTUALITETE

Peshkopi

Ku janë djemtë e Dibrës?

-Një i mbytur ne brigjet e Otrantos, varrosur para pesë ditësh në Klloçisht të Maqellarës

-Një tjetër i mbytur në brigjet e Otrantos, i paidentifikuar

-29 djem të Dibrës, hypur në skafine 9 marsit,nuk dihet ku janë

-Vaje e lot në Maqellarë, Grevë, Melan, Brezhdan etj. për djemtë e humbur.

Lajmi i kobshëm, ardhur nga brigjet e Otrantos në komisariatin e policisë së Peshkopisë më 11 mars 1996 helmoi së pari familjen e Zaudin Qokut në Klobçisht të Maqellarës. Djali i tij është gjetur i vdekur ne brigjet e Otrantos. Me preokupimin e njerëzve të gjakut e në veçanti e deputetit Agron Qoku, trupi tij pajetë i Sulejmanit u soll e Maqellarë për t'u prehur në këtë mëmë.Por ndryshe nga mbëdhjetë viktimat e tjera që to vite me vdekjen e tyre në e moshë fare të re kanë rcjellë lot e dhimbje në famildhe të afërmit e tyre(djem, a Kllobçishti, Katundi i gël, Maqellara. Grazhdani vdekja më e re përcolli një pranë familjeve për t'i qetësuar. Lajmi u përcoll nga disa gazeta. Vetëm gazeta dhe media zyrtare heshtën(!).

Njerëzit me njetet dhe ndjekur ditë për ditë, që nga 9 marsi e në vazhdim. Ministria e brendëshme më 27 mars njofton se më 19 mars në bregdetin e Otrantos , është gjetur kufo-

21 VJET MË PARË

Heshtja dhe mbyllja e tragjedisë dibrane, 9 Mars 1996

DËSHMON IZET HAXHIA

Në atë kohë është munduar të mbahet heshtje e të mbyllet kjo tragjedi sepse ata që kanë bërë trafikun e tyre kanë qenë të lidhur me pushtetin e PD dhe SHIKU-t në atë kohë

NJË LETËR...

I nderuar z. Izet,

Lexoj me vëmendje dhe ju respektoj në misionin tuaj për të hedhë dritë në errësirën që u krijua në Shqipëri, veçanërisht në vitet nëntëdhjetë. Unë kam qenë gazetar i "Zërit të popullit" në Dibër deri në korrik të vitit 1996, kur pas zgjedhjeve të 26 majit, dhuna fizike e tre viteve më parë u shndërrua në dhunë familjare, në kërcënimin për të më rrëmbyer fëmijët dhe në tentativën e hapur për të rrëmbyer vajzën time studente. Përballë ultimatumit "O mbyll gojën, ose të rrëmbyem fëmijët dhe më keq" u detyrova të ikja natën, fshehurazi nga Peshkopia dhe të vendosem në Athinë ku jetoj me vështirësitë e moshës 76 vjeçare dhe të shëndetit tash më se 20 vjet.

Më 9 mars të vitit 1996 një gomone me tridhjetë dibranë u zhduk në ujërat e Otrantos. Një kufomë u gjet në brigjet e Italisë. Kufoma ishte e një djali të ri nga Kllobçishti i Maqellarës e cila u identifikua dhe u mor nga Italia e u varros në vendlindje nga deputeti Agron Qoku. Flitet se janë gjetur edhe dy kufoma të tjera por deri sot nuk janë përdorë teknikat e kohës me ADN për verifikimin e tyre. Më 14 mars 1996 botova një lajm thirrës për ti kërkuar të zhdukurit, lajm që pushteti i Sali Berishës e vuri kundër meje dhe nuk bëri asnjë hap për të sqaruar familjet e viktimave. Ishin kohë zgjedhjesh dhe siç i pat deklaruar një gazetari të "Zërit të popullit" Bashkim Gazidede (kishin qenë bashkë mësues në gjimnazin e Peshkopisë) "Ata janë mbytur por ne nuk na intereson të bëhet publik".

Ishte koha përpara zgjedhjeve të 26 majit 1996. Ju keni qenë pranë ngjarjes, pranë bisedave që me siguri janë zhvilluar në kupolën e lartë të kohës dhe në korridoret e institucioneve. Shpresoj të keni për këtë kujtime të cilat do të desha ti kem në arkivin tim për të hedhë një fije drite për këtë ngjarje që u shua në mënyrën më të shëmtuar. Një vit më vonë do të ndodhte tragjedia e "Sebilës", e disa vite më vonë ajo e shkodranëve të mbytur në zonën e Karaburunit. Për të dyja këto ngjarje flitet çdo vit dhe kërkohet zbardhja më e gjerë e ngjarjes, ndërsa për 9 marsin e dibranëve është heshtur dhe vazhdon të heshtet. Do të desha që kujtimet tuaja për këtë ngjarje të mi dërgoni që ti bëj publike me rastin e 21 vjetorit të tragjedisë. Shpresoj në ndihmën dhe kujtesën tuaj njerëzore si një homazh për "Djemtë e Dibrës" Me respekt Abdurahim Ashiku Athinë, 28 janar 2017

PËRGJIGJE NGA IZET HAXHIA...

Përshëndetje Abdurahim,

Më kujtohet si ngjarje kjo e nëntë marsit. Nga Maqellara kanë qenë të gjithë. Me sa me kujtohet rreth 29 apo 30 veta. Në atë kohë është munduar të mbahet heshtje e të mbyllet kjo tragjedi sepse ata që kanë bërë trafikun e tyre kanë qenë të lidhur me pushtetin e PD dhe SHIKU-t në atë kohë. Ndonjë hollësi nuk më kujtohet, por po kujtova diçka do ta përcjell.

Gjithë të mirat!

KRONIKA E TRAGJEDISË 9 MARS 1996 MAQELLARA NËN TRYSNINË E NJË TRAGJEDIE DETARE

Lajmi i zi arrin në Maqellarë. Komisariati i Vlorës njofton komisariatin e Peshkopisë se një djalë i ri nga Maqellara e Dibrës është gjetur i vdekur në breg të detit, nxjerrë nga valët e ftohta të tij.

Njerëzit e familjes, me dhimbjen e madhe për njeriun e tyre të dashur nisen për të marrë djalin e vdekur. Në Vlorë mësojnë se kufoma nuk është gjetur në brigjet e detit shqiptar por në anën tjetër të detit, në brigjet e Otrantos.

Në Maqellarë të Dibrës është hapur mort. Familja Qoku pret e përcjell njerëz, pret të vijë djali i tyre i shtrenjtë.

Por në Maqellarë tmerri i vdekjes është më i gjerë, më i madh, i pranishëm në dhjetëra familje. Kjo lidhet me faktin se njëkohësisht me djaloshin Qoku janë nisur në drejtim të Vlorës, e më tej me gomone në drejtim të Italisë, tre mikrobusë me djem të rinj, rreth 30 vetë. Deri tani për ta nuk ka asnjë lajm, asgjë që të qetësojë zemrat e ngrira nga tmerri të nënave, baballarëve, motrave, grave, fëmijëve, të afërmeve të këtyre familjeve.

Një djalë i ri është gjetur i vdekur në brigjet e detit italian. Dhjetëra djem të tjerë nuk dihet ku janë, nuk dihet në se kanë arritur në brigjet e ëndrrës së tyre për një jetë më të mirë apo i kanë përpirë dallgët e zeza të detit. Familjet pranë zyrave të postë telekomunikacionit pyesin në adresa të ndryshme në shtetet fqinj dhe nuk marrin përgjigje.

Duke uruar që djemtë të kenë arritur shëndosh e mirë në Itali e familjet e kësaj zone të mos shohin gjëmë e kob, Maqellara kërkon të hidhet zyrtarisht dritë mbi këtë ngjarje të rëndë, të qetësohen zemrat e ngrira të prindërve.

Abdurahim Ashiku

(Botohet sipas kopjes origjinale në arkivin e gazetarit) Gazetar

* * *

Tragjedia Dibrane e 9 marsit 1996 është e mbyllur, e kyçur në kasafortat e trafikantëve të pushtetit të kohës. Për të është heshtur dhe vazhdon të heshtet...

Po flitet përditë për hapje dosjesh për krimet e komunizmit kur duhet të flitet po aq fort edhe për krimet e pas komunizmit, krime që ende kullojnë gjakun e djemve të rinj, e vajzave të reja, krime në kujtesën e drejtpërdrejtë të njerëzve që i jetuan, krime që kanë adresa pushtetarësh.

Dosja e tragjedisë dibrane duhet të hapet në të gjitha fletët, "sepse ata që kanë bërë trafikun e tyre kanë qenë të lidhur me pushtetin e PD dhe SHIKU-t në atë kohë."

Fytyra e tyre duhet të dalë në dritën e diellit për ti detyruar të ulen në bankën e të akuzuarit...

A.Ashiku

NJOFTIME

Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Edhe në rastet kur kontributet tuaja janë CASH, kërkoni një dokument të firmosur dhe vulosur nga redaksia.

* * *

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6** ose në faqen tonë **www.rrugaearberit.com**

Bëj pajtimin tënd me PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit

ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

vendlindja

Opinion / Në Dibër, ashtu si në shumë rajone të tjera të Shqipërisë, ardhja në jetë dhe rritja e një vajze akoma konsiderohet si një barrë nga familjet e tyre.

VLESHA, fshati i njerëzve të mirë dhe punëtorë

Nga **SIDORELA SHEHU**



Një fshat mes fshatrave! Një fshat si të gjithë fshatrat për fshatarët e tjerë, por jo për mua! Një fshat as i madh, as i vogël në veri –lindje të Dibrës, Vlesha. Ndodhet rreth 25 km larg nga qyteti i Peshkopisë dhe është pjesë e njësisë administrative Sllovë. Rruga kryesore që kalon sipër fshatit e lidh atë me Kalanë e Dodës dhe Kukësin!

Nga ana e poshtme fusha, e cila kufizohet si një gadishull në tri anët me tre fshatra te tjerë, Kallën, Zall-Kalisin, Sllovën. Nga ana e sipërme Stërmeci, mali i fshatit, duket sikur vë kufij dhe nëse ngjitesh në majë të tij, ai hap kufinjtë. Gjithashtu, duket sikur ka krijuar enkas për fshatin një ballkon në trup të tij. Madhështia e tij hap krahët në lindje te diellit dhe qëndron hijerëndë kur nata zbret mbi të!

Vlesha qëndron prej 300 vjetësh në këtë ballkon duke pritur e përcjellë njerëz, vite, zakone, tradita të mira e gjithçka. Ekzistenca e saj merr jetë edhe nga toponimet e ndryshme të vendit si: Kodra e Kishës; Kroi i Shëngjergjit; lisat e Shëngjergjit etj. Mbase këto toponime vërtetojnë historikun e një popullsie të vjetër katolike që jetonte njëherë e një kohë në Vleshë.

Ende sot, ndihen ecjet e të parëve tanë. Teqja e Shehelerëve ndodhet në brendësi të fshatit dhe kushdo që kërkon lutje për ndihmë, e ka marrë atë lutje. Gjithashtu, Vlesha është e njohur për Ujin e Ftohtë, ku shumë njerëz nga fshatrat përreth Dibrës ose Kukësit, vijnë për të përmirësuar shëndetin e tyre në këtë burim ujor, që shërben për të ndihmuar njerëzit që vuajnë nga reumatizma. Madje, Uji i Ftohtë është burimi kryesor vaditës për fushën e begatë të Vleshës.

Për ata që e njohin Vleshën thjesht kalimthi nga rruga kryesore , nuk mund ta dinë gjallërinë që ajo akoma merr dhe jep nga çdo stinë. Pranvera i dërgon zogjtë që trokasin netëve të gjata në pemët e lulëzuara plot hare. Vera e përcjell me ardhjen e nipërve , mbesave që kthehen në fshat për pushime të qeta. Vjeshta rikthen gjallërinë e njerëzve punëtore kur marrin frytin e punëve të lodhshme te verës. Kurse dimri hedh mbi të petkun e bardhësisë duke dhënë një magjepsje të një vendi krejtësisht turistik.

Tani popullsia e Vleshës është e pakësuar në numër, por nuk mungojnë akoma njerëzit e mirë dhe mysafirë; ata njerëz që akoma tregojnë historitë e të parëve tanë me një lloj fanatizmi; ata njerëz që në raste dasmash mblidhen tok më tok për të ndihmuar njëritjetrin në gatime ose në përcjellje te miqve të rinj. Janë pikërisht këto virtyte që bëjnë të ndihesh se nuk je vetëm.

Shumë arsimtarë të fshatit kanë dhënë ndihmesa për shkollimin e brezave të ndryshëm duke hedhur dritë për një të ardhme të mirë për çdokënd.

Ekziston një ndjenjë kënaqësie të flasësh e shkruash për Vleshën! Krenare për vendlindjen time! Unë akoma ndjej ecejaket e një dite të bukur pranvere, ku dal në oborr të shtëpisë dhe aroma e pemëve të lulëzuara më shoqëron për një kafe të shkurtër...

Pasuri për mua dhe vendasit e saj, dhe për të tjerët një fshat që ndoshta nuk do e njihni mjaftueshëm...

Për vajzat dibrane dhe jo vetëm!

Nga **KLODIANA KAPO***



Qytarët e Dibrës duke shëtitur në bulevardin e qytetit | Foto nga: Lindita Çela

Errisim për derë të huej! Kështu m'u përgjigj nëna e Anës 12 vjeçare kur e pyeta pse vajza nuk po ulej. Sapo kishim bujt në shtëpinë e saj dhe jashtë kishte nisur të errej. Dhoma ishte e ngrohtë ndërsa dyshemeja e cila mbulohej nga një tapet që i kishin dalë ngjyrat ishte i akullt. Ishte ftohtë dhe fëmijët preferonin të qëndronin sa më pranë sobës së drurit. Gruaja e shtëpisë mblodhi me shpejtësi tryezën e bukës. Kishim ardhur në një kohë të papërshtatshme. Por të zotët e shtëpisë nuk e prishën zemrën. Nëna dhe dy djemtë e vegjël u ulën në njerin divan, pranë nesh. Burri dhe vëllai i tij në anën tjetër. Pasi na pyetën me rradhë si ishim, dhe a ishim lodhur në dhomë hyri vajza e madhe e shtëpisë Ana. 12 vjeçarja kishte një fshesë të vogël në dorë, dhe me shpejtësi u ul për të pastruar nën këmbët tona thërrimet e mbetura të bukës. Sa hap e mbyll sytë ajo pastroi tapetin dhe u zhvendos pranë sobës së drurit, për të futur një kërcu druri. U largua dhe pas pak minutash u duk në derë me një tas me karamele dhe një limonatë për të na qerasur, ne miqtë e paftuar. Pasi kreu nderimet me rradhë dhe qerasi edhe dy vëllezërit e saj më të vegjël, ajo qëndroi sërisht në krah të sobës, në këmbë aty ku dremiste e qetë një mace e bardhë. Sa fëmijë ke?- e pyes gruan e shtëpisë.

Pesë, tre cuca e kta dy voca. Një e kam të martuar, një tek vllahu dhe në shtëpi kam Anën e dy vocat.

Ana nuk i ngrinte sytë. Duart i shtëngonte e nuk dinte nga t'i fuste prej sikleti.

Pse e lodh kaq shumë gocën? – e pyes mbase edhe duke e tepruar pak.

Eh, thotë nëna po e përgatis për derë të huej. Në këtë çast ndërhyn xhaxhai i cili bashkë me të vëllanë përdrodhën mustaqetet. Ana këtu është në derë të huej. Tek burri është në derë të vet.

Askush nuk foli. As nëna, as Ana, as ne.

Kërkuam leje dhe u çuam. I fola Anës, i afrova ta përqafoja. Por ajo smë degjoi, smë pa. Sytë i mbante poshtë. E preka. M'u hodh në krah ndërsa më dukej se tërë kohës pickonte veten me siklet.

Ana më trishtoi.

E takova pasi kisha takuar tre gra që kishin zgjedhur të ishin të forta, të mos u besonin lotëve, të luftonin. Por dhimbja po i linte vraga të mëdha, në shpirt dhe në trup. Ato i ishin nënshtruar mentalitetit të nënave dhe baballarëve të tyre. Ishin dhënë në derë të vet. Aida 38 vjeç po luftonte e vetme të rriste tre fëmijët që burri i saj kishte pasur në martesën e parë, dhe po përpiqej me forcë të gjente zgjidhje për djalin e saj pesë vjeçar i cili kishte lindur me disa sëmundje dhe askush nuk i jep shpresë. Bashkëshorti i saj jeton në Greqi dhe asaj i duhet jo vetëm të kujdeset por edhe të ushqejë katër fëmijë. Kur ne ikëm, mes lotësh Aida tha: "Do të ishte më mirë të isha bërë nënë pa patur në krah një burrë. Por Aida nuk është e vetmja. Valentina është një tjetër grua, që na besoi një pjesë të jetës së saj. Ajo ishte mbartuar me mblesëri në moshën 19 vjeçare. Ishte bërë nënë e një vajze dhe një djali i cili lindi me probleme të mëdha shëndetësore. Bashkëshorti e braktisi dhe vjehrra e nxorri nga shtëpia. Tani ajo jetonte në një hapësirë prej 2 metër katror tek shtëpia e babait të saj. Ajo me vajzën kujdeset 24 orë në 24 për djalin.Ai nuk ecën. Nuk mund të ushqehet vet dhe nuk flet. Kur ky fëmijë të eci e gjithë Shqipëria do të jetë e imja thotë Valentina. Ju më shihni në dy metra katror por mua më duket vilë, duke patur parasysh se çfarë kam kaluar në shtëpinë e burrit. Ndërsa Zarja, një tjetër grua na tha se përveç varfërisë, sëmundjes duhet të durojë dhe pranojë edhe dhunën që burri ushtron ndaj saj dhe femijëve. Nënat në disa zona të Dibrës trishtohen kur lindin vajza. Ato i shohin me dhimbje se kanë frikë se ato do të nëpërkëmben, përbuzen, shfrytëzohen dhe dhunohen.

Dhe cikli vijon. Këto vajza bëhen gra, nëna që ndëshkojnë vajzat e tyre pa patur forcë të ndryshojnë.

Sa do të doja që Ana, të kishte mundësi të bisedonte me ne, të fliste për ëndrrat e saj, të ulej me kokën lart në divanet e shtëpisë dhe të bisedonim për shoqet e saj të klasës, apo se çfarë do të donte të bëhej kur të rritej,

Do të doja që Ana të ndihej e barabartë me vellezërit e saj, dhe ta ndjente se ajo derë do të ishte gjithnjë e hapur dhe e ngrohtë për të.

(reporter.al)

Klodiana Kapo është Menaxhere për Marrëdhëniet Publike dhe Komunikimin për World Vision në Shqipëri dhe Kosovë. World Vision International është një organizatë e krishterë humanitare, zhvillimi dhe advokimi me aktivitet në rreth 100 vende të botës.

Rruga e Arbërit nr. 130

dëshmi

Ibrahim Kika, 97-vjeçari nga Valikardha e Zerqanit, i infiltruar nga komunistër në sekretarinë e Konferencës, tregon ngjarjet e atyre viteve, në një rrëfim ekskluziv për gazetën "Rrugën e Arbërit".

Ja si më infiltruan komunistët në Konferencën e Zall Herrit

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Veterani i LNÇL, 97 vjeçari Ibrahim Kika, pjesëmarrës në konferencën e organizuar në Zall Herr të Tiranës nga nacionalistët (Balli Kombëtar, Legaliteti dhe paria e Dibrës), tregon për Rrugën e Arbërit, qëllimin e mbajtjes të kësaj konference. Edhe pse në moshë të thyer, 97 vjeçari nga Valikardha e Zerqanit, gëzon një shëndet të admirueshëm dhe kujtesë, do thonim pa e tepruar, të përkryer, si pakkush në moshën e tij. Pjesëmarrës i rreshtuar me komunistët në FNÇL, ai dërgohet prej tyre në Konferencën e Zall Herrit, për të qenë syri dhe veshi i tyre për të mësuar mbi qëllimin e mbajtjes së kësaj konference dhe atë që do vendosej në përfundim të zhvillimit të saj.

REKRUTIMI

Në vjeshtën e 1943, nis tregimin e tij, 97 vjeçari, kur sapo ishte prishur në mënyrë të njëanshme Marrëveshja e Mukjes, klima e marrëdhënieve mes FNÇL e Ballit Kombëtar, ishte ashpërsuar së tepërmi, pasi komunistët me hedhjen poshtë të kësaj marrëveshje, përvijuan qartë qëndrimin e tyre për të mos pranuar ndarjen e pushtetit me nacionalistët, pas përfundimit të luftës. Shfaqet në këtë periudhë mjaft aktiv në lëvizjet e tij Abaz Kupi ose siç thirrej ndryshe Bazi i Canës, me gradën major, i cili ishte i njohur pasi kishte udhëhequr rezistencën e forcave të Mbretit Zog, më 7 prill 1939, kundër trupave italiane që zbarkuan në Durrës. Edhe pse nuk kishte shkollë të madhe, për të flitej si njeri trim dhe i zgjuar. Pas largimit të Mbretit Zog dhe deri në pushtimin e vendit nga gjermanët, ai mbajti emrin e mirë të antifashistit.

Pozita e tij për tu pozicionuar me komunistët apo ballistët bëhet e vështirë për shkak të bindjeve të tij të kundërta jo vetëm me komunistët, por edhe me ballistët. Ndaj në fillim vjeshtën e 1943-shit, ai pozicionohet me organizatën Nacional Zogiste, ku përveç tij nënshkruajnë edhe Fiqiri Dineja, Muharrem Bajraktari, Aqif Lleshi, Miftar Kaloshi, Cen Elezi etj. Si nacionalist, bajraktar i Krujës, natyrisht që ai ndjehej më afër dhe më mirë për të bashkëpunuar me BK. Pikërisht në të tilla rrethana Fronti Nacionalist (Ballistë, Legalistë), të mbështetur edhe nga Paria e Dibrës, nisin një lëvizje të madhe për tu organizuar, ku padyshim Abaz Kupi, bëhet një nga eksponentët më aktiv, për rigrupimin e riorganizimin e forcave të djathta nacionaliste në vend, me qëllimin e formimit të një Qeverie të Përkohshme, e cila flitej se do vendosej në qytetin e Peshkopisë. Në këtë kohë isha vetëm 22 vjeç dhe i inkuadruar në Batalionin Partizan të Dibrës, ku zëvendës komisar ishte djali i motrës time, Isuf Sula dhe përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm Zoi Themeli. Në shtabin e batalionit, prej ditësh diskutohej për organizimin e Konferencës së Zall

Forcat ballisto-zogiste në bashkëpunim me parinë e Dibrës, me mbarimin e konferencës, nisen nga Zall Herri, drejt qytetit të Peshkopisë. Më duhej t'i shkëputesha grupit, për të informuar komunistët për vendimet që u morën në Konferencën e Zall Herrit, në plotësim të detyrës që kisha marrë...



Herrit, nga nacionalistët. Duhej me çdo kusht që të merrej vesh se çfarë do vendosej atje, që të merreshin masa nga ana e forcave partizane, për të penguar dhe moslejuar hyrjen e forcave nacionaliste në qytetin e Peshkopisë.

Ndërkohë edhe nacionalistët kishin nisur lëvizjen e tyre për organizimin e kësaj konference. Ka qenë fillim tetori i 1943. Hysni Dema dhe Pajazit Përvizi, krerë të parisë së Dibrës, falë edhe njohjeve që kishin me babën tim, Nezirin, pasi ai ishte kryeplak i fshatit Valikardhë për disa vite radhazi, i trokasin në derë duke i kërkuar pjesëmarrjen time në Konferencën e Zall Herrit. Babës duke qenë kryeplak i fshatit, i duhej të mbante qëndrim të kujdesshëm edhe me nacionalistët, për ta ruajtur fshatin nga raprezaljet e okupatorit, pasi ata kishin lidhje me të.

– Do rrini sonte këtu në shtëpinë time, -u thotë baba.

– Jo se kemi punë pasi duhet të mbledhim njerëz për pjesëmarrjen në këtë konferencë, që do jetë shumë e rëndësishme.

– Pastaj kemi frikë se ti nuk na ban mish, -i thonë babës me shaka dhe nisen drejt Teqesë së Dëllinjës për të rekrutuar të tjerë pjesëmarrës për në Zall Herr. Isha 22 vjeç dhe në këtë kohë, ashtu siç dhe ju tregova më lart, isha i angazhuar në batalionin partizan të Dibrës, falë kjo edhe lidhjes që kisha me një nga drejtuesit e këtij batalioni, Isuf Sula, të cilin e kasha halis nip, djalin e motrës. Pasi më bën me dije baba për ftesën e nacionalistëve, njoftoj Isufin dhe Zoin.

–Po më thonë ata pa mëdyshje.

–Neve po mendojmë prej kohësh për zgjidhjen e këtij problem, pasi na duhet me doemos që të dijmë se ç'farë do vendoset në atë konferencë.

– Shkurt hesapi, ti do të jeshë syri dhe veshi jonë në këtë konferencë. Pasi marr udhëzimet e duhura prej tyre, së bashku me dhjetra të tjerë valikardhas, nisemi drejt Zall Herrit.

ZHVILLIMI I KONFERENCËS

Duhet të ketë qenë java e dytë e tetorit të 1943 kur dhe u mbajt konferenca. Vërehej një angazhim dhe shpejtësi e madhe në mbajtjen e saj. Kjo për faktin se siç dhe thashë më lart, ishte momenti kur marrëdhëniet midis F.N.Çl, e Ballit Kombëtar, ishin ashpërsuar pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Mukjes, kur komunistët u tërhoqën nga nënshkrimi i saj në mënyrë të njëanshme, pasi nuk pranuan ta ndanin pushtetin me nacionalistët pas mbarimit

Cili ishte roli i Fiqiri Dines, Muharrem Bajraktarit, Aqif Lleshit, Miftar Kaloshit dhe Cen Elezit?

Na mbajtën mirë me ushqim ku çdo natë thereshin berre, por edhe na paguanin me napolona floriri për ditët e qëndrimit, natyrisht me pagesa të diferencuara ku më shumë merrnin komandantët dhe oficerët dhe më pak pjesëmarrësit e thjeshtë. I përmbledhur qëllimi i kësaj konference ishte riorganizimi i forcave të BK, Legalitetit dhe parisë së Dibrës...

të luftës. Ndërkohë kishte dështuar edhe një përpjekje e Ballit Kombëtar për të formuar një qeveri të përkohshme në Berat. Ndaj situata ishte "zjarm". Në të dy frontet, atë NÇL dhe atë Nacionalist, punohej intensivisht se kush do merrte pushtetin me mbarimin e luftës. Pra ishin ditët e përplasjes së fortë mes tyre. Kujtoj pjesëmarrjen e krerëve më të lartë të BK, Legalitetit dhe parisë së Dibrës, Abaz Kupi, Preng Pervizi, Musa Juka, Medi e Mithat Frashëri, Fiqiri Dineja, Muharrem Bajraktarin, Aqif Lleshin, Sul Kurtin, Myftar Kaloshin, Cen Elezi etj. Shansi im në zbatim të detyrës së marrë nga komunistët, për të qenë brënda kësaj konference, si zëri dhe veshi i tyre, erdhi krejt papritur e pakujtuar. Miku i familjes time Pajazit Përvizi, me të cilin kisha punuar në moshën 18 vjeçare në Nënprefekturën e Zerqanit, ku ai ishte sekretar i saj, më komunikoj nën praninë edhe të një prifti katolik, që nuk e kujtoj emrin e tij, detyrën e sekretarit, për të qenë brenda konferencës, ku do mbaja proces verbalin e zhvillimit të saj, për llogari të tyre. Kështu mu krijua mundësia ideale që të marr vesh se çfarë do të thuhet në atë konferencë, për të plotësuar kështu detyrën e marrë nga komunistët.

Konferenca vijoi për katër ditë. Na mbajtën mirë me ushqim ku çdo natë thereshin berre, por edhe na paguanin me napolona floriri për ditët e qëndrimit, natyrisht me pagesa të diferencuara ku më shumë merrnin komandantët dhe oficerët dhe më pak pjesëmarrësit e thjeshtë. I përmbledhur qëllimi i kësaj konference ishte riorganizimi i forcave të BK, Legalitetit dhe parisë së Dibrës, për të formuar një Qeveri të Përkohshme në qytetin e Peshkopisë, pasi kishin dështuar në Jug të vendit për formimin e saj. Këtu u hodh ideja për luftë kundër partizanëve kudo që ata do të ndeshen. Pra pikërisht këtu u fol hapur për luftë ndaj njëri-tjetrit, apo vllavrasëse siç dhe e quajnë disa, por mua nuk më vjen mirë ta quaj të tillë. Dhe kjo përplasje dukej se për të parën herë haptazi do ndodhte në Peshkopi, ku dy grupimet e këtyre fronteve do luftonin kundra njëri-tjetrit. Për hir të së vërtetës në këtë Konferencë, nuk u tha asgjë nëse në këtë përpjekje nacionalistët do të kishin edhe ndihmën e gjermanëve, por ndërkohë as nuk u fol për luftën kundër okupatorit.

NISJA DREJT PESHKOPISË PËR FORMIMIN E QEVERISË SË PËRKOHSHME.

Forcat ballisto-zogiste në bashkëpunim me parinë e Dibrës, me mbarimin e konferencës, nisen nga Zall Herri, drejt qytetit të Peshkopisë. Më duhej t'i shkëputesha grupit, për të informuar komunistët për vendimet që u morën në Konferencën e Zall Herrit, në plotësim të detyrës që kisha marrë. I shkëputem grupit me pretendimin se më duhet të kontaktoj me bashkëfshatarët e mi të Valikardhës, për të ardhur së bashku me ata.

Por edhe me ata më duhej që të shkëputesha, pasi duhej të kontaktoja me komunistët (Isufin dhe Zoin), për t'i vënë në dijeni për atë që kishte vendosur kjo konferencë. Pasi mendohem mirë, krijoj një sherr me njërin nga bashkëfshatarët e mi, Ymerr Lami, për pagesën e ditëve të konferencës, ku ai kërkonte nga unë që t'i jepja më shumë napolona se ç'i dhashë, ndërkohë që unë kisha shtuar më shumë emra nga ç'farë morën pjesë në konferencë. Ishte kjo sajesë sherri, që më mundësoi të kthehem vetëm në Dibër, në plotësim të misionit që kisha marrë përsipër.

KTHIMI PRANË BATALIONIT PARTIZAN TË DIBRËS.

Mora i vetëm rrugën e kthimit Zall Herr-Shkalla e Bjeshit-Bastar-Qaf Murrize-Guri i Bardhë. Isha i ri dhe i fuqishëm. Mu deshën vetëm 12 orë për tu kthyer në shtëpi. Kontaktin e parë e marr me ata, që më nisën me këtë mision, Isuf Sula, Zoi Themeli dhe Dalip Gurra, për t'i informuar me atë që kishte vendosur Konferenca e Zall Herrit. E lamë që të nesërmen të takohemi në Shupenzë tek shtëpia e Ramiz Murrës, ku veç këtyre të treve do merrte pjesë edhe Haxhi Lleshi, komandant i Batalionit të Dibrës. – Këtë djalin nga e kemi, -pyet Haxhiu. –Është i joni nga Valikardha e Zerqanit dhe daja i Isufit, - i thotë Zoi. – Paska bërë një punë për tu lavdëruar. Nxjerr nga gjiri materialet që kisha mbajtur nga zhvillimi i konferencës dhe jua vë përpara në tavolinë.

Pasi njihen me materialet e Konferencës së Zall Herrit, ata largohen menjëherë në drejtim të Dibrës së Madhe për të organizuar forcat partizane, për të mos lejuar hyrjen e forcave ballisto-zogiste të ndihmuara nga paria e Dibrës, në në qytetin e Peshkopisë. U la detyrë që veç forcave të Batalionit të Dibrës, në luftimet e Peshkopisë të përfshiheshin edhe forcat partizane të Çetës së Gollobordës, të komanduara nga Ahmet Cami. -Më lanë në besë tek Ramiz Murra. Ramizi më ndihmoi që të kthehesha në Zerqan tek Përvizet, për të çuar materialet e konferencës, të cilat mi kthej Isufi, pasi i kopjoi ata. Dy grupet ai ballisto-zogist dhe komunistat u konfrontuan në luftën e Peshkopisë, e cila u zhvillua nga 16 deri më 18 tetor 1943, ku forcat partizane nuk lejuan që nacionalistët dhe forcat e parisë së Dibrës të hynin në qytetin e Peshkopisë. Në këto luftime u vra edhe komandanti i Çetës së Gollobordës, Ahmet Cami.

(Vijon numrin e ardhshëm)

intervistë

Dritëro Agolli dhe "Njeriu me top" **i** Luznisë së **Dibrës**

Nga ABDURAHIM ASHIKU



Ai, Dritëro Agolli, poeti, shkrimtari, NJERIU, e donte Dibrën dhe dibranët. Sa herë jam takuar me Të, në mjedise të ndryshme në Tiranë dhe në Athinë, në shtëpinë e Tij gjithnjë derëhapur për të gjithë, fjalën e ka përcjellë në Dibër duke kujtuar me dëshirë njerëz dhe vende, duke i përmendur me emër e mbiemër.

Dritëro Agolli fizikisht nuk është më por shpirtërisht është midis atyre njerëzve që e deshën dhe i deshi.

Nga bisedat që kam bërë në shtëpinë e tij, nga fotografitë, disa me vlerë artistike që këto ditë më janë marrë nga interneti pa cilësim autori, po përcjell njërën, atë që është e lidhur me një ngjarje të vërtetë në kohë lufte në Luzni, hasmërinë midis dy fiseve në fshatrat përballë njeri tjetrit Arap i Poshtëm dhe Lishan i Poshtëm, ngjarje që Dritëro Agolli e shndërroi në art për ta bërë të njohur në rang kombëtar...

*
* *

Atë ditë, e premte 9 prill 2010, trokita në portën e "Kullës Agolli" pa e njoftuar më parë e pa lënë takim. Një ngatërresë në numrin telefonik, e zakonshme për ne ikanakët të mësuar me numra me pesë shifra të Tiranës, më detyroi ti bije ziles, ndoshta sa për t'i dhënë Sadijes në këmbë dy librat e mi të fundit, njeri prej të cilëve, "Rilindësit e kohës sonë – 2" ishte i pagëzuar nga shkrimtari ynë i madh.

Zëri i Sadijes, si zëri i grave burrnesha të kullave të moçme shqiptare, më ftoi menjëherë tu ngjitem shkallëve e të hyj në derën gjithnjë të hapur të familjes Agolli...

Ulur në të njëjtin kolltuk, si një lis i moçëm me rrënjë të thella, Dritëro Agolli...

Përqafohemi, shkëmbejmë buzëqeshjet e zemrës, flasim për shëndetin, ngremë rakinë e sapo shërbyer, gjerbim kafenë e Sadijes...

I ve përpara librat "Shkolla shqiptare e Athinës-Rilindësit e kohës sonë-2" dhe "Po Dibrës! Jo Skavicës"...

Kuvendojmë...

*
* *

A. Ashiku: Me Skavicën mbytet e gjithë fusha e Dibrës, i them ndërsa ai shfleton librin, mbytet e gjithë historia e Dibrës, histori që është e lidhur me Skënderbeun por edhe me ngjarje të tjera të mëdha. Por mbytet edhe "varri" i Mato Grudës, atje tek Matet dhe Grudet në Luzni...

D. Agolli: Pse edhe Luznia mbytet?

A. Ashiku: Mbytet Fusha e Luznisë, Katundi i Ri mbytet tërësisht kurse Hoteshi pjesërisht...

D. Agolli: Po.

A. Ashiku: Desha që të kthehemi pak në kohë, atëherë kur ishit gazetar në "Zërin e Popullit", kur u ngjitët në Malin e Luznisë dhe mësuat historinë e njeriut me top, Manuket që goditën Meret dhe bëtë romanin "Njeriu me top". Unë, siç e shikoni kam bërë një libër ku i them Jo Skavicës sepse mbyt një qytetërim të tërë dhe kërkoj që të shihet një tjetër alternativë, alternativa e hidrocentraleve mbi lumenjtë, degë të Drinit. Me që jeni devolli më ngjan se Skavica si rezervuar është si ti vesh një pritë Devollit në Maliq, të mbytësh gjithë fushën për hir të hidrocentraleve që do të bëhen në kaskadën e Devollit.

D. Agolli: Ta vësh në Cangonj.

A. Ashiku: Duke hedhur një vështrim tek e kaluara do të desha këndvështrimin tuaj për këtë gjë. Si e gjetët "Njeriun me top në Luzni", si e krijuat Mato Grudën dhe plakun Mere? Si i morët emrat e fiseve dhe i bëtë personazhe të romanit?

D. Agolli: Atje mbi... në fshatin Arapaj...

A. Ashiku: Arap i Poshtëm. Arap i Poshtëm dhe Lishani i Poshtëm vendet ku është zhvilluar ngjarja reale...

D. Agolli: ...Një njeri i familjes së tyre, të Mereve, kishte shkruar gjithë historinë e familjes, hasmëritë. Bënte fjalë në ato shënime edhe për një top të artilerisë së lehtë që tërhiqej me kuaj që e kishin gjetur pas rënies së Italisë fashiste dhe e kishin marrë me vete me qëllimin të marrin hak ndaj asaj shtëpie që ...pala tjetër dua të them...

A. Ashiku Manuket me Meret...

D. Agolli: Po. Këta e kishin marrë që kur të vinte rasti ta qëllonin me top këtë shtëpi sepse ajo ua kishte zhdukur gjithë njerëzit. Ajo ishte një fletorkë me kapak të zinj siç ishin atëherë fletoret, si bllok. E këtij formati ishte sa i këtij libri. Ai shkruante me një vërtetësi të madhe të gjitha ngjarjet si kishin ndodhur. Atje ishte një gazetar i "Zërit të Popullit", Osmani...

A. Ashiku: Osman Allkja. E njoh, e kam mik.

D. Agolli: Ai, Maneja, se Mane i thosha unë, pasi i tregova për fletorkën më tha se unë kam këtë fletore. Ma dha ky fletoren. Nuk e mora unë vetë. Unë kam një fletore më tha dhe do të ta sjell, po të asaj shtëpie të Manukëve. Ma dha fletoren. Unë e mbajta gjatë atë fletore. Fletorja mbeti në sirtarin e tavolinës time në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe nuk e di ku përfundoi. Pas disa vjetëve mendova, më lindi ideja, për të bërë romanin "Njeriu me top". Doemos unë ia ndërrova emrat, por Meres nuk ia ndërrova. E vura Mere se më dukej kështu shumë ekzotike dhe një emër që nuk i përkiste feve të ndryshme që kemi këtu ne. Mere mund të jetë edhe nga vende të tjerë, edhe francez mund të jetë. Apo jo?

A. Ashiku: Po.

D. Agolli: Kështu mora këtë sepse ishte asnjanës. Mere, ne andej kemi shkurtimin e Remes, Muharrem ose Mere i themi, apo një emër tjetër që mbaron me këtë. Prandaj mora emrin, mora edhe ngjarjen dhe u shkrojt ky roman. Pasi u botua romani, Viktor Gjika, tashti ka vdekur dhe vdiq i ri, relativisht shtatëdhjetë vjeç, regjisor shumë i mirë, nga më të mirët që kemi ne e që kemi pasur dhe nuk besoj të zëvendësohet lehtë. Viktorit i pëlqeu si ngjarje dhe më tha se unë do ta bëj këtë film por më bëj ti skenarin. Unë i thashë më mirë bëje vetë se unë çfarë kisha për të thënë i thashë në roman. Në ndonjë gjini tjetër këtë nuk e hedh dot prandaj merre dhe bëj çfarë të duash. Ai e bëri vetë skenarin duke ia parë edhe unë, duke precizuar disa ngjarje vetëm për ti dhënë disa konsultime, jo si redaktor. Kështu u bë filmi Njeriu me top.

A. Ashiku: Mato Gruda. Në Luzni janë dy fise Matet dhe Grudet...

D. Agolli: Mato është emër shqiptar, veçanërisht në bregdet. Ka Mate në Çorraj, në Sasaj...

A. Ashiku: Ashtu siç ka shumë edhe në Dibër.

D. Agolli: Edhe Jakupi që ishte, ti e njihje Jakup Matën. E bëra në atë mënyrë që të ndjehej se ishte në të gjithë Shqipërinë jo vetëm në atë krahinë. Kjo mund të ishte edhe nga Devolli, edhe nga Labëria, edhe nga Veriu prandaj i përzjeva këto edhe Grudë edhe Mate në mënyrë që të mos thoshin të tjerët se ja na e ka bërë krahinën tonë kështu. Megjithëse në përgjithësi tendenca e romanit ishte pozitive. I lanë hasmëritë dhe luftuan kundër një pushtuesi të përbashkët. Kështu lindi ky roman. U botua me tirazh të madh, u shit brenda një jave. Është ribotuar disa herë...

A. Ashiku: Është botuar edhe në revistën "Nëntori"...

D. Agolli: Një pjesë, jo i gjithë, disa fragmente. Nuk më kujtohet në "Nëntori" apo në "Drita". Është ribotuar disa herë dhe u përkthye në Francë, në Siri, në Bullgari dhe në disa vende të tjera. Ka bërë jehonë edhe në vende të tjerë. Kështu është historia e këtij romani.

Prill, 2010

Hamdi Kacani dhe ambulanca e Dibrës



Në odën dibrane, po qe se dikush përmend emrin e Hamdi Kacanit, të gjithë do të luajnë vendit e fjalët për të do të marrin rrjedhën e Drinit. Nuk kishte shkollë Hamdi Kacani, shkollë ulur në bankë me libra, fletore, kalem e penë në dorë. Nuk kishte laps Hamdi Kacani të shkruante udhëtimet e tij maleve të Dibrës, pranë njerëzve e me njerëzit në ditë të vështira shëndetësore, në 35 vjet punë, me ta e për ta...

I kam bërë një fotografi Hamdiut me ambulancën e tij. Nuk e kam intervistuar, as kam bërë ndonjë shkrim për heroikën e tij në atë profesion ku humanizmi dhe dashuria për njeriun ngjitet e nuk zbret. Shofer ambulance ishte Hamdi Kacani, shofer me një makinë ruse OAZ 4x4,DI 91 14 ardhur nga fillimi i viteve pesëdhjetë. Një jetë të tërë mbi katër rrota e me timonin ndër duar. Po, po, një jetë të tërë, derisa doli në pension. Madje, edhe kur erdhën kohë të reja, kur filluan privatizimet, ai e mori makinën e jetës së tij, siç merret një fëmijë nga "shtëpia e fëmijës" e bëhet gjak i familjes... Ishim komshinj, në një pallat me Hamdiun.

Në këndin e drejtë që formohej nga takimi i dy pallateve shikoja çdo ditë Hamdiun dhe makinën e tij të bardhë. E pashë derisa iku në qetësinë e një njeriu që dashuronte punën e tij, siç dashuronte fëmijët, siç dashuronte njerëzit...

Nuk e di se çfarë kushtesh duhen për të qenë pjesë e "Librit Ginis", por Hamdi Kacani me autoambulancën e tij janë për tu shënuar pa asnjë dyshim.

Dibra është një ndër zonat më të prapa në rrugëtimet drejt njerëzve, fshatrave e zonave të largëta. Peshkopia, qendra e Dibrës, ka parë asfaltin e rrugës që e lidhte me Tiranën dhe Shqipërinë, vetëm në mes të viteve shtatëdhjetë kur u lidh me Bulqizën me një rrugë njëkalimshe... Rrugët e tjera në hapësirën prej 1600 kilometrash katrorë, nga Llanga në Qafë Draj e nga Qafa e Buallit në Kala të Dodës, Selishtë,Lurë e më gjerë, ose ishin rrugë të shtruara me kalldrëm e me pak zhavorr sipër ose ishin thjesht rrugë verore me heroikë lëvizjeje verës e me sakrifica tej njerëzore dimrit. Afër, afër edhe sot kështu janë...

Autoambulanca e Hamdiut nuk pyeste këtyre rrugëve, ditën dhe natën, në shi e dëborë, në lagështi e në akull. Sekreti ishte i thjeshtë. Hamdiu e konsideronte autoambulancën si pjesëtare të familjes së tij, si fëmijë që kërkonte kujdesin e prindit për tu rritur i shëndetshëm. Ato orë midis dy thirrjeve urgjente për udhëtim tek të sëmurët Hamdiu ishte nën e në makinën e vet, me vështrimin në gjithçka që duhej kontrolluar e rregulluar. Asgjë nuk i shpëtonte kujdesit të tij...

Në vitin 1985 në spital vjen një ambulancë e re prodhim Rumun. Ia dhanë Hamdiut. Bëri me të një rrugë në Bulqizë. E ktheu. Kërkoi prapë OAZ-in. "Kjo nuk të çon në Lurë, Kala të Dodës, Selishtë, Reç, Trebisht..."- u tha.

OAZ-i me dy diferencialë, nën kujdesin e vazhdueshëm të tij, i dinte më mirë rrugët e Dibrës, verës dhe dimrit, në shi e në dëborë... Mbase nuk do ta kujtoja Hamdi Kacanin larg e larg vendlindjes time në mërgim ku jamsikur gjatë skanimit të mbi gjashtë mijë negativave të jetës time, të mos e gjeja në një pozim diku tek ura e Muhurrit në krah të rrjedhës së Drinit të Zi...

A. Ashiku

Botuar me shkurtime. Opinionin e plotë e gjeni në linkun: \http://www.javanews.al/hamdi-kacani-dibres-dhe-frroku-ambulances-se-tiranes/

Rruga e Arbërit nr. 130

"Të rinj - të talentuar"

Është rubrika më e re në gazetë, ideuar nga Samet Zagradi, një nga bashkëpunëtorët tanë më të rinj. Kjo rubrikë e re synon të na njohë me të rinjtë dibranë që me punën e tyre po korrin sukses në fusha te ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Rubrika do të shërbejë për të njohur më shumë vlerat që ato mbartin si dhe për të qenë një shembull për të gjithë të rinjtë me suksesin e tyre. Dibra ka mjaftë të rinj të talentuar, dhe ne shpresojmë që në numrat në vazhdim t'ju njohim me sa më shumë prej tyre. Me qëllimin e mirë që t'u japim mbështetje për të ecur përpara, por edhe për të na frymëzuar me punën me shembullin e tyre.

Këtë numër do t'ju njohim me dy prej tyre, gazetaren e re dhe të talentuar

Ida Nurçe dhe pedagogun e ri, Erduan Kllobuçishta.

Ida Nurçe: Me punë mund të arrish ku të duash

- A mendoje që një ditë do ishe e njohur?

- Unë nuk jam aq akoma aq e njohur. Më duket akoma herët dhe padyshim që kam akoma goxha punë për të bërë.

- Kush është Ida larg profesionit të gazetares?

- Është një gocë shumë impulsive, jashtë mase kokëfortë, shumë e shoqërueshme dhe shumë më e ndjeshme nga se duket.

- Ju jeni gazetare në një nga televizionet më të njohur të vendit dhe për më tepër e një emisioni investigativ. Çfarë ndjesie ke për këtë fakt?

- Nëse do të më pyesje dy -tre vite më parë, ndjesia do ishte e papërshkrueshme. Ndërsa tani është një ndjesi krejt normale, sepse kam punuar për të qenë aty. Sigurisht, është kënaqë si të punosh në një televizion kombëtar tepër të njohur. Me punë mund të arrish ku të duash.

- Ti promovon dhe pranon vlerat e Dibrës ashtu siç jeni një "fanatike" e dialektit dibran? Përse e bën këtë?

- Unë e kam shprehur hapur që jam patriote dhe e dua vendin tim. Ai vend është një ndër më të bukurit dhe ka vlera, që jo të gjithë i dinë. Unë gjithmonë do të jem krenare që jam dibrane, pasi mendja fle në atë zonë.

- Cilët kanë qenë vështirë sitë që ti ke hasur në fillimet e tua?

- Në fillim e kam pasur shumë të vështirë, pasi në Tiranë kam ardhur krejt e vetme. Nuk kam pasur askënd që të më japë një dorë ndihmë.

Dy muaj kam ecur rrugëve të Tiranës duke shpërndarë CV-në time nëpër televizione dhe gazeta të ndryshme, dhe pse isha pa asnjë përvojë pune. Pastaj kam punuar në një gazetë pa rrogë, vetëm për të fituar eksperiencë, për afro 6 muaj. Ditë sa të bukura, aq edhe të vështira për mua. Por në fund ja dola, pasi ajo ishte një trampolinë për mua drejt televizionit. Duke filluar me Ora News si gazetare sociale, pastaj ne News 24 tek emisioni "Kaktus" dhe si përfundim tek Tv Klan, emisioni "Stop".

Të integrohesh në një shoqëri kaq ndryshe nga ajo jemi mësuar ne të rinjtë dibranë, është absolutisht e vështirë, pasi në Dibër është një mentalitet komplet tjetër. Plus, te shohin edhe me atë syrin si "Maloke". Por është një gjë: duhet të mbyllësh sytë dhe veshët dhe të merresh vetëm me objektivin që i ke vënë vetes. Vetëm kështu mund të ecësh përpara. Në fillim duhet të dish çfarë do, pastaj të dalësh atje jashtë dhe ta marrësh. Është një botë shumë e egër dhe duhet të luftosh shumë.



Gjëja e parë që do të bëja është "Rruga e Arbrit", sepse është një mankth i vërtetë të ndash mendjen të vish në vendlindje...

- Çfarë të mungon nga Peshkopia dhe në qoftë se do të jepet mundësia do të jetoje gjithmonë këtu?

- Nga Peshkopia më mungon qetësia, ajri i pastër dhe njerëzit mikpritës. Nëse do mundesha të ndiqja ëndrrën time, atje sigurisht që do jetoja. Unë jetoj atje ku janë ëndrrat e mia.

- Në qoftë se do të kishe shkopin magjik, cilat do të jenë 3 gjërat që do të bëje për vendlindjen?

- Gjëja e parë që do të bëja është "Rruga e Arbrit", sepse është një mankth i vërtetë të ndash mendjen të vish në vendlindje dhe të mendosh që do të ecësh katër orë sipër një rruge të shkatërruar. Do i kisha kushtuar shumë rëndësi turizmit malor, pasi vendi jonë ka malin më të lartë në Ballkan, Korabin që është pak i promovuar. Dhe së fundi, do të kisha ndryshuar mentalitetin që ndrydh shumë femra për të ndjekur ëndrrat e tyre.

- Cili është mesazhi juaj për të rinjtë e Dibrës?

- Mendoj se të rinjtë dibranë janë më të zgjuarit e moshës së tyre dhe kanë edukatën, që nuk e ka rinia e shumë vendeve të tjera.

Gjithashtu, më pëlqen edhe fakti, që nuk janë të ç'thurur, siç janë të rinjtë e qyteteve të mëdha, por janë familjarë. Unë do t'u thoja vetëm një gjë: Fatkeqësia më e madhe është talenti i çuar dëm, ndaj zbukurojeni atë dhe punoni fort për të. Mos nguroni të guxoni sepse mund të fitoni ose të humbisni. Po nuk guxuat të humbur jeni, gjithsesi.

Erduan Kllobuçishta: zbuloni pasionin dhe bëni ndryshimin!



Dibra dhe Peshkopia dikur kanë qenë të njëjta. Për mua vazhdon akoma.

ufizohen si gjetje të mundësive reale në bazë të nevojave që ne kemi në shoqërinë ku ne ndodhemi. Shpeshherë gjërat e mëdha nuk maten me vite, por me aftësinë për të bërë gjërat në mënyrë sa më efektive dhe produktive...

- Erduan, ju jeni psikolog dhe keni punuar disa vite si pedagog, hartues dhe zbatues i disa projekteve në organizata të mëdha, dhe je vetëm 29 vjeç. Si mundet të korrësh një tërësi suksesesh në kaq pak kohe?

- Po është e vërtetë. Ka të bëj me individin, me faktorin social dhe tek çdo njeri kjo shfaqet në nivele të ndryshme. Personalisht, çdo herë kam nisur me idenë se çfarë duhet të ndryshoj tek vetja dhe cilat janë nevojat në rrethin në të cilin unë gjendem. Arritjet e mia sado që të jenë, në fund përkufizohen si gjetje të mundësive reale në bazë të nevojave që ne kemi në shoqërinë ku ne ndodhemi. Shpeshherë gjërat e mëdha nuk maten me vite, por me aftësinë për të bërë gjërat në mënyrë sa më efektive dhe produktive. Nuk kam parë si diçka të pamundur. Fjala e pamundur është në fjalorin e të paditurit. Mendoj se njeriu me vullnet dhe përkushtim mund t'ja arrijë çfarë do që të jetë, por varet se çfarë qëllimi individi i ka vendosur vetes në jetën e tij.

Qëllimi i suksesit tim nuk është të nxjerr në treg produktin, por të nxjerr vlerën e saj në jetën tonë. Nuk duhet menduar shumë suksesi sepse nëse ndodh kjo, në anën tjetër mendon dhe dështimin. Nëse ti mendon se rrethanat që ti ndodhesh janë faktor i dështimit tënd, ato janë duke të kontrolluar ty. Qëllimi është të sfidosh dhe zotërosh atë që quhet e pamundur. Por ajo që me intereson në të tanishmen dhe të ardhmen është progresi, dhe të parit gjërat në një perspektivë tjetër. Çdo gjë është e mundur kur ke pasion.

- Çfarë përfaqëson Erduani larg profesionit të tij? Kush është ai?

Më pëlqen të lexoj jashtë profesionit libra të ndryshëm, romane, sidomos nga fusha e biznesit. E kam pasion udhëtimin dhe shpesh praktikoj turizmin malor. Di të them se çfarë jam i aftë të bëj. Se kush jam nuk di të të them saktësisht, jeta jonë është një proces ndryshimi. Çdo moment që kalon ndërton fatin tënd, ndërton karakterin tënd. Jeta është transformim, kalim nga një gjendje tek një gjendje tjetër. "Se kush jam", definohet me gjendjen se sa mirë ndjehesh me veten tënde, se sa mirë të tjerët ndjehen me ty. Ne kemi polaritete në veten tonë. Shfaqemi ndryshe në rrethana të ndryshme. Nuk mund ta përcaktoj fatin tim thjeshtë nga një moment apo rrethanë të caktuar. Jam akoma në kërkim të vetes...

- Gjatë gjithë kësaj rruge normalisht që ke pasur dhe pengesa apo vështirësi. Cilat kanë qenë disa nga ato?

- Normalisht se dështimet janë ato që faktorizojnë suksesin tënd. Por në rastin tim, dua të them se nuk ekzistojnë dështimet, por mësime dhe leksione nga to. Më shumë se sa dështimet në profesionin e psikologut, ka të bëj me aplikueshmërinë e saj në shoqërinë tonë. Vetëdijësimi është në ngritje e sipër, por akoma do kohë që të arrihet një kuptim i duhur në shoqërinë tonë për këtë profesion.

- Cila ka qenë puna qe të falte më shume emocion.

- Të qenurit një pedagog është një "luks" intelektual dhe ti jepet dikujt në moshë të hershme është një përvojë e pazëvendësueshme. Në përvojën time rol parësor luan individi, si i tillë edhe studenti për mua ka luajtur një rol të rëndësishëm.

- Një pjesë e madhe të rinjve kanë perspektivë të studiojnë për psikologji. Çfarë do t'u sugjeroje ti dhe sa vlerësohet figura e psikologut në shoqërinë tonë?

- Profili i psikologut nuk është sikurse rrëfimi tek prifti apo hoxha. Ajo është shkencë dhe në të njëjtën kohë është dhe art. Sa i përket këtij profili nuk duhet të jetë zgjedhja e fundit. Ajo determinon fatin tënd dhe të të tjerëve. Profili i psikologut nuk është nga ato profesione që të pasurojnë financiarisht, por të bën të vlerësosh potencialet e tua dhe të vlerësosh drejtë jetën tënde dhe të të tjerëve. Së fundmi me urdhrin e psikologut, profesioni jonë tashmë ka kush ta përfaqësoj dhe kemi vendin tonë në shoqëri si profesionist.

- Jeni lindur në Dibër të Madhe dhe pothuajse jeton ne Peshkopi. Cilat janë disa nga ndryshimet mes dy Dibrave?

- Dibra dhe Peshkopia dikur kanë qenë të njëjta. Për mua vazhdon akoma.

- Ke do falënderoje për suksesin tënd?

- Familjen dhe gruan time.

- Të rinjtë sot janë disi si të mpirë nga situatat që po kalon vendi jonë. Si psikolog cilat do ishin disa nga këshillat tuaja për ta?

- Është e vërtetë se faktori ekonomik luan një rol të rëndësishëm në jetën tonë, por jo çdo herë ajo është determinues. Të gjithë të rinjtë duhet të fokusohet dhe pyetja se "çfarë dua unë", duhet fokusuar tek mundësitë reale që ato kanë. Kurrë nuk duhet lejuar që të tjerët tu definojnë se çfarë ju mund të bëni, por gjeni pasionin tuaj dhe bëhuni ndryshimi i vërtete së pari për veten dhe familjen tuaj, pastaj shoqëria di të bëj vlersimin e vet.

SPECIALE ARSIM

Një shekull e tre dekada arsim shqip

Arsimi në Dibër, nga mësimi i shkronjave shqip ,te përdorimi i teknologjisë

Nga **Alban TUFA**



Të dhënit dije është akti më sublim që mund të bëjë njeriu, e ky akti veç prindit, i është besuar edhe mësuesit. Arsimi, dhënia dhe nxënia e dijes, si proces dhe si formë trashëgimi, ka kaluar në kalvarin e vuajtjes, mundit, vështirësive dhe sfidave të ndryshme.

Shkolla e parë shqipe ne Dibër u hap në vitin 1888 nga Said Najdeni. Kjo shkollë qe ilegale dhe nuk zgjati shumë. Pesë vite më vonë ai e rihapi atë shkollë sërish. Kjo shkollë qe pika e fillimit të arsimit shqip në Dibër. Fill pas saj, u çel një shkollë tjetër shqipe në Gollobordë, pastaj në Maqellarë, Dohoshisht, Brezhdan, Homesh dhe Grykë e Vogël. Seid Najdeni pajisi shumë dibranë me Abetare, si nga ato të hartuara nga Kostandin Kristoforidhi por edhe me ato të hartuara nga Sami Frashëri, dhe bashkë me dijetarë e atdhetarë të tjerë i dhanë kahje arsimit shqip në Dibër.

Hapja se shkollave të tjera nuk u ndal edhe pse u përballën me vështirësi të mëdha. Kështu që prej vitit 1888 dhe deri në vitin 1899 kishin mësuar tashmë shkrim dhe lexim shqip mbi 300 dibranë. Kështu në krahinën tonë veç alegorisë po mësohej edhe gjuha shqipe. Kontributi i dibranëve në Rilindjen Shqiptare qe i madh dhe njëkohësisht dëshmi se ky vend ka qenë pikë kyçe për lëvizje patriotike dhe arsimore. Kuvendet dhe Lidhjet që u mbajtën në Dibër por jo vetëm, forcuan rolin e arsimit duke i dhënë kështu prioritet dhe duke e parë si të vetmen rrugëzgjidhje për formësimin e shtetit të ri shqiptarë.

Ndërsa më 14 Prill 1914 hapet shkolla e parë shqipe e ligjshme në Peshkopi me mësues Haki Sharofin. Mandej po në prill të vitit 1923 hapet shkolla e parë femërore me mësuese Nazmie Palloshin.

Shkolla e mesme e përgjithshme e filloi punën e saj në vitin shkollorë 1962 – 1963. Mësimet u zhvilluan në hapësirat e shkollës (asokohe) 7 – vjeçare "Demir Gashi" me drejtor z. Hilmi Sadikaj. Nga matura e parë e kësaj shkolle në vitin shkollorë 1965 – 1966 vijuan studimet e larta 29 nxënës, nga të cilët: 13 nxënës në Universitet dhe 16 në Institut.

Por këto janë vetëm fillimet për të vijuar më pas në sistemin e konsoliduar 12 vjeçar ku mësimet u zhvilluan në hapësirat e shkollës Pedagogjike, (aty ku sot është ish filiali i Universitetit të Durrësit) pastaj aty ku është sot. Kjo shkollë mban emirn "Seid Najdeni".

Shkolla e mesme profesionale "Nazmi Rushiti" është hapur për herë të parë si shkollë pedagogjike në vitin 1945.

Me kalimin e viteve ajo ka ndryshuar drejtimet mësimore si: bujqësor, artistik dhe pedagogjik (deri në vitin 2011).

Në viti 2004 mori fizionominë me këto drejtime mësimore: Ekonomi (biznes); Ekonomi (administrim zyre); Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Arsim i kombinuar (Mekanik, Elektroteknik dhe Përpunim druri).

Më parë, ajo ka patur status lokal, por nga 1 Janari 2015, si të gjithë shkollat e tjera profesionale, gëzon të drejtën e njësisë së veçantë menaxhuese të buxhetit dhe burimeve njerëzore. Ky status i ri, rrit mundësinë për të krijuar kushte më të mira në mësimdhënie/nxënie, etj.

Shkolla profesionale "Nazmi Rushiti", frekuentohet jo vetëm nga nxënës të qytetit por edhe nga nxënës të zonave rurale te Qarkut Dibër, kryesisht nga komunat: Maqellare, Melan, Tomin, Kastriot, Sllovë, Kala e Dodës, Luzni, Lurë, Muhurr dhe Luzni.

Ajo frekuentohet gjithashtu edhe nga nxënës të komunave e rretheve, Mat dhe Bulqizë.

Sot Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër së bashku Zyrat Arsimore Mat dhe Bulqizë ka nën juridiksionin e saj, dhe administron: në arsimin parashkollor 145 kopshte me 4238 fëmijë nën kujdesin e 247 edukatorëve.

Ndërsa në arsimin 9-vjeçar 96 drejtori shkollash me 25159 nxënës dhe 1580 mësues.

Në arsimin e mesëm: me kohë te plotë 24 shkolla (gjimnaze 8, te mesme të bashkuara 14, profesionale dhe tekniko profesionale 2) me 6603 nxënës dhe 318 mësues.

TEKNOLOGJIA DHE POLITIKA, PENGESË PËR ARSIMIMIN?!

Përpos këtyre arritjeve me mund e sakrificë, viteve të fundit shfaqen probleme të mëdha në arsim jo vetëm në Dibër por kudo në Shqipëri. Futja e teknologjive të reja, siç është bërë domosdoshmëri, është bërë edhe pengesë për zhvillimi normal të orëve të mësimit. Studime të shumta janë bërë në vendet perëndimore në lidhje me ndikimin e tabletëve dhe celularëve në mbarëvajtjen e studimit. Nga kjo ka rezultuar që këto pajisje janë vërtet pengesë duke i shpërqendruar nxënësit. Ky problem vetëm shtohet dhe nuk dihet se sa do ti ketë përmasat dhe ndikimit në vitet në vazhdim.

Një problem tjetër evident dhe shqetësues është se sa herë ndërrohen qeveritë, ndërrohen të gjitha strukturat e arsimit. E gjitha bëhet nga maja e hierarkisë deri tek edukatorët.

Studiuesi Haki Përnezha, me një eksperiencë 42-vjeçare si më mësues, thekson: "Vështirësitë e punës me fëmijët gjithnjë janë prezente. Çdokush që ka një përvojë në këtë profesion, ka plotë për të thënë. Ne mësuesit, por edhe çdonjeri, ka konstatuar se ndryshimet në sistemin politik si dhe zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë e informacionit, e kanë vënë mësuesin gjithnjë e më shumë para vështirësive, gjithnjë në rritje për sa i përket problemit të tejçimit të informacioneve te fëmijët.".

Kjo i çon nxënësit në një destabilizim të ecurisë së tyre. Pra përzierja e politikës me arsimin e çrregullon këtë sistem, madje aq sa edhe duke i përdorur këta nxënës edhe për fushata zgjedhore. Diçka e tillë është vënë re në çdo fushatë zgjedhore.

Por mbi të gjithë problemet që karakterizohet arsimi, jo vetëm në Dibër, Përnezha shprehet: "Nëse do të pyesim dikë për këtë problem, shpesh merr përgjigje të tilla: "...cilësia ka rënë, fëmijët s'dinë tabelën e shumëzimit,... shkruajnë keq...etj, etj". Këto fenomene hasen te nxënësit tonë sot, por nuk duhet të harrohet se "kurrikula" e shkollës nuk është ajo e para 40 viteve, sot fëmijët marrin informacione të zgjeruara në shumë disiplina që në klasën e parë, apo kopësht, pale më në klasat e mëtutjeshme. Në shkollë punohet dhe kjo punë matet lehtësisht me anë të sistemit të kontrollit e vetkontrollit që funksionon në sistem.".

Një qasje tjetër sjellin disa mësues të ciklit të ulët shprehen se nxënësit e tyre dinë më shumë se ata kur ishin në moshë të tyre.

Po të vëresh, literatura e tyre është shtuar, dhe çantat ju rëndojnë më shumë. Futja e anglishtes si lëndë që në klasë të tretë, por edhe përdorimi i mjeteve të reja të komunikimit, kanë sjellë vitet e fundit dhe në fshatrat më të thellë të Dibrës, aromën e globalizmit.

Kjo në thelb, kjo e ka forcuar edhe më tej rolin dhe rëndësinë e edukatorit/mësuesit në aspektin e rekomandimit dhe sugjerimit të informacionit. Por, nga ana tjetër e ka vështirësuar punën e tyre, sepse nga kjo morì informacionesh dora e mësuesit është delikate dhe vendimtare.

"Ne jemi të prirur të "fajësojmë" mësuesit. Jemi ne ata që duhet të zgjojmë te fëmijët dëshirën dhe interesin për të mësuar. Në mesin tonë ka plotë prej atyre mësuesve që nxënësit e presin orën e tyre me dëshirë, ashtu sikurse ka edhe prej syresh që transmetojnë vrazhdësi e për pasojë edhe emocione negative. Sidoqoftë, mësuesit e kanë të qartë se puna më fëmijët së pari është art dhe artin nuk e bën kushdo", thotë mësuesi me eksperiencë të gjatë, Përnezha

Megjithatë, një gjë është e sigurt, sepse mundi i atyre që hapën shkolla ilegale dhe mësuan dorazi dhe nëpër bodrume gjuhën shqipe, është shpërblyer dhe po shpërblehet dita-ditës. Nga dyert e shkollave në Dibër, kanë dalë me qindra figura të shquara: të artit, sportit, shkencës etj, siç di ai vatan të nxjerr burra me mend.



"DIBRA NË HULLI TË HISTORISË" është një botim në tre vëllime që i kushtohet arsimit në trevat e Dibrës. Libri me mbi 1200 faqe është një vështrim i zhvillimit të arsimit nga lashtësia deri në vitin 1912 (vëllimi i parë), zhvillimin e arsimit në vitet 1912-1944 (vëllimi i dytë) dhe arsimi në vitet 1944-1990 (vëllimi i tretë).

Xhemal Domi lindi në fshatin Ceren të Kalasë së Dodës më1 maj 1937 në një familje intelektuale me tradita kulturore patriotike. Arsimin fillor dhe 7-vjeçar i mori në vendlindje, në Kala të Dodës. Arsimin e mesëm e kreu pjesërisht në Elbasan (vitin e pare e të dytë) dhe pjesërisht në shkollën pedagogjike në Peshkopi (vitin III-IV), ku dhe u diplomua shkëlqyeshëm. Arsimin e lartë e kreu në Tiranë në Fakultetin Histori - Filologji.

Që në moshën 15-vjeçare, pasi kaloi një kurs përgatitor tremujor në Shkodër, filloi punën me përkushtim si mësues fillimisht në Radomirë (1952), pastaj në Ceren (1953-1954), në Mustafaj (1954-1955). Pasi kreu shërbimin ushtarak (1956-1958), emërohet përsëri mësues ku shërben në Gjurrë-Reç (1959), në Ploshtan (1961-1965), në Radomirë (1965-1966) dhe me hapjen e shkollës 8-vjeçare në Radomirë ishte drejtori i parë i saj (1966-1968).

Më 1968 shkarkohet si drejtor shkolle dhe transferohet në Lashkizë të Zall-Dardhës ku hapet shkolla 8-vjeçare, nga ku pas një muaji transferohet në shkollën 8-vjeçare në Shumbat, ku shërbeu tri vjet rresht

duke përballuar kushtet e vështira ekonomike dhe atmosferike.

Gjithkund që punoi, është dalluar për punë vetëmohuese dhe arritje të arta sasiore e cilësore në procesin mësimor-edukativ. Është nderuar me instiktivin "Mësues i dalluar" nga Ministria e Arsimit si dhe me medaljen dhe Urdhrin "Naim Frashëri" nga Presidiumi i Kuvendit popullor.

Nga viti 1973-1976 ishte zv.drejtor dhe pastaj drejtor i shkollës 8-vjeçare dhe të mesme (1976-1983), drejtor 8-vjeçarje (1983-1990) dhe mësues në shkollën e mesme Ceren deri sa doli në pension (1990-1993).

Është autor i disa punimeve shkencore si: - Historiku i shkurtër i Kalasë së Dodës (1981). Një vështrim i shkurtër mbi të vërtetën historike të Shqipërisë veri-lindore – 1918-1925, "Beteja e Kalasë së Dodës përmbysi planin e Zogut për t'u riorganizuar në Dibër" referuar në Peshkopi, - 1974 dhe në Bajram Curr 1975, "Mbi bajraktarizmin dhe shfaqjet e tij në kohën e sotme" (1980) etj. Në 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit referoi në Shkodër e Peshkopi temën "Malësitë e Veriut force goditëse dhe prapavijë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" (1978).

Vepra e tij madhore është "Dibra në hulli të historisë - Historia e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat dibrane dhe rreth saj".

Librin mund ta gjeni pranë librarisë së Botimeve M&B

1 vëllim kushton 1000 lekë

Kush është Shemsi Manjani, për ata që nuk e njohin pjesën sportive të tij, por kanë njohur më shumë atë pedagogjike dhe të drejtimit, si në seksionin e arsimit të dikurshëm, ashtu edhe në gazetën lokale "Ushtima e Maleve".

profil

Shemsi Manjani - njeriu universal i sportit

Nga **DEFRIM METHASANI**

Me Shemsi Manjanin, takimin e kishim lënë në orën 10, por ai si një prej atyre njerëzve që binjak në jetë kanë korrektesën, erdhi disa minuta më shpejt. Fillimisht nuk e njoha, sepse me një motor "Vespa" ecte shpejt dhe bukur, a thua se ishte në një moshë të re. Është 83-vjeç dhe është shpallur vespisti më i mirë në Shqipëri, prej shoqatës së motoristëve të motorit "Vespa" në 70-vjetorin e kësaj shoqate. Një lajm vërtet që të bën përshtypje, kur mëson prej tij se mosha aktuale është 83 vjeç. Një formë fizike për t'u admiruar, por edhe një kujtesë fenomenale që ja kisha zili. Ai rrëfen saktë, sikur gjërat kanë ndodhur vetëm para pak ditësh, ose muajsh dhe jo para gjashtë, apo shtatë dekadash. Në fakt qëllimi im, ishte rikthimi në vite dhe gjuha e fakteve të historisë së futbollit dibran, veçmas në vitet 60-61, kur ngjiste shkallët e cilësisë dhe Korabi bëhet pjesë e elitës së asokohe, pra brenda ekipeve të kategorisë së parë. Kjo për një arsye të thjeshtë, sepse për fatin e mirë, Shemsiu jeton dhe është një muze i gjallë i asaj historie, si një prej ish futbollistëve cilësore të formacionit të Korabit në vitet kur skuadra ishte në kategorinë e parë. Por cili është Shemsi Manjani, për ata që nuk e njohin pjesën sportive të tij, por kanë njohur më shumë atë pedagogjike dhe të drejtimit, si në seksionin e arsimit të dikurshëm, ashtu edhe në gazetën lokale "Ushtima e Maleve".

FILLIMI I NJË JETE SPORTIVE

Zanafilla e tij me sportin, nis që në vitin e 3-të kur ishte nxënës në shkollën pedagogjike. Ishte viti 1951 dhe Manjani





futet në ekipin përfaqësues të Dibrës në futboll, ekip që ishte krijuar vetëm një vit më parë. Një futbollist ndoshta jo shumë shtatlartë, por një mesfushor dhe gjysmësulmues tipik.

Pas dy vitesh, pra në vitin 1953, Shemsi Manjani shkon në shkollën e lartë në Tiranë. Dega e tij ishte gjuhë-letërsi, por pasioni për sportin, bënte që të luante njëherësh në disa lloj disiplinash sportive. Kësisoj ai bëhet pjesë e ekipit të shkollës, duke kontribuar njëherësh në futboll, volejboll dhe ping-pong. Manjani kujton sot me nostalgji, dy miqtë e mirë të tij, njëherësh dy emra personalitetesh të sportit shqiptar, Pandi Gëllçin dhe Pëllumb Pelivanin.

Në vitin 1957 Shemsi Manjani pasi mbyll me sukses studimet e shkollës së lartë, rikthehet në vendlindje në qytetin e Peshkopisë.
Në vitin 1958, ai nis të riluajë me Korabin e atyre viteve, duke koleksionuar edhe suksesin e parë, pasi skuadra shpallet kampione duke fituar në Himarë dhe fiton të drejtën të luaj në kategorinë e dytë.

Pasioni për sportin ka sfiduar vitet mbi supe, duke shënuar rekorde të jetës, si pjesëmarrës i turneve kombëtare dhe ndërkombëtare në moshën madhore...

RIKTHIMI NË DIBËR DHE SHPËRTHIMI TE KORABI

Në vitin 1957 Shemsi Manjani pasi mbyll me sukses studimet e shkollës së lartë, rikthehet në vendlindje në qytetin e Peshkopisë. Në vitin 1958, ai nis të riluajë me Korabin e atyre viteve, duke koleksionuar edhe suksesin e parë, pasi skuadra shpallet kampione duke fituar në Himarë dhe fiton të drejtën të luaj në kategorinë e dytë.

Por njëkohësisht Shemsiu kujton edhe duelet në volejboll, veçmas një ndeshje me Butrintin, ku dibranët humbën vetëm me një pikë diferencë. Mjaftoi ajo pikë, që Butrinti të ngjitej në elitë dhe të bënte ligjin për vite e vite me radhë edhe me Dinamon e famshme. Shemsiu kujton që lojtari i ndeshjes në atë ditë ishte Lutfi Manjani, një sportist shume cilësore që i kalonte kufijtë e parashikimit.

SUKSESI I PARË, NGJITJA NË KATEGORINË E DYTË

Përmes një fotografie të ruajtur me shumë kujdes, Shemsi Manjani rikthen sot nostalgjinë e vitit 1958, kur ekipi i Korabit siguroj të drejtën për të luajtur në kategorinë e dytë. Në këtë foto, ai flet me respekt për emra konkret që nisen të gdhendin historinë e suksesit. Fiqiri Deliallisi, Sefedin Juniku, Xhevdet Tusha, Musa Bordulla, Hysen Biçaku, Shefki Hafizi, Xhemal Graceni, Mufit Begu, Hiqmet Elezi dhe Uran Besatari, janë protagonistët e një Korabi të ri, që ngjitet në kategorinë e dytë dhe më pas vijon udhëtimin tjetër, atë drejt kategorisë së parë. Shumë prej futbollistëve, bashkë me Shemsi Manjanin, ishin dibranë, por kishte edhe mjaft të ardhur, që përshtateshin bukur mes dibraneve të mirë dhe mikpritës.

NGJITJA NË ELITE DHE KUJTIMET E TIJ...

Në vitin 1960 skuadra e fitoi të drejtën të hyjë në një kategori më lart, por sipas tij ai kampionat u shty dhe u luajt më vonë, në vitet 1961-1962.



Duke i rikthyer në ato vite, Manjani kujton që asokohë kishte kundërshtarë mjeshtra të mëdhenj të futbollit, dy prej të cilëve kërkon t'i kujtojë edhe sot, veçmas Refik Resmën dhe Bert Jasharin. Madje me këtë të fundit, ai krijoi një raport të ngushtë shoqëror dhe miqësor, saqë e ruan akoma edhe sot. Korabi në kategorinë e parë rezervon kujtimet më të bukura të jetës së tij. Ditët e ndeshjeve ktheheshin në festë për gjithë Dibrën. Vinin edhe nga fshatrat dhe në qafën e pazarit Haxhi Gjapi, bashkë me disa dashamirës e tregtarë të tjerë, mblidhnin fonde dhe na bënin dhurata në rast fitoreje. Sidomos kur vinte "Partizani" e "Dinamo", bëhej nami. S'kishe ku të hidhje as kokrrën e mollës.

Gjatë gjithë rrugës deri te fusha, shoqëroheshim nga qindra e mijëra njerëz. Populli sportdashës i Dibrës i gëzohej edhe ardhjes së yjeve të futbollit, si Panajot Pano. Ikjet e tij në fushën e lojës, ishin të shpejta dhe dinake. Të rrëshqiste si ngjalë. Natyrisht kishin nivel më të lartë se ne, por pasioni dhe sedra jonë ishte e admirueshme. Në skuadër portier kishim Elio Elinin, - kujton Shemsiu, një djalë simpatik nga Tirana që kishte cilësi mjaft të mira, ndërsa kapiten ishte i madhi Lutfi Mjanjani, që vërtet ishte një qendërmbrojtës i pakalueshëm. Nga Shijaku kishte ardhur tek ne Imer Muça, ndërsa dibranë ishim edhe unë, Taxhedin Shehu, Musa Bordulla dhe Islam Kosova. Njëra prej fotove që botohet në këtë shkrim, rikthen sot mallin





cyan magenta yellow black

E kujtoj si një njeri serioz dhe tepër të përkushtuar, veçmas në rastet kur ishte protagonist në formacion dhe i besohej një përgjegjësi e tillë. Kështu e kam njohur edhe vite e vite më vonë, në punën e tij titanike për arsimin dibran, deri në ditët e sotme"...





Manjanët përfaqësojnë një nga trungjet më të mëdhenj të Homeshit e njëkohësisht një "dinasti sportive" më vete dhe me emra tepër të spikatur... Mbi gjithçka ata kanë mbetur njerëz me virtyte e cilësi të larta, të nderuar e të respektuar si në profesionin e tyre të arsimtarit ashtu dhe në sport".

edhe për emra të tjerë vërtet historik që kontribuan për Dibrën, si Nesti Xoxe, Hysen Biçaku, Tomorr Gjoka, apo Petrit Llagami. Fjalë të mira Shemsiu kërkon të pohojë për trajnerin Vasfi Biçakun, arkitektin e një Korabi të vogël që bëri historinë e madhe.

PING-PONGU, SPORTI QË EDHE SOT E USHTRON

Të duket disi e pabesueshme, por edhe edhe mbas moshës 75-vjeçare Shemsiu luajti ping-pong, duke qenë pjesëmarrës në turneun ndërkombëtar që shoqata e Pensionistëve realizoi disa vite brenda dhe jashtë vendit. Luajti bukur dhe shpejt dhe ruan me fanatizëm reflekset që ky sport të mundëson. Lëvizjet e tij edhe sot janë si të një djaloshi, duke sfiduar moshën dhe vitet mbi shpatulla. Ka fituar Çertifikata Nderi në Prishtinë, Dibër dhe Korçë. Një sport të tillë, ai e ushtronte edhe kur ishte i ri, veçmas në vitet studentore, por edhe më pas në Peshkopi. Shemsiu, Lutfi Manjani dhe Shkëlqim Hoxha, ishin një treshe shumë cilësore që mateshin në rang kombëtar. Tek i shoh diplomat e fituara vitet e fundit, krijoi bindjen që pikërisht ky mentalitet fituesi dhe ky pasion, kanë mbetur tek Shemsiu, si në rininë e tij, kur ushtronte njëherësh tre sporte, futboll, volejboll dhe ping-pong.

TEUTA DHE ANDI, DY EMRA, QË NDEROJNË NJË EMËR!

Vajza dhe nipi, të duket se ruajnë emrin e bukur të krijuar nga babai dhe gjyshi i tyre. Teuta Manjani, mbahet mend prej të gjithëve si një ish kampione e sportit të bukur të shahut. Fillimet e Teutës janë si volejbolliste me ekipin e Korabit, nga viti 1975 deri në vitin 1978. Por në verën e vitit '78, merr pjesë në kampionatin kombëtar të shahut, duke krijuar kësisoj shkëputjen nga sporti i rrjetës dhe bëhet pjesë e kampionateve të sportit të shahut. Shkëlqimi i saj është i menjëhershëm dhe në dy vite radhas, pra 1978 dhe 1979, shpallet kampione kombëtare në shah për femra. Por të njëjtin sukses thuajse ajo e arriti edhe në vitin 1983, kur me pikë të barabarta me vendin e parë, vetëm për koefiçient, renditet e dyta në Shqipëri. Falë kontributit të saj, ajo bëri që Korabi në vitin 1984 të fitonte medalje bronzi në një veprimtari ndërkombëtare. Por kënaqësia e Shemsiut nuk është vetëm si baba, por edhe si gjysh. Andi, është një djalë i talentuar i cili luan futboll në Shkup, atje ku jeton familja e nënës së tij Teuta Lala Manjani. Nisma që ai të merrej me futboll, kishte emrin e gjysh Shemsiut që vërtet ndihet shumë i lumtur për këtë aktivizim të tij. Duke shkuar me ekipin që stërvitet në Shkup e ndeshur me moshatarët e tij në Holandë dhe vende të tjera.







TRE MJANJANËT!

Duke u rikthyer në historinë sportive të atyre viteve, të bën përshtypje fakti që Korabi, kishte në gjirin e tij dy djem me mbiemër të njëjtë që kishin lidhje gjaku dhe vëllazërie me njëri-tjetrin.

Natyrisht që më i miri, ishte Lutfi Mjanjani, një djalosh tejet i guximshëm, që kishte një sedër të jashtëzakonshme dhe e kishte të vështirë të pranonte humbjen.

Edhe ai ishte një universal në sport, tek e shihje të kontribuonte edhe në sporte të tjera jashtë futbollit, si volejboll, atletike, shah, ping-pong etj. Shemsiu e pohon që Luti ishte ajka e Mjanjanëve të sportit, ndërsa Rizai ishte disi më ndryshe. Gjithsesi treshja e Manjanëve, përbënte një rast unik në sportin dibrane, duke gëzuar respektin e sportdashësve që e respektonin këtë trio simpatike dhe vlerësonin rolin e tyre familjare te Korabi.

BEXHET SHEHU: "ISHTE SERIOZ DHE I PËRKUSHTUAR"!

Njëri nga bashkëkohësit dhe miqtë e tij të afërt, që edhe sporti i lidhi po kaq, është edhe profesor Bexhet Shehu, emri i të cilit në futbollin dibran, është vërtet një emblemë.

Tek e merr në telefon dhe e pyet për Shemsiun, përgjigja e parë jo vetëm është pozitive, por të thotë që kam aq shumë gjëra që dua të kujtoj, saqë e kam të vështirë të zgjedh...

...- "Me Shemsiun njihemi prej kohësh, që kur ishim konviktorë. Ishte disa vite para meje. Kishte një vullnet të admirueshëm, së bashku me dy kushërinjtë e tij, Rizain dhe Lutfiun. Përbënin një treshe nga rrethinat e Peshkopisë, që luanin vërtet një futboll të mirë. Koha është e largët dhe vështirë të mbahen mend saktë të gjitha gjërat. Por pas vitit 1958 kujtoj që ai luante në mesfushë, por mbaj mend që ruante me kujdes edhe në mbrojtje. Lutfiu ishte më i fortë, por Shemsiu e vlerësonte mjaft të qenin lojtar formacioni dhe luftonte shumë në fushë. E kujtoj si një njeri serioz dhe tepër të përkushtuar, veçmas në rastet kur ishte protagonist në formacion dhe i besohej një përgjegjësi e tillë. Kështu e kam njohur edhe vite e vite më vonë, në punën e tij titanike për arsimin dibran, deri në ditët e sotme"... mbyll vlerësimin e tij profesor Bexhet Shehu 80- vjeçari, që në numrin tjetër do të jetë i pranishëm në këtë gazetë me profilin e tij.

Përfundoi duke përmendur me shkurtime një vlerësim të gazetarit sportiv, komentatorit të njohur Ismet Bellova, ish-shok klase dikur me Shemsiun në librin e tij "Dibra sportive": .... "Sa për sportin Homeshi mund të quhet pa ndrojtje fshat sportiv. Manjanët përfaqësojnë një nga trungjet më të mëdhenj të Homeshit e njëkohësisht një "dinasti sportive" më vete dhe me emra tepër të spikatur...

Mbi gjithçka ata kanë mbetur njerëz me virtyte e cilësi të larta, të nderuar e të respektuar si në profesionin e tyre të arsimtarit ashtu dhe në sport".

Rruga e Arbërit nr. 130

profil

Maqellara është ndër krahinat më të bukura të rrethit të Dibrës. Aty prej shekujsh jeton një popull patriot, punëtor e arsimdashës. Nga gjiri i tij kanë dalë luftëtarë e burra shteti si Iljas Pashë Dibra, Riza Tefiku, Ismail Strazimiri, Xhelil Gjoni etj.

Tre nga misionarët e arsimit në Maqellarë

Nga **ZABIT LLESHI**

Maqellara është ndër krahinat më të bukura të rrethit të Dibrës. Aty prej shekujsh jeton një popull patriot, punëtor e arsimdashës. Nga gjiri i tij kanë dalë luftëtarë e burra shteti si Iljas Pashë Dibra, Riza Tefiku, Ismail Strazimiri, Xhelil Gjoni etj.

Shkolla shqipe ka qenë ëndërr, ajo u bë realitet pas Shpalljes së Pavarësisë. Pas çlirimit të vendit, më 1944, shkollat u zgjeruan në çdo fshat, u hapën shkollat 7-vjeçare, sot 9-vjeçare dhe ajo e mesme. Të shumtë ishin bijtë e Maqellarës që i dolën zot profesionit të mësuesit dhe shërbyen si misionarë të arsimit, si Haki Pahumi, Emin Jashari, Tosum Xhemali, Pëllumb Qosja, Muntaz Nasufi, Neki Osmani, Mitat Agolli, Besim Stafa, Shahin Lazri, Baudin Strazimiri, Qemal Kërkuti, Boge Postoli, Demir Osmani, Ramazan Ilnica, Ramazan Piku, Hekuran Dida, Avni Gjoni, Rruzhdi Keshi, Ali Liça, Rasim Xholi etj.

Po ndalemi në tre prej tyre, duke pasur parasysh se gazeta "Rruga e Arbërit" do të shkruajë herë pas here për mësuesit e Maqellarës, që jetën ia kushtuan shkollës dhe arsimit.

Të shumtë ishin bijtë e Maqellarës që i dolën zot profesionit të mësuesit dhe shërbyen si misionarë të arsimit, si Haki Pahumi, Emin Jashari, Tosum Xhemali, Pëllumb Qosja, Muntaz Nasufi, Neki Osmani, Mitat Agolli, Besim Stafa, Shahin Lazri, Baudin Strazimiri, Qemal Kërkuti, Boge Postoli, Demir Osmani, Ramazan Ilnica, Ramazan Piku, Hekuran Dida, Avni Gjoni, Rruzhdi Keshi, Ali Liça, Rasim Xholi etj.

SKËNDER PAHUMI

Skënder Pahumi lindi më 1948 në Vojnik të Maqellarës. Babai i tij Nazmiu, ishte shumë arsimdashës, kishte mbaruar me vështirësi Internatin e Homeshit duke



kaluar shumë brenga, por fëmijët dëshironte t'i shkollonte. 4 fëmijët, 2 mësues e dy ekonomistë të lartë, duke mbështetur njëri-tjetrin bënë realitet ëndrrat e tyre e të prindërve.

Skënderi qysh në fëmijëri kishte dëshirë që të bëhej mësues. Mbaroi shkollën pedagogjike me rezultate shumë të mira në Peshkopi, duke përvetësuar dijet e lëndëve mësimore, njohuritë metodike e didaktike bashkë me përvojën që kishte fituar shkolla pedagogjike qysh me krijimin e saj.

Punën si mësues e filloi me pasion në Kërçisht, Maqellarë, për ta vazhduar në Majtarë nga viti 1972 deri në vitin 1988. Gjithnjë i heshtur, asnjëherë nuk fliste për vete. Nxënësit e tij nga cikli i ulët 'shpërthenin' në klasë të pestë, duke treguar punën e palodhur të mësues Skënderit.

Përparimi frontal në të gjitha lëndët në klasat e larta të shkollës 8 e 9-vjeçare, por edhe në shkollat e mesme e të larta, dhanë frytet e punës së këtij mësuesi. Të gjithë ata nxënës që hodhën bazat e dijes shkollore më mësues Skënderin, shkëlqyen në të gjitha hallkat e arsimimit. Kolegët e drejtuesit e shkollës konstatuan se ai i kushtonte shumë kohë përgatitjes për mësim, konkretizimin e orës së mësimit me bazë materiale e mjete ilustruese.

Kur hyje në klasën e tij, gjithçka ishte në vendin e vet. Mjetet mësimore ishin të sistemuara dhe shumica e tyre ishte përgatitur nga dora e tij. Klasa shndriste nga rregulli e pastërtia. Nxënësit merrnin pjesë gjallërisht në orën e mësimit. Për mësues Skënderin nuk kishte orë të parë e të fundit. Të gjitha orët vlerësoheshin njëlloj. Puna sistematike dhe kërkesat gjithnjë në rritje, e bënë atë ndër mësuesit e dashur dhe të respektuar të Maqellarës. Shpejt u bë i njohur jo vetëm në rrethin e Dibrës, por edhe në shkallë republike.

Gjatë ushtrimit të detyrës, në sajë të korrektësisë e punës sistematike, krijoi përvojë që e çoi drejt mjeshtërisë pedagogjike. Kjo vinte si pasojë e një vullneti për njohje shkencore të lëndës (saktësia shkencore), vetëkualifikimi, lidhja e shkollës me praktikën, me prindërit e mbi të gjitha rritja e ndjenjës së përgjegjësisë për punën e detyrën. Me futjen e programit të ri të matematikës si eksperiment në ciklin e ulët, kabineti pedagogjik i rrethit zgjodhi të eksperimentonte këtë program. Në vitin 1986, pas një trajnimi të mësuesve për këtë qëllim, klasa nisi punën me programin e ri eksperimental. Mësuesi siguroi bazë materiale, plus asaj që jepej nga rrethi, krijoi klasën-kabinet, që u vizitua nga mësues të rrethit e më gjerë.

Përvoja e re për zbatimin e programit në ciklin e ulët ishin një vlerë e shtuar për zbatimin e programit të shkollës sonë kombëtare. Në analizën e Arsimit të Dibrës, më 17 dhjetor 1986, në konkluzionet e Ministrisë së Arsimit, thuhet: "Të sakta dhe me vlerë janë mendimet që jep mësues Skënder Pahumi në Majtarë, i cili dallohet për punën e tij vrojtuese dhe plotësimin sistematik të dokumentacionit dhe eksperimentit". Për programin e ri të matematikës, thuhet: "Konceptet matematikore përvetësohen mirë nga nxënësit, në përputhje me moshën, është mënjanuar të mësuarit mekanik". Përvoja e tij u përgjithësua në shumë referime shkencore e e konferenca pedagogjike në shkallë rrethi, zonale e kombëtare.

Më 1988 transferohet në Kabinetin Pedagogjik të rrethit Dibër. Dhjetë vjet punoi për konsolidimin e arsimit fillor në rreth. Prej vitit 1998 deri më 1912, punoi mësues në shkollën "Mustafa Grablleshi"- Tiranë. Në këtë shkollë, si kurdoherë pati rezultate të larta, duke punuar pa u lodhur si misionar i Arsimit.

Gazeta "Mësuesi" dhe "Ushtima e maleve" shpesh kanë bërë objekt të shkrimeve përvojën e mirë të mësues Skënderit. Puna e tij është vlerësuar me Medaljen "Naim Frashëri" kl.I, ndërsa titullin "Mësues i Meritуar", me dekret nr.7287, më 4.3.1989.

SHEFKI SHEHU

Shefki Shehu rrjedh nga një familje me tradita patriotike, i biri i Ramadan Shehut nga Vojnika e Maqellarës, lindur më 1938. Qysh në fëmijëri dallohej për zgjuarsi e shkathtësi, që u evidentuan sidomos në shkollë, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera nga klasa e parë deri në të katërtën në shkollën pedagogjike Peshkopi. Ai zgjodhi profesionin e mësuesit, aq të vështirë, por i bukur e emocional, që të jep hapësira për t'u bërë misionar i edukimit të brezit të ri. Shefkiu punoi disa vite në Maqellarë, mbasi mbaroi Institutin Pedagogjik 2-vjeçar në Shkodër, në degën Matematikë-Fizikë, në janar 1965 filloi punë në gjimnazin e Peshkopisë. Në shtator të atij viti, u emërua drejtor i shkollës 8-vjeçare Majtarë. Këtu u dallua jo vetëm për marrëdhënie të mira me mësuesit, veçanërisht ata të rinj, por fitoi një përvojë në drejtimin e shkollës. Nën shembullin e tij kolektivi i mësuesve arrti suksese në punën për zbatimin e programeve të reja për shkollën, zgjerimin e arsimit tetëvjeçar, rritjen e cilësisë në procesin e edukimit, pasurimin e bazës materiale e deri pjesëmarrje aktive në jetën kulturore-artistik në fshat.

Për shumë vite Shefkiu drejtoi shkollën 8-vjeçare dhe shkëlqeu si mësues në shkollën e mesme Maqellarë. Afër 40 vjet mësues ai u karakterizua nga një disiplinë shembullore në punë, përgatitje të mirë profesionale e shkencore në mësim, organizim me kompetencë, lidhje të ngushtë të shkollës me familjen etj., një model i mësuesit në shkollë e jashtë saj.

Katër pjesëtarë të familjes zgjodhën mësuesinë, duke u dashuruar me këtë profesion. Ata u bënë ndër mësuesit e vlerësuar në Maqellarë. Zabiti, vëllai i Shefkiut, ka punuar në disa shkolla, në Maqellarë, Majtarë, Zogje e Dovolan. Ndihmesa e tij për forcimin e shkollës ka qenë e konsiderueshme duke çuar përpara traditat e shkollave të Allajbegisë e Maqellarës në rrethin e Dibrës.

Shefki Shehu gëzonte respekt e simpati nga njerëzit e thjeshtë, kolegët, prindërit e nxënësve me të cilët ndërtoi marrëdhënie shoqërore e miqësore. Gjeneratat që kaluan në duart e tij ruajnë kujtimet e mbresat më të mira për të. Shumë prej tyre mbaruan shkollat e larta, u bënë mësues, agronomë, ekonomistë e kuadro të vlefshëm për familjet e tyre dhe shoqërinë. Sipas shembullit të këtij mësuesi i gjen sot kudo, drejtues të ekonomisë, arsimit e kulturës në të gjithë Shqipërinë.

Shefki Shehu mori titullin "Mësues i Meritуar", me dekret nr.642, datë 03.09.1993, vlerësim jo vetëm për Shefkiun, por edhe për shkollën e mësuesit e Maqellarës, që tregon se kolektivi i kësaj shkolle ka një kontribut të rëndësishëm në konsolidimin e shkollës, mbarëvajtjen e punës mësimore-edukative, si shembull në rreth e më tej.

QAMIL SULA (HAMZAI)

Qamil Sulën e njohin kudo në Dibër, mësuesit, kuadrot të brezit të viteve 1970-2000, si njeri të qetë, të matur e me ndërgjegje të lartë. Ai në moshën e fëmijërisë ishte një djalë i imët, i shkathët, por me mendje të mprehtë.

Mbaroi shkollën fillore në Pocest, 7-vjeçaren në Maqellarë dhe shkëlqyeshëm mbaroi gjimnazin e Shkodrës më 1960.

Në atë kohë të gjithë nxënësit që mbaronin shkollën e mesme, vazhdonin shkollat e larta dhe Qamilit iu akordua bura në Universitetin e Tiranës, dega Matematikë-Fizikë.

Në vitin shkollor 1965-1966 filloi punën e mësuesisë në gjimnazin e Peshkopisë, pastaj në shkollën 8-vjeçare të Maqellarës nga viti 1966 deri në vitin 1970. Puna e tij sistematike i kaloi kufijtë e zonës dhe u emërua inspektor e kryeinspektor në seksionin e Arsimit e rrethit. Në këtë pozicion u tregua i palodhur, duke përhapur përvojën pozitive në shkollat e rrethit. Ai dha një ndihmë të mirë për shtirjen e arsimit 8-vjeçar e të mesëm, përgjithësimin e përvojës së përparuar dhe gjallërimin e jetës artistiko-kulturore fshat e sidomos në zonat të thella.



Më 1977-1985 punoi në aparatin e Komitetit të Partisë dhe më 1985-1991 në Komitetin Ekzekutiv të rrethit nëpunës i zyrës së Marrëdhënieve me Publikun.

Me shumë dëshirë e pasion u rikthye në arsim në Grevë e Dovalan (1991-1998).

Në vitin 2001-2004erdhi me punë në shkollën e Laknasit të Tiranës. Këtu solli atë përvojë që kishte fituar në Dibër, duke mbetur një mësues i denjë për arsimin shqiptar. Kur e pyet Qamilin, se a ka marrë ndonjë medalje a dekorim si mësues apo drejtues i shkollave, ai buzëqesh dhe shprehet: "Unë jam përpjek të vlerësoj, të propozoj për dekorime mësuesit e kuadrot e tjerë, ndërsa për mua duhet të mendonin ata që e kishin këtë të drejtë". Në fakt, për atë brez arsimtarësh, vlerësimet me dekorime ishin të kursyera. Nuk e meritonin atë neglizhencë deri në mosvlerësim, sepse punonjësit e arsimit e të kulturës kontribuan dhe sakrifikuan bashkë me familjet për edukimin e shkollimin e brezit të ri, brenda e jashtë Dibrës, në skajet më të largëta të rrethit.

Dalja në pension nuk e ka penguar Qamil Sulën të punojë me të rinjtë shkollorë në plotësimin e dijeve në lëndën e matematikë – fizikës, sidomos të atyre që nisin shkollat e larta.

Eqerem Çabej këshillonte mësuesit se: "Puna e tyre nuk është vetëm një profesion, por një mision", - i rëndësishëm për edukimin e brezit të ri.

Tre misionarëve të arsimit në Maqellarë, me rastin e 7 Marsit ju urojmë jetë të gjatë e lumturi në familje!

arsim

Kontributi *i hoxhallarëve dibranë* **në arsimin shqip**

Nga ROLAND MUKA*

SHKOLLA DHE LAICITETI

130 vjet pas hapjes së shkollës së parë shqipe ka nisur të diskutohet mbi laicitetin e shkollës. Duhet apo jo të mësohet feja në shkollë?

Kryeministri Rama ka shprehur idenë e futjes së edukatës fetare në shkolla, e cila

meriton një përshëndetje, sepse nxënësit për herë të parë do të kenë mundësi të informohen mbi religjionet fetare, dhe, normalisht, kjo do të ndihmojë jo pak në punën edukative të mësuesve, sepse feja në themelin e saj ka moralin e lartë dhe edukatën.



Haxhi Vehbi Dibra



Haki Sharofi



Said Najdeni



Hafiz Sherif Langu



Hoxhë Muglica

Nisma e kryeministrit Rama sapo u bë publike bëri jehonë të madhe në opinionin publik dhe në rrjetet sociale, por, për fat të keq, shumica e popullsisë shqiptare e indoktrinuar nga regjimi komunist shpreheshin kundra kësaj nisme, duke e pare fenë si rrezik, njëlloj siç propagandohej nga komunistët se "feja është opium për popullin".

Kjo çështje pati reagime të ndryshme, por unë do të doja të ndalesha te fillesat e arsimit shqiptar, dhe më konkretisht tek hapja e shkollave shqipe në Dibër, ku bie në sy një numër i madh hoxhallarësh që kanë qenë nismëtarë në hapjen e këtyre shkollave.

Shumëkush mund të mendojë se pse hoxhallarët do të merreshin me hapjen e shkollave shqipe, por njohësit e islamit e kuptojnë se kjo fe nuk ka ardhur vetëm për çështjen shpirtërore, për të na mësuar sesi ta adhurojmë Zotin në shtëpi apo në xhami, se si të falemi e si të agjërojmë etj., por para së gjithash, është program i jetës së njeriut nga lindja e deri në vdekje.

Ajo përfshin dhe menaxhon me çdo segment të jetës së njeriut: edukimin shpirtëror, arsimimin dhe shkencën, edukatën dhe kulturën, artin e politikën, ekonominë e biznesin, martesën dhe jetën bashkëshortore, shitblerjen dhe tregtinë, si dhe më kryesorja, që lidhet me këtë temë është edhe detyra për mbrojtjen e atdheut.

Pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, roli i hoxhallarëve dibranë u bë parësor në zhvillimet kombëtare dhe sidomos në ato arsimore, nëpërmjet të cilave shikonin përparimin e kombit. Hoxhallarët si: Haxhi Vehbi Dibra, Seid Najdeni, Sherif Langu, Haki Sharof, Hasan Muglica e shumë të tjerë, u edukuan në shkollën e fesë Islame dhe i përhapën këto njohuri bashkë me mësimet e gjuhës shqipe.

PERSONALITETE TË ARSIMIT

Haxhi Vehbi Dibra pati një veprimtari të papërshkrueshëm në shërbim të kombit e atdheut. Mori pjesë në klube e grupe patriotike; kryesoi Kongresin e Dibrës, kongres i cili vendosi të futet gjuha shqipe nëpër shkolla; qe delegat i Dibrës në shpalljen e Pavarësisë; u zgjodh kryetar i Senatit të parë shqiptar; ishte nënkryetar i Qeverisë së Vlorës; qe kryetari i parë i Komunitetit Mysliman Shqiptar; urdhëroi që feja të mësohej në gjuhën shqipe dhe bisedat të bëheshin në gjuhën shqipe.

Said Najdeni i njohur edhe si Hoxhë Voka ishte hoxhë, arsimtar dhe veprimtar i çështjes shqiptare. I ndërgjegjësuar për gjendjen e atdheut, më 1888 mbaron shkollën dhe kthehet në atdhe me një sasi abetaresh të Sami Frashërit të shtypura nga Shoqëria e Stambollit dhe filloi mësimin në gjuhën shqipe me ato abetare. Veprimtarinë e tij e shtriu jo vetëm në Dibër të Madhe, por edhe në krahinat e Gollobordës, Grykës së Vogël, në Bllacë, në MAqëllarë, në Brezhdan, në Dohoshisht e shumë fshatra të tjerë të Dibrës. Mësimet e Said Najdenit që kanë filluar në vitin 1896 janë të dokumentuara si fillimet e përhapjes së gjuhës shqip në trevën e Dibrës. Duke gjykuar toskërishten si të zorshme për dibranët e tij, Hoxhë Voka boton në Sofie "Abetare e gjuhës shqipe në të folmen gegënisht". Në shenjë nderi dhe respekti sot në qytetin e Peshkopisë një shkollë mban emrin e këtij patrioti dhe veprimtari të paharruar.

Haki Sharofi ishte mësuesi i parë i shkollës shqipe në qytetin e Peshkopisë, ishte drejtuesi i parë i revistës së mirënjohur për kohën "Zani i Naltë". Në historinë e arsimit dibran njihet si një besimtar, atdhetar dhe intelektual model.

Hafiz Sherif Langu punoi pa u lodhur për përhapjen e shkollave shqipe. Qe kryetar administrativ i klubit "Bashkimi"; ishte delegat i dibranëve në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë më 28 nëntor 1912. Nga viti 1940 deri më 1946 qe kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Hafiz Ismet Dibra ishte drejtori i parë i Medresesë së Tiranës, shkollës që shumë shpejt bëri emër në arsimin kombëtar në vitet '20 – '30.

Hafiz Zabit Kodra – Studimet i mbaroi me rezultate të shkëlqyera në vitin 1912 në Stamboll. Njihte katër gjuhë të huaja: arabisht, turqisht, persisht dhe frëngjisht. Njihte shumë mirë lexim dhe shkrim në gjuhën shqipe. Në vitin 1914, me vendim të qeverisë së asaj kohe emërohet mësues i shkollës fillore në komunën e Ostrenit, shkollë e cila duhej të ngrihej për herë të parë, por represioni serbo – bullgar e pengoi ngritjen e kësaj shkolle. Pas një viti u emërua mësues në shkollën e Muhurrit, e cila filloi së pari punën.

Sheh Sula i Zerqanit (Sulejman Shehu)– Në sajë të aftësive të tij të rralla intelektuale, Sulejman Shehu arriti të merrte dekoratën më të lartë që jepte Porta e Lartë në teologji dhe gradën major në ushtri. Mori pjesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit si përfaqësues i Dibrës, si dhe në Kongresin e Manastirit. Më 10 maj 1910 nën drejtimin e tij u hap shkolla e parë shqipe në Zerqan.

Hoxhë Muglica lindi në katundin Okshtun të Gollobordës më 1856. Ai qe propagandist i shquar i arsimit kombëtar, i librit në gjuhën shqipe dhe i shkollës në gjuhën amtare në zonën e Dibrës. Mori pjesë në Kongresin e Dibrës (1909) dhe në Kongresin e dytë të Manastirit (1910). Hoxhë Muglica në bashkëpunim me Elez Koçin organizuan në krahinën e Gollobordës disa kuvende, me qëllim përhapjen e ideve të Kongresit të Dibrës e të Manastirit në lidhje me të ardhmen e shkollës shqipe. Ai arriti të organizojë një qendër mësimore në zonën e Gollobordës dhe t'u mësojë nxënësve gjuhën e shkruar shqipe dhe besimtarëve fenë islame.

Qe një ndër përkrahësit e shkollës së parë Normale, të cilën e furnizoi me kontingjente nxënësish nga Golloborda, Okshtuni etj. Historia e martirëve shqiptarë ka regjistruar në vitin 1915 edhe Hoxhë Muglicën, i cili ra nga plumbat e ushtarëve serbë te Ara e Sheremetit të Muglicës, me thirrjen burrërore: "Rroftë Shqipëria! Rroftë kombi shqiptar!"

* * *

Këta ishin disa nga atdhetarët dhe njëherësh hoxhallarë të shquar, të cilët dhanë kontributin e tyre në zonën e Dibrës, por nëse do bëjmë një hulumtim më të gjerë, figura të tilla do t'i gjejmë në një numër shumë të madh në trojet shqiptare, ku mund të përmendim shkurtimisht: Hafiz Ali Korçën një ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Pandeli Sotirit, i cili mundësoi hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë, Haxhi Ymer Prizrenin, Zyber Hallulli, Hafiz Ibrahim Dalliun etj.

Duke lexuar për jetën dhe veprën e këtyre patriotëve të shquar frymëzohem dhe bindem në vetvete se besimi dhe feja nuk përbëjnë asnjë pengesë në zhvillimin e arsimit, por duhet që bindjet dhe idetë fetare të mos përzihen me ata shkencore dhe të praktikohen jashtë mjediseve shkollore.

Po kështu, mendoj se jeta dhe vepra e këtyre pinjollëve është një përgjigje e qartë për të gjithë skeptikët që mendojnë se futja e kulturës fetare në shkollë është rrezik për cenimin e laicitetit të shkollës.

** Mësues historie, shkolla e mesme e bashkuar Ostren.*



Nga shkrimi mbi gur tek universitarët

Nga **SELMAN MEZIU**

Mësuesi muhurrak, shkolluar për matematik Sami Doda, merr iniciativën, kërkon me pasion këmbëngulje në kujtesat e të moshuarve, në arshivat e ndryshme, në ato pak libra të shkruara në ketë lamë, të hedh dritë mbi arsimin në krahinën e Muhurrit me studimin e titulluar: "Dritë diturie në Muhurr" (Monografi, botimet M&B, Tiranë 2014).

Shkruan me një gjuhë të thjeshtë. "*Përpjekjet e para për hapjen e shkollës në Muhurr e kanë zanafillën që në vitin 1909, me hapjen e "Mejtepes". Mësimi zhvilohej në gjuhën turke. Në lagjen Algjone Sul Kaleshi e më pas nga Hafuz Xhani (Dan Xhani i vjetër) në shtëpinë e tijë u hapën këto shkolla.,, (f.28)*

Masat shtypëse të qeverisë turke, reformat e Tanzimatit, dhe lëvizja xhonturke, kishte sjellur në mendimin intelektual të Muhurrit hapin e parë: mësimin e gjuhës turke si bazë njohje e komunikimi për emigrimin drejt qyteteve e vendeve të perandorisë dhe leximin e letrave që vinin nga ato që nga kushtet e vështira, mjerane detyroheshin të linin familjen, të afërmit, atdheun për të siguruar vazhdimin e jetës të familjeve në vendlindje.

AUSTRIAKËT HAPIN PORTAT E DIJES

"*Nga dokumete të tërthorta dhe nga kujtime të pleqve është vërtetuar që në fakt në vitin 1916 është hapur shkolla shqipe në Muhurr për një periudhë të shkurtër ashtu siç u hapën edhe 7 shkolla gjithësej në rajonin e Dibrës, gjë që u bë e mundur nga autoriteti ushtarak austro-hungarez (f.29).*

Një veprim i tillë i pushtuesve austro - hungarez duke përdorur plumbin dhe shkronjat nuk është një veprim abstrakt. Ai ka patur karakter politik, për të futur kthetrat në Shqipërinë e virgjër të mbitokës e nëntokës, por edhe të ndihmojnë këtë popull të ngjit me kujdes shkallët e dijës, pa të cilën nuk do të kishte zhvillim ekonomik, kulturor, qytetërim.

Inisiativa tjetër mjaft delikate, por e zgjuar e autoriteteve austriake është se: *"Pas nje viti (më 1916, S. D.) u emërua mësues në shkollën e Muhurrit (Hafiz Zabit Kodra S.M.) e cila filloi së pari punën.,,* (f.29). Gjë që tregon dashamirësinë me fenë islame, respekt e vlerësim për propagandues e tyre por që mund të kryenin, detyrat e tyre në dobi të njerëzve, duke i mëkuar banorët e trevës së Muhurrit me dituri, nëpërmjet të shkruarit e lexuarit të gjuhës nanë.

KULLAT DJEPE TE ARSIMIMIT

Streha e arsimimit të fëmijëve muhurrak do të kthehen konaqet, shtëpiat e fshatarëve të varfër, si e vetmja zgjidhje e përkohshme e këtij problemi. Interesimi për shkollim hyri në odat muhurrake ne agimet e shekullit të njëzetë, pikërisht në vitin 1909.

Mbarimi i luftës së Parë Botërore ishte një kasaphanë e vërtet në banorët e Europës dhe një thellim i varfërisë në çdo kënd të saj. Politika arsimore e qeverive që ndërroheshin edhe çdo dy muaj nuk krijoi mundësinë për hapjen e shkollave shqipe, as me arsimtar, as me ndërtesa, as me investime e programe. *''Vetëm në vitin shkollor 1925-1926 u bë e mundur hapja e shkollës së parë shqipe në Muhurr, në shtëpinë e Destan Sinës, shtëpi e cila egziston edhe sot e banueshme.,,* (f.31)

(vijon në faqen 22)

Rruga e Arbërit nr. 130

Te të gjithë këta pishtarë të arsimit dibran mbeti e pastër dashuria për atdheun, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të cilën e promovuan dhe e mbollën te nxënësit që i kaluan nëpër duar.

profil

Dibër e Madhe, *dashuria për atdheun kalon nga Gjuha shqipe*

Nga **ARSIM KOLARI**

Në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe fillimin e shek. XX, edhe në Dibër, ashtu si në disa treva shqiptare, mori hov lëvizja arsimore dhe kulturore, duke e përcaktuar Dibrën si qendër të përhapjes së arsimit shqip në Shqipërinë Veriore dhe viset tjera shqiptare. Lëvizjes arsimore dibrane, shtysë më të madhe i dha Lidhja Shqiptare e Prizrenit, meqenëse Dibra ishte mbrojtëse kryesore e platformës për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe. Pengesë kryesore për këtë përhapje, ishte Perandoria Osmane, megjithëkëtë mësimi dhe shkrimi i gjuhës shqipe u bë fshehurazi nëpër dhoma të thella e bodrume. Ky emancipim kulturor zhvillohej nëpërmjet përhapjes së gjuhës shqipe, përhapjes së diturisë dhe rritjes së numrit të shkollave shqipe, për të ndërgjegjësuar shqiptarët që të mbrojnë kombin dhe të çlirohen nga okupatorët.

Sipas studiuesit të madh dibran Arian Kadiu, në vitin 1877 të dhënat osmane të hulumtuara tregojnë se Dibra me rrethinë ka pasur mbi 30 shkolla fillore të besimit islam si dhe dy shkolla të tilla të krishtera. Vetëm në Dibër të Madhe, në këtë vit ka pasur 7 medrese dhe një ruzhdie (e cilësuar si shkollë e mesme). Nëpër fshatra të ndryshëm, bejlerë e agallarë të kulturuar, hapnin shkolla në sarajet e tyre. Ky fakt tregon se Dibra me rrethet e saj kishte ngritje të mjaftueshme arsimore dhe kulturore, të shërbyeshme si bazë e ndërtimit të shkollave në gjuhën shqipe.

Në vitin 1887, sipas studiuesit dibran Fatos Daci, u hap shkolla e parë shqipe edhe në Rekë të Dibrës, konkretisht në fshatin Vërbjan. Rol të veçantë në përhapjen e dijes dhe krijimin e shkollave shqipe në Dibër kishin atdhetarët mendjendritur, si: Said Najdeni (Hoxhë Voka), Hamdi bej Ohëri, Shaqir Daci, Nazif Sharofi, Kadri Fishta, etj.

Më pas, Fatosi tregon se më 12 mars 1912, me lejimin e valiut të Manastirit u hap shkolla e parë shqipe në Dibër të Madhe, nga ku hapja e shkollave shqipe mori njëfarë legjitimiteti. Në korrik të vitit 1908 Eqerem Cami, veprimtari për hapjen e shkollave shqipe dhe mësimin e gjuhës amtare, bashkë me Sheh Latifin, Sherif Langun, Shqyqyri Beun (djalin e Iljaz Pashës), Ismail Strazimirin dhe atdhetarë të tjerë, bënë të mundur që në gjimnazin e Dibrës mësimi të bëhej shqip dhe mësues të emërohej Shefqet Daiu nga Elbasani. Në monografinë kushtuar Dibrës, të studiuesit Arian Kadiu gjejmë të dhëna se "Mësuesi i Popullit" Haki Sharofi, atdhetarizmin e tij e shpalosi në klasë e shkollë dhe si i tillë, në Kongresin e tretë të arsimtarëve në Tiranë, më 12-21 gusht 1924 mori vendime për demokratizimin e njësimin e shkollave shqipe.

Hapja e Normales së Elbasanit ishte një ngjarje e shënuar për prindërit artdashës të Dibrës së Madhe. Nxënësit e parë dibran që filluan dhe kryen me sukses mësimet në këtë normale, janë: Medat Cami, Esat Mezelxhiu, Abdi Begu - Haxhiu, Irfan Tomini, Ilmi Golja, Sherif Lleshi, Xhavit Kaba, Iqmet Maslinka etj.



Në vitin shkollor 1941-1942 në Dibër u hapën dy shkolla fillore: Sh.F."Liria" (afër kinemasë së vjetër) me drejtor Xhevat Xhafën dhe Sh.F. Skënderbej" me drejtor Naim Babameton nga Elbasani. Poashtu, në këtë vit shkollor u hapën shkolla edhe në fshatrat e Dibrës, si: në Banjisht (mësues Hasan Rrapi), në Radostush (Hysen Abdihoxha dhe Fadil Hoxha), në Trebisht (Aqif Pasholli), në Vidushë (Hiqmet Kasapi), në Velebordë (Pandi Manço), në Skudrinjë (Zihni Çila dhe Ibrahim Zabzuni), në Kosovrast të Epërm (Fadil Hoxha dhe Braho Domi), në Xhepishtë (Ali Telhani dhe Dhimitër Fullani), në Zhitinen dhe Paresh (Thanas Caku), në Prapanik (Isan Baholli), në Koxhaxhik (Servet Mano), në Spas (Abaz Xhafa), në Konjarë (Hiqmet Kasapi), etj. Në këtë periudhë, u shfrytëzuan kushtet e ofruara nga Këshilli Administrativ i Ministrisë së Arsimit për arsimimin e dibranëve, ndaj u angazhua plejada e nxënësve të rinj për zhdukjen e analfabetizmit të ngelur në popullatë, për t'u shndërruar në mësimdhënës shembëlltyrë, si: Sami Lemçe, Faton Daci, Lamçe Rusi, Mukades Halili, Qauseser Shehu, Shaje Jegeni, Gëzime dhe Lamiko Bellçishta, Gëzime Piperku, Lamiko Rusi, Remzi Papraniku, Dalip Bellçishta, Emin Pustina, Nehat Bellçsihta, Mahmud Hysa, Masar Kodra, Mojsi Lutfiu, Bardhyl Cami, Atli Bellçishta, Nexhmi Dibra, Isa Batku, Sahit dhe Qerem Lleshi, Refik Qatipi, Shaban Shemsiu, Lutfi Maru, Sabaudin Ajdini e të tjerë varg. Në këtë interval, ishte hapur kursi gatitor i zejtarisë, në të cilin ishin të regjistruar 30 nxënës.

Shkolla tetëvjeçare e fshatit Sollokiç u hap në vitin 1946, ku ndër mësuesit e parë ishte edhe Sefedin Koleci, i shkolluar në akademinë ushtarake në Torino të Italisë, pastaj Ajredin Dibra, Sabaudin Ajdini, Gëzim Ostreni, Atli Bellçishta, Mentor Sejfedini, Ferit Vojnika etj.

Shkolla e mesme në Dibër të Madhe u formua në vitin 1960. Gjimnazi i atëhershëm ishte i vendosur në ambientet e shkollës fillore " Oxhë Vogli", ndërsa mësimi realizoheshte në dy gjuhë, shqip dhe maqedonisht dhe me dy ndërrime. Në vitin shkollor 1960/61 shkolla kishte vetëm tre paralele: njëra në gjuhën maqedone dhe dy në gjuhën shqipe. Pas tërmetit, në vitin 1967 gjimnazi u vendos në lagjen Venec 1, ku gjendet aktualisht. Gati çdo vit, në këtë gjimnaz në vit të parë regjistrohen rreth 150 nxënës shqiptarë. Profesori i gjuhës shqipe, Qeram Lleshi është drejtori i tanishëm i këtij gjimnazi.

Shkolla fillore "Penestia" apo "shkolla e vjetër" siç njihet nga qytetarët, u themelua rreth vitit 1968. Ajo gjendet përballë Shtëpisë së Kulturës dhe drejtor i parë i saj ka qenë Petrit Muça. Sot, kjo shkollë nëntëvjeçare ka nga 4 paralele për secilin vit, me më shumë se 500 nxënës shqiptarë. Drejtor aktual është mësuesi i lëndës së historisë, Ramadan Imeri.

Ndërkaq, shkolla fillore "Said Najdeni", e themeluar më vonë se të tjerat, në vitin 1994, aktualisht posedon 500 nxënës me 36 paralele dhe mbi 40 mësimdhënës. Drejtor i parë i saj ka qenë mësuesi i matematikës Rizvan Koleci, pastaj pedagogu Sakip Veliu, më vonë arsimtari i matematikës Ilmi Frangu, pas tij biologu Pëllumb Frangu, e më në fund mësuesi i gjuhës angleze Burim Kaziu. Pra, aktualisht në qytetin e Dibrës ka dy shkolla fillore dhe një të mesme, veç atyre të fshatit Ballancë, qendrës Zhupë e fshatrave të Rekës.

Te të gjithë këta pishtarë të arsimit dibran mbeti e pastër dashuria për atdheun, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të cilën e promovuan dhe e mbollën te nxënësit që i kaluan nëpër duar. Duhet trajtuar me një nderim të veçantë çdo mësues dibran, sepse ishin ata që sakrifikuan veten dhe familjen e tyre për të reflektuar dritë në mendjet e nxënësve qoftë edhe në skajin më të thellë në kohë të turbullta, të cilëve herë ua shpërblyen e herë ua lanë në harresë mundin e dhënë. Kandili i ndezur nga ta na kujton kush jemi e ç'ka duhet synuar!...



Jahja Domnori, atdhetar, publicist, edukator, ekonomist, eurid, personalitet i arsimit dhe kulturës shqiptare.

Nga **DEMIR OSMANI**

Mësuesi merituar Jahja Domnori në vitin 1945 deri në fund të viti 1947 ka qenë kryemësues në shkollën e Allajbegis të Njësisë Administrative Maqellare në Dibrës , e cila kremton këtë vit 100 vjetorin e hapjes të saj. Për 100 vjetorin e kësaj shkolle ka shkruar kolegu im Ramazan Ilnica, ndërsa unë po shkruaj për mësuesin Jahja Dommori. Kjo për shumë arsye, por edhe për faktin shumë të thjeshtë, pasi edhe sot pas 70 vitesh po të përmendet emri i tij në konakun e burrave në Allejbegi, menjëherë vihet qetësi, në shenjë nderimi e respekti për këtë figurë të shquar.

KUSH ISHTE JAHJA DOMNORI?

Jahja Domnori lindi në Shkodër më 14 Mars të vitit 1905, në një familje atdhetare dhe të kulturuar. Babai i tij, Alushi merrej me tregti e kështu vizitonte shpesh Stambollin, Kajron, Algjerin, Triesten, Venecian, Sarajevën dhe pothuajse te gjithë portet e Mesdheut duke importuar mallra të ndryshme industriale. Ai është i njohur si një nga luftëtarët e rezistencës për mbrojtjen e Shkodrës dhe trojeve shqiptare nga aneksimi i fqinjëve.

I rritur në familje me tradita te larta qytetare, i ati e dërgoi Jahjan të mësojë në shkollën "Daryl Irfan" (Dera e Dijes) që më vonë mori emrin "Shkolla e Parrucës. Me 1922 u hap Gjimnazi i shtetit në Shkodër në të cilin ai regjistrohet dhe e mbaron me 1928 në degën pedagogjike, duke hyrë në historinë e këtij Gjimnazi si Matura e parë me drejtor Mirash Ivanaj. Gjatë periudhës shkollore si student, bënte pjesë në skuadrën e futbollit "Vllazmia".

Studenti Jahja Domnori mori pjesë aktive në demonstratën antifashiste të 28 nëntorit 1927 dhe aksionin e heqjes së flamurit Italian nga Banka e Shtetit në Shkodër, nga ku edhe arrestohet sëbashku me pesë studentë të tjerë, por shpejt lirohet nga përkujdesja e ish Drejtorit të shkollës Mirash Ivanaj.

Menjëherë pas mbarimit me rezultate të shkëlqyera të degës pedagogjike të gjimnazit të Shkodrës emërohet mësues në Internatin "Kastrioti" të Dibrës. Me që ishte njëri nga mësuesit më të përgatitur, përveç detyrës të mësuesit i ngarkohet edhe detyra e ekonomatit të shkollës dhe konviktit. Në kujtimet e tij shkruan: "Ishte hera e parë në jetën e time që bëra udhëtim me avionin e shoqërisë italiane Adria Aereo Llojd, i cili zbriti në fushën e Kastriotit për 27 minuta. Udhëtimin e bëra sëbashku me djalin e xhaxhait, Qazim Domnorin i cili ishte shëndetlig, dhe e mora me vete, që t'i ndërroja klimën dhe ta shkolloja"...

portret

Asnjëherë nuk u rreshtua në formacione politike, por i shërbeu me devotshmëri arsimit të popullit që i përkiste në të gjitha trojet shqiptare dhe në të gjitha regjimet që jetoj. Ishte Atdhetar, kundërshtar i pushtonjësve të trojeve tona dhe të trurit njerëzor.

Jahja Domnori, *mësuesi i Allajbegisë*

Më pas vazhdon: "si ekonomat në atë shkollë me konvikt, i kurseva shtetit 500 napolona ari. Pasi e verifikoi Ministria e Arsimit se fëmijët, dhe 25 irridentistët nga Dibra e Madhe të cilët i kisha në ngarkim, ishin ushqyer konform rregullores, pata mundësinë t'i shpenzoj ata para për rikonstruksion të godinës, për krevate, velenca etj."("Jeta ime", ditari personal i mësuesit Jahja Domnori).

Me sjelljen e tij korrekte mësuesi i ri Jahja Domnori shumë shpejtë fitoi respektin dhe besimin e dibranëve. Sa herë vononin rrogat e arsimtarëve për arsye të ndryshme, shkruan Jahja Domnori në librin "Jeta Ime", shkoja e merrja para te pronari i Hotelit "Durimi" në Peshkopi, z. Ramiz Trepçi, burrë i ndershëm, i besës dhe shumë arsimdashës (R. Trepçi ishte nip i Sulë Shehut, atë kohë kryetar bashkie dhe një personalitet i shquar i arsimit kombëtar, fillimin, Internati "Kastrioti" e kishte në shtëpinë e Sulë Shehut)".

Jahja Domnori ka lënë shumë shënime në fletoren "Jeta Ime" për 8 familjet e mëdha të Dibrës: Elez Isufi në Sllovë, Dine Begu në Maqellarë, Murat Kaloshi në Kandër, Dervish Luzha në Reç e Dardhë e me radhë, Dine Dema, Dan Cami dhe Dine Hoxha në Muhrrin e Vjetër, për të cilin shkruan se ishte shumë i ditur. Për të gjithë kishte një mendim, mikëpritës, atdhetar dhe arsimdashës.

Me 1931 emërohet mësues dhe ekonomat në shkollën internat të Burrelit. Aty ishte ndryshe, do t'i blinte ushqimet nga një kontraktor që ishte i lidhur me parinë dhe i impononte të firmoste çmimin e diktuar prej tij dhe jo çmimin e tregut. Miku i tij Peter Elezi, mësues dhe studius i mirënjohur i gjuhës shqipe, koleg në atë institucion, frikësohej se mos i bënin Jahjas ndonjë të keqe, pasi edhe drejtori servil i shkollës, nuk e shikonte me sy të mirë qëndrimin e tij që kundërshtonte të firmoste, duke i thënë se është malli i Princit, por përgjigjja e Jahjasë ishte: "nuk besoj se Princi do të jetë dakord që të abuzoj me paratë e shtetit". Në këto rrethana dha dorëheqjen. Ministria e Arsimit, pas një pauze të shkurtër e emëroi, kryemësues në Shkodër.

Në vitin 1934, me urdher të Ministrit të Arsimit, Mirash Ivanaj, që e njihte shumë mirë, pasi e kish pasur student të tij dhe i vlersonte shumë aftësitë pedagogjike dhe organizative të Jahja Domnorit, e emroi në Vlorë për të riorganizuar arsimin, pasi në shumë shkolla kish shumë çrregullime administrative. Për një kohë shkurtër me metodën e punës që dimte ta bënte vetëm ai, trefishoi numrin e nxënësve, duke përfshirë edhe fëmijët e portit dhe rrethinave të qytetit, që deria atëherë nuk i lejonin të shkonin në shkollë. Shkolla u vu në një disiplinë të admirueshme sepse ai vetë jepte shembullin personal të një pune të ndërgjegjshme mësimore edukative. Ai arriti të siguroj shumë shpejtë mbështetjen e Kryetarit i Bashkisë së Vlorës z. Ali Asllani që ishte një intelektual i njohur, me ndihmën e të cilit arriti të bëjë një kopësht model për shkollën, duke lidhur me të një miqësi të sinqertë. Shpesh në biseda z. Ali Asllani i thoshte: "Si arrite t'i bësh lebërit e vegjël të flasin gegërisht. Po zoti Ali - i pergjigjej Jahjaj, edhe ju e keni pëlqyer kur unë them Vlona për Vlorën, sepse vlon shpirti i vlonjatit për liri".

Pushtimi Italian e gjeti në Shkodër. Konsulli Italian, Milani, e kishte regjistruar në listen e të padëshiruarve, sepse kishte kundërshtuar të vishte këmishën e zezë fashiste dhe kishte refuzuar të nxirrte gruan, Naxhijen, me kostum kombëtar në pritje të ministrit të jashtëm Italian, Konti Çianos. Për këtë arsye e largojnë nga Shkodra dhe emërohet në Durrës. Atje u takua me intelektualin Rifat Durmishi që ia dinte vlerat dhe e emëroi menjëherë zv. inspektor



Në shtëpinë e Cen Elezit, 1930, ditën e Shëngjergjit, disa nxënës të Internatit të Kastriotit (Foto nga arkivi i familjes Domnori)

dhe drejtor të Shkollës "Hasan Prishtina" me një personel prej 16 mësuesish. Menjëherë sëbashku me personelin e shkollës u radhit në qëndresën antifashiste, ndër të cilët Jahja përmend Aristidh Kero, Nexhmi Ballka, etj.

Në vitin 1941, Ministri i Arsimit Ernest Koliqi e emëroi Drejtor të shkollës së parë shqipe në Ulqin, duke i ngarkuar detyrën që të grumbullonte edhe mësues të tjerë. Gëzimi e pasioni i tij për organizimin e shkollës shqipe ne Ulqin qe i pa parë. Kontigjentin e mësuesve e gjeti në Shkodër sepse duheshin mësues të përgatitur. Ndër të tjerë iu drejtua edhe familjes së Prenkë Jakovës (atdhetar dhe kompozitor i shquar) sepse ishte njohur me Kolën (babai i Prenkës) në Luftën e Koplikut, i cili ishte ndër organizatorët e mbrojtjes se kufijve kombëtar nga agresioni jugosllav, ku Jahaja Domnori në moshën 15 vjeçare rrëmbeu pushkën e u radhit në frontin e rezistencës.

Ja si e përshkruan vetë Prenkë Jakova këte takim "Pasi u falme me zotni Jahon, ai më propozoi që të shkojshe në katundin e Katërkollit në Anë të Malit, se në ate zonë kishte marrë edhe mësues të tjerë prej Shkodre si Viktor Kicin, Prenkë Shiroken, Shuk Shllakun, Ramadan Millen, Zef Berishen edhe shumë të tjerë. Me që të gjithë mësuesit që më përmendi zotni Jahja i njifshe mirë, pranova pa ma të voglin hezitim. Nana Roze iu lut edhe për vllain tem Çeskun për me i gjetë nji vend edhe atij se i pëlqente natyra dhe puna si mësues". (marre nga kujtimet e Prenkë Jakovës).

Jahja Domnori është pishtar i përhapjes se arsimit shqip në Ulqin, ku edhes sot ruhet falimi i tij monumental si Drejtor i parë i kësaj shkolle. "Ju që keni ruajtur gjuhën shqipe si dritën e syve, duhet punuar, tani këte punë e ban shkolla." (marrë nga fjalimi ne ceremoninë e hapjes së shkollës).

Ne vitin 1943, emërohet mësues në shkollën femërore "Don Ndre Mjeda" me drejtoreshë Ida Melgusha. Aty punon deri në çlirimin e vendit. Në kujtimet e veta shkruan: "Aty pata një incident, me një të quajtunin Myslim Bejgora, i cili qe duke më vrarë, sepse kishte marrë vesh se unë i dërgoja rrogën në shtëpi, Zenepe Golemit, nëpërmjet Refik Shpuzës, kur ajo kishte dalë në mal, partizane. Drejtoresha, Ida Melgusha, si i vetmi mashkull që isha, ma jepte mua rrogën e saj për t'ia dërguar familjes."

MËSUES NË ALLEJBEGI

Menjëherë pas çlirimit të vendit deri me 1947 emërohet kryemësues në Allejbegi. Aty ishte hapur shkolla e parë shqipe që në vitin 1916, por ishte e shkatërruar nga lufta, dhe çdo gjë duhej riorganizuar nga e para. Me aftësitë e tij të jashtëzakonshme organizative dhe ndenjën e një atdhetari të flaktë u bëri thirrje fshatarëve të Allejbegisë, Vojnikës, Çernenës, Portgocës dhe arrit në kohë rekord të ndërtoj shkollën dhe të filloj mësimin rregullisht. Për karakterin e burrëror që kish dhe drejtësine e ndershmërin e lartë, vetë fshatarët e kërkuan dhe e vendosen ne krye të komisionit reformës agrare. Pas një pune të lodhshme çdo gjë e realizoi me mirëkuptim, sepse toka ishte pika më e dobët për fshatarët. Menjëherë ngriti dhe drejtoi kurset e luftës kundër analfabetizimit, duke shkuar sëbashku me koleget e tjerë në çdo shtëpi. Brenda një kohe të shkurtër kryemësuesi Jaho Domnori u bë njeriu më i dashur dhe i respektuar i gjithë krahinës. Gjatë qëndrimit në këtë fshat sëbashku me bashkëshorten Naxhijen dhe vajzën e tij Pertefe banoi në shtëpinë e Kadri Demirit. Aty i lindi djali i madh i tij të cilit ia vuri emrin Kujtim. Kujtimi u bë inxhinjer dhe qe Drejtori i parë i kantierit të ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, ku punonësoi shumë të rinj dibranë, pasi gjithmonë e quante veten dibranë, e u thoshte kam lindur në Allejbegi. Është nga rastet unikale ku edhe sot pas 70 vitesh Kujtimi dhe fëmijët e tjerë të mësuesit Jaho Domnori e vizitojnë herë pas here fshatin Allejbegi e fshatarët e tij.

U hidhërua shumë kur mori lajmin për arrestimin e mikut të tij Kadri Demiri në Gjirokastër dhe mësuesit të gjithë virtytshëm Edip Tërshana në Peshkopi, të cilin e pushkatuan më vonë. Nuk e harroi kurrë këtë figurë të arsimit në Dibër, bile kujtonte edhe djalin e tij Nehatin, që kur shkonte për seminare në Peshkopi e ftonin në familje ku njëherë kishte ngrënë bukën të pjekur prej Nehatit 12 vjeçar.

Në vitin 1948, seksioni i arsimit në Shkodër e dërgon të hapi shkollën e parë unike në Gur të Zi. Gjithmonë në fronte të vështira, por gjithmonë i gatshëm për t'i shërbyer arsimit, në çfarëdo rrethane që të ishte.

Në vitin 1949, emërohet në konviktin Oroshi, që ishte transferuar nga Dukagjini në shtëpinë e murgeshave në Shkodër, për të vendosur rregullin, sepse ishte në gjendje jashtëzakonisht të shthurur. Kur e inspektoi Dhori Samsuri, që vinte nga Tirana, u shpreh: "si është e mundur të rregullohej konvikti për një kohë kaq të shkurtër". Ndërsa Prof. Dr. Musa Kraja në veprën "Mësuesit për Kombin Shqiptar shkruan: "Jaho Domnori, mësues i heshtur e fisnik, ndjenjat e pastra prindërore i kishte shkrirë plotësisht edhe tek nxënësit e vet. Në konviktin e Oroshit, ai duke vlerësuar specifikën e atij institucioni arsimor, ishte bërë një mësues, edukator dhe prind i vërtetë. Ky pasion e këto ndjenja e shoqërojnë atë në të gjitha vitet e shërbimit".

Vit pas viti kalonte në shkolla të ndryshme të Shkodrës duke dhënë lëndë jashtë profilit të tij, sipas nevojës që kishte seksioni i arsimit si: matematikë, gjeografi, histori, krahas gjuhës dhe gjeografisë etj. Kur u hap Instituti 2-vjeçar i Shkodrës, u caktua pedagog–metodist, ku studentët dëgjonin mësime të hapura dhe drejtonte praktikat pedagogjike të studenteve që do të ishin mësuesit e ardhshëme.

Një ndihmesë të madhe ka dhënë për Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër. Kur i kërkonte ndihmë, drejtoresha Persa Grabova dhe më vonë Belkize Shazi, ai ishte aty. Një nxënësja e tij e këtij institucioni, Zhaneta Dilaveri, e përmendte ndihmën e tij prindërore: "sa herë që vinte zotni Jahja e rrethonim me dashuri, ai kishte fjalën e ëmbël që e zbuste shpirtin tonë të vrarë."

Mësuesi Jahja Domnori ishte nën ndikimin e ideve të Rilindjes Kombëtare dhe të iluministëve Francez. Njihte 5 gjuhë të huaja, Frengjisht, Gjermanisht , Italisht, Turqishtë, Arabishtë. Persishten e vjetër e kishte fituar në Shkollën "Daryl- Irfan" (Dera e Dijës) ku pati mundësi të studionte në origjinal poetët persë Saadi, Rumi, Omar Kajami e të tjerë orientalë.

Studionte në origjinal Kantin, Laplasin, Shopenhaurin, Russoin, Bualonë, Montenjin dhe Danten ku ka lënë mjaft përkthime nga Kanti dhe Shopenhauri. Më shumë ishte thelluar tek Gëte, i cili në fund të jetës kishte pranuar filozofinë e profetit Islam, religjionit të cilit i përkiste edhe Jahjaj. Në këte mënyrë gjente lidhje të filozofëve gjerman e francez me filozofët e orientit, lidhur me orientimin shkencor te dukurive natyrore e shoqërore. Respektonte të gjitha besime fetare dhe ishte shembull i tolerancës fetare. Shumica e miqve të tij i përkisnin religjionit kristian.

Nga dijetarët shqiptarë vinte ne krye Sami Frashërin, fjalorin shumëgjuhësh të të cilit nuk e hoqi kurrë nga dora, ndërsa fotografia e Hoxhë Tahsinit me mbishkrimin: "Zoti është krijuesi i gjithçkaje, por çdo gjë është shkruar në pllakën e gdhendur të natyrës", e mbante në dhomën e tij dhe gjithmonë përmendte atë si shembull për studimet e tij shkencore, që i jepte mundësinë fesë islame të evoluonte.

Asnjëherë nuk u rreshtua në formacione politike, por i shërbeu me devotshmëri arsimit të popullit që i përkiste në të gjitha trojet shqiptare dhe në të gjitha regjimet që jetoj. Ishte Atdhetar, kundërshtar i pushtonjësve të trojeve tona dhe të trurit njerëzor.

Gjithnjë jepte këshilla me vlera të larta edukative e shoqërore, duke i argumentuar me thënje nga urtësia botërore e shqiptare, për të të bindur për veprimet e moralshme që duhet të kryesh, të cilat i përzgjidhte në përputhje me këshillën që të jepte. Asnjëherë nuk e kam dëgjuar të ngrinte zërin, por fliste ngadalë dhe argumentone çdo mendim, gjë që vinte nga kultura e gjerë që kish marrë e merrte çdo ditë, pasi librin e kishte thesarin më të çmuar.

Nuk mburresh kurrë, gjithë jeta e tij karakterizohej nga modestia, qëndrimi korrekt ndaj detyrës, shoqërisë dhe familjes.

Vdekja i erdhi natyrshëm, në moshën e pleqërisë përsëriste fjalët: "duhet të iki atëherë kur vdekja do të më bahet ma e ambël se jeta". I rrethuar me dashuri nga familja dhe farefisi la këtë mesazh: "Fëmijët e mij, tanë jetën teme jam mundue me ba mirë, kam hjekë zi me e realizue, por kur e kam plotësue, kam përfitue kënaqësinë ma të madhe, prandaj bani gjithmonë mirë."

Në kuadrin e 7-marsit,
130-vjetorit të Shkollës së Parë Shqipe

Vahid Kormaku - *mësues e veprimtar shoqëror*

Nga **GAFUR ZOTA**

Kohë më parë, Vahid Kormaku (i Riu), nip i mësuesit e studiuesit të shquar Vahid Kormaku (i Vjetri shën.im), pati mirësinë të më jepte monografinë "Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritë të realitetit". Si ish drejtor i muzeut të rrethit, Peshkopi, kam patur rastin të njihem me dorëshkrimin e mësuesit patriot Vahid Kormaku. Tash, me punimin e sjellë nga i nipi, lexuesi gjen më shumë informacion për këtë figurë të shquar të arsimit, historisë e traditës.

Vahid Kormaku lindi më 1895(Aqsh, f.195, v. 1936, d.613, nr.1683, fl.31). Më tej dëftesë e kursit të shpejtë, përfunduar në Shkodër, më 10/IX/1925(Shih.Vahid Kormaku Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritë të realitetit, Tiranë 2012, f.162). Nën kujdesin e të atit, Saliut, kreu në Selanik arsimin e mesëm. Në gjimnazin turk të Selanikut, krahas gjuhëve orientale Vahidi –shkruan Mersin Hoxha kish mësuar edhe Italisht e greqisht. Studimi mbi "Udhët që ndiqte ushtria turke në drejtim të bregdetit shqiptar", "Via Egnatia"apo "Udha Stamboll-Durrës"- siç e quan Vahidi, Udha e "Grykës së Drinit të Zi", "Stamboll-Adrianopol-Filipopol-Sofje-Nish", etj. janë mbështetur në burime të autorëve antik, për kohën tabu edhe për studjuesit e mirëfillt. Pra Vahidi, më parë se shumë të tjerë, i kishte konsultuar ata. Studimi për rrugët është shoqëruar me të dhëna rreth stacioneve, qendrave urbane, kalave e vendeve me interes akeologjik. Ai shkruan për gjetje arkeologjike, fortesa, qytete të periudhave të ndryshme, tempuj monumental. "Në gjithë luginën e Drinit të Zi - shkruan Vahid Kormaku janë zbuluar 16 gërmadha fortesash të quajtura qytete e kala, 24 baza kullash të hershme si edhe tre vende të quajtura Gradisht". Në punën e tij ka infrmacion mbi gjeografinë , demografonë, traditën, botanikën. Ka informacion mbi qendrat urbane. Lidhur me këtë shkruan: "…Si shqiptarë kemi të drejtën e shenjtë të punojmë për të nxjerrë nga erësira shekullore gjithë ato visare të epokave të ndritëshme të racës tonë".

Sigurisht një kurorë me lule është kontributi që sjell për kastriotët. Angazhimin me këtë temë mbi të gjitha e ndjen si detyrim para historisë dhe brezave. Lidhur me këtë shkruan: "…Si arsimtar tue pa nevojën e madhe, që pret historija kombëtare nga ne, due të jap mendimin tim mbi sheshet e betejave të fatosit t'onë kombëtar, Skëndrebeut, gjeniut homerik, që me epokën e vet të pa shoqe, në historinë e botës, shkroi me gërma gjaku pavdekshërinë shqiptare, që ne sot mburemi e i kallzojmë botës mbarë…".Punimi i mësuesit dhe studiuesit Vahid Kormaku "Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritën e realitetit" është shoqëruar me material ballafaques, marrë nga autorë të ndryshëm. Ka mendim ndryshe çka e bën më interesant kontributin që sjell mësuesi i nderuar Vahid Kormaku. Gjithë kjo dëshmon për një punë të madhe e të palodhur hulumtuese në teren, aq më tepër në një kohë të vështirë, në mungesë të informacionit e mjeteve të transportit. Vahidi i ra kryq e terthor jo vetëm Dibrës, por edhe viseve jashtë saj, ku Skënderbeu u ndesh me pushtuesit osman. Kudo që shkeli konsultoi shumë të moshuar, studioi e krahasoj të dhënat e mbledhura me autor të ndryshëm duke na ofruar me harta e skicime tablonë e luftimeve të zhvilluara. Mendimet e shfaqura prej tij dëshmojnë jo vetëm për angazhimin e madh, por dhe kulturën e gjerë. Mjafton të përmendim hulumtimet e bëra dhe të dhënat që ofron për Koxhaxhikun-Sfetigradin. Syrit dhe mëndjes së tij nuk i kanë shpëtuar prania e një udhe antike, shtruar me kalldrëm, 60-70 m.e gjatë dhe 2 m e gjerë, varezat ku janë pranishëm gurë të ngjashëm me ato të qyteteve të vjetër si Elbasani e gjetkë. Ai sjell të dhëna mbi kalanë, popullsinë, besimet, jetën dhe punët e banorëve. Një informacion i tillë dëshmon për një studiues me kulturë të gjerë, përvojë dhe këmbëngulës. Studiuesit që pasuan, në përpjekje për thellimin e të dhënave, gjejnë te Vahidi indikacionet e para. Ai jo vetëm është bashkëkohës i Haki Stërmillit e Haki Sharofit, por në hulumtimet dhe studimet e kryera ka mes tyre pika takimi. Ata me të drejtë mund të konsiderohen si pionierët e historisë së shkruar në Dibër. Ato na lan një trashgimni të vyer dhe që meriton më shumë vlerësim, por dhe respekt e mirënjohje. Ata hodhën themelet e kalendarit të ngjarjeve historike, vendeve me vlera monumentale, të cilat studiuesit i pasuruan më tej me të dhëna të reja. Akademiku Aleks Buda do të thoshte për Vahidin se ishte njeri erudit, i shquar, pionier i historisë Shqiptare.



"Asht nji nga mësuesit e vjetër, mjaft i aftë në të kryemit të detyrës së mësuesit…, asht i squet, i zellshëm e i vemendshëm. Përveç detyrës si mësues i ka kushtue nji aktivitet të madh edhe zhvillimit e përhapjes së gjuhës shqipe, jo vetëm ndër nxanës, por edhe në popull të pashkolluem e ndër gra duke qenë në këtë mënyrë si qytetar i nevojshëm e shqiptarë i mirë."

Aqsh.f.195, v.1937, d.73, fq.327



Mësues Vahidi në mes të nxënësve të shkollës fillore Steblevë, 1938.

Sigurisht, më parë se Vahd Kormaku të ishte një hulumtus i spikatur i historisë e traditës, Ai ishte mësues. Nuk është e qartë nëse pas mbarimit të gjimnazit vijoi të punonte, në Selanik, pranë të atit apo u kthye në vendlindje. Në vitin shkollor 1920- 1921 përfundoi një vit studime në Normalen e Elbasanit. Këtu mori njohuri të karakterit didaktik e metodik, shumë të nevojshme në misionin e ardhshëm të mësuesit.

Në monografi shkruhet se më 1921 filloi punë si mësues në fshatin Tunjë-Gramsh. Nga të dhënat që gjenden në Aqsh, f.195, v.1937, d.73, fl.327 emri i vendit ku Vahidi filloi punë nuk lexohet mirë duke krijuar edhe ndonjë dilemë. Pa pretenduar monopolin e të drejtës (deshifrimi është detyrë specialist), mendoj se bëhet fjalë për fshatin Homesh e jo Gramsh. Homeshi ishte qëndër e rëndësishme administrative, me patriot potencial, me shkollë që nga rëndësia krahasohej me internatin "Kastrioti" dhe "Mati". Vahidi me kulturën, shkollimin, kualifikimin mund të ofronte shërbimin e tij në këtë shkollë. Edhe ndarja administrative është më afër mendimit tonë, pasi Golloborda e Homeshi ishin brenda të njëjtës njësi administrative. Madje, Vahidi gjithë veprimtarinë si mësues e hulumtues e kreu brenda njësisë administrative ku lindi, gjegjësisht në fshatrat e Gollobordës e Bulqizës, nënprefektura, Zerqan. Në qoftë se ka shërbyer në Tunjë të Gramshit, mendoj se bëhet fjalë para përfundimit të një viti studime në Normalen e Elbasani, pra para vitit 1921. Themi këtë pasi fillimet në arsim nuk mendojmë se i takojnë moshës 25 vjeçare, por më parë. Sidoqoftë kjo është një çështje që kërkon më shumë kërkim, të dhëna e analizë.

Me shkresë Nr.226/3 datë 10/01/1922 Vahidi u emërua mësues në Ostren të Madh Këtu filloi punë, më 23/01/1922. Pra, nuk rezulton në Tunjë të Gramshit(nëse po, rezulton vetëm për 3-4 muaj). Në vitet 1923-1926 shërbeu në Borovë. Në këtë kohë vjen në Gollobordë Prof.Friedrich Markgraf. Vahidi hapi dyert e shtëpisë së tij, ofroi mikprite e bashkëpunim në misionin e tij të botanistit. Markgraf gjeti te Vahidi një intelektual me kulturë të gjerë, me një bibliotekë të pasur për kohën, bashkëpunues, vëzhgues e hulumtues të kualifikuar të natyrës, botës bimore, një koleksionist të vleftë. Kohë më vonë, Friedrich Markgraf do të shkruante me shumë konsideratë për koleksionistin, Vahid Kormaku.

Gjatë kohës që shërben në Borovë i nënshtrohet një kursi të shpejtë kualifikues në aspektin didaktik e metodik. Autoritetet arsimore lokale e qendrore kishin formuar konsideratë shumë të mirë për punën e tij si mësues. Nisur nga kjo, por dhe fakti që arsimi bazë ishte gjimnaz, në harkun kohor 15/7/1925-5/9/1925 iu nënshtrua kursit të shpejtë pedagogjik, në Shkodër. U trajnua nga figura të shquara të arsimit kombëtar si Luigj Prela, Simon Rota(piktor i përmasave të mëdha kombëtare shën.im) etj. Gjatë viteve 1926-1929 Vahidi shërbeu në Ostran të Madh. Me shkresë Nr.5426/9 datë 01/02/1930 filloi punë në vendlindjen e tij, Steblevë. Këtu nuk qëndroi shumë kohë pasi në vitin shkollor 1931-1932 shërbeu në Bulqizë. Në vitet 1932-1937 rikthehet në vendlindjen e tij, Steblevë, duke e mbyllur karrierën pedagogjike në moshë të re, Klenjë, më 1946.

Gjatë veprimtarisë së tij si mësues, Vahidi i ofroi arsimit kombëtarë shërbime të çmuara. Shquhet për pasionin me të cilin u transmetoi brezave njohuri mbi gjuhën amtare shqipe, për të cilën shkruante se është nga gjuhët ma të bukura, ma të pasura të Evropës. Përveç punës së drejtpërdrejt të mësuesit, Vahidi gjatë gjithë punës së tij në Gollobordë ka qenë edhe një aktivist i shquar. Duke parë nevojat e banorëve për arsim, me iniciativën e tij, hapi kurse për shkollimin e tyre, veçanërisht të grave .Ai u bë kështu një kontribues i rëndësishëm për emancipimin shoqëror e kulturor në tërë krahinën e Gollobordës. Duke vëzhguar nga afër kontributin e Vahidit, cilësitë individuale si mësues, intelektual, personalitet e aktivist shoqërorë, në vlerësimin e Ministrisë së Arsimit, më 1937, shkruhet: "… Asht nji nga mësuesit e vjetër, mjaftë i aftë në të kryemit të detyrës së mësuesit…asht i squet, i zellshëm e i vemendshëm. Përveç detyrës si mësues i ka kushtue nji aktivitet të madh edhe zhvillimit e përhapjes së gjuhës shqipe, jo vetëm ndër nxanës, por edhe në popull të pashkolluem e ndër gra duke qenë në këtë mënyrë si qytetar i nevojshëm e shqiptar i mirë".

Në këtë përvjetor të 130-të të shkollës së parë shqipe u përpoqëm të ofrojmë te lexuesi një indikacion modest nga kontributi i madh e i gjithanshëm i mësuesit patriot Vahid Kormaku. Kontributi që ai i ofroi shoqërisë, brezave kërkon më shumë vemendje, pasi në monografi nuk ka gjetur vendin e duhur. Besojmë se Vahid Kormaku e ka vendin përkrah kontribuesve më të shquar të arsimit në Gollobordë, Dibër e më gjerë. Me atë çka i ofroi krahinës , Ai ka qenë nderi i saj.



portret

Një rrjedhë loti në bisedë me vajzën e tij Imelda Hodo Daki.

Hamit Hodo, profesori i Bujqësores së Peshkopisë...

Nga **ABDURHIM ASHIKU**

A to fletë letre, shkruar me makinë, i gjeta një ditë mes fletëve të zverdhura që kisha marrë me vete "nëntë male kaptuar". Ishin konkluzionet e një eksperimenti për një bimë foragjere që ai, me përkushtim e disiplinë shkencore, kishte mbjellë dhe e rekomandonte për shtrirje të gjerë jo vetëm në kushtet e luginës së gjerë të Drinit të Zi por edhe më në lartësi...

Kishte ardhur nga larg, nga Rradhima e bukur e Vlorës për tu bërë dibran e për të ikur larg, shumë larg si dibran...

Kishte ardhur, si edhe shumë të tjerë nga veriu në jug të Shqipërisë për "pak kohë" e për tu bërë kohë e Dibrës...

Hamit Hodon, me ato fije letre e kisha dokumentisht me vete, ashtu siç e kisha në fotografi e mbi të gjitha në kujtesën e një miqësie që vetëm "dhuna" e kohës mundi të na ndajë...

Ishte dhe mbeti njeriu më i afërt shpirtëror imi, shok e vëlla, byrazer gjaku rrjedhë e ushqimit në gojën e njeri-tjetrit...

U njoha, ose më saktë e lidha deri në koncentrim njohjen, në Shkollën e Mesme Bujqësore "Nazmi Rushiti", atë universitet të bujqësisë së Veriut të Shqipërisë nga kanë dalë njerëz të dijes e të kulturës, shkrimtarë e poetë, shkencëtarë e dijetarë jo vetëm të bujqësisë.

Se Dibra kishte pa asnjë dekret kuvendar tre universitete:

"Universitetin Pedagogjik", Shkollën e Mesme Pedagogjike të Peshkopisë, një ndër të parat shkolla të mesme të hapura pas çlirimit (1947) buronja e dijes dhe e arsimit, e shkollimit të fëmijëve, e emancipimit të vajzave për të gjithë Veriun e Shqipërisë...

"Universitetin Bujqësor", Teknikumin Bujqësor të Peshkopisë që hapi sallat e studimit më 1 shtator 1959.

Universitetin Popullor të Dibrës ku njeriu hynë e mbetet student i përjetshëm...

Dy të parët "kohëte reja" i shuan, ashtu siç shuan edhe degën e universitetit të Durrësit në Peshkopi...

Hamit Hodo u bë një ndër njerëzit që i dhanë shumë Dibrës.

I dha si mësues i lëndëve teknike, i zooteknisë dhe i shkencave të tjera... I dha si një njeri me dije e kulturë të gjerë...

Sa breza nxënësish dëgjuan dhe admiruan zërin kumbues të Hamit Hodos tek i tërhiqte në mësim, në mësimin brenda kornizave të programit e në botën që u hapte duke i përcjellë në skaje të gjera të dijes...

Sa breza nxënësish morën dhe bënë pjesë të jetës urtësinë e fjalës së Hamit Hodos ?

E kam në sy apartamentin modest të Hamitit, "dhomë paradhomë" në katin e tretë të një ndërtese pranë kopshtit dhe çerdhes së fëmijëve të lagjes "Gjokë Doçi".

Kam në sy Hazizen, një grua që ishte shembull i vlerës bashkëshortore. Kam në sy Imeldën kur erdhi e vogël, e brishtë për tu bërë pjesë e gëzimit të çiftit Hamit e Hazize Hodo.



Hamiti, Hazizja dhe Imelda ikën një ditë nga Peshkopia. Ikën për tu vendosur në një shtëpi të vogël në stacionin e fundit të autobusit të Tiranës së Re, në një shtëpi bashkë me vëllain e Hamitit – Kadriun, një specialist që i dha shumë kohës së vet, pa marrë asgjë.

Atje e kam takuar për të fundit herë Hamit Hodon...

Atje kam pirë kafen e fundit me të...

Unë qesh i detyruar të ikja larg e larg për tu mbajt në këmbë, vetë dhe familja.

Me vete mora edhe mikun tim më të mirë Hamit Hodon...

E kërkova nga larg, madje trokita një ditë edhe në portën e shtëpisë së Kadri Hodos...

Njerëz të tjerë gjeta e gjunjëkëputur mora teposhtën e shkallëve...

Një ditë, falë mjeteve të kohës u lidha me Imelden...

Ishte rritur Imelda, shoqe e ëmbël e vajzës time Erblinës. Ishte martuar dhe kishte marrë me vete në Francë, qytetare e së cilës ishte, edhe Hamitin me Hazizen.

Me dhimbje mësova se miku im i mirë Hamit Hodo kishte ikur duke lënë pas një dhimbje në shpirtin e Imeldës dhe Hazizes.

Imelda më shkruante...

"Mirëmbrëma Xhaxhi !

Babi ishte shumë i sëmurë dhe në vitin 2005 gjendja e tij sa vinte dhe rëndohej. Në atë kohë jetonte në Tiranë. Në fund të atij viti i marr të dy mamin dhe babin tek unë në Francë. Ai pati kancer të rëndë në mushkri dhe probleme kardiake. Mjekët nuk më dhanë më as kohë dhe as shpresë. Por im atë ishte shpirt luftarak edhe pse sëmundja e treti.

Jetoi edhe dy vjet dhe tejkaloi çdo pohim të mjekëve. Ndenji rreth një vit në spital. Deri në momentin e fundit që i mbylla sytë ishte në vetëdije të plotë.

E operuan me 5 janar 2007 në zemër dhe nuk e përballoi dot.

Pas një jave me 11 janar vdiq në spital përpara duarve të mia.



Para se të vdiste mami dhe unë i kërkuam se ku donte të prehej, në Radhimë apo në Tiranë tek i vëllai. Na vështroi mua dhe mamin, na kapi duart dhe mu drejtua:

"Nëse unë varrosem në Tiranë apo Radhimë sa herë do të mund të kthehesh ti Imelda tek varri im? Ndoshta 10 apo 15 herë gjatë gjithë viteve.

Babi ka dëshirë të varroset aty ku je ti, ku jeton ti. Në çdo moment të jetës tënde ti të më kesh pranë dhe të vish te babi sa herë që të kesh dëshirë apo hall. Do të jem pranë gjithmonë.E doja shumë Kadriun (fliste për të vëllain) dhe e nderova deri në fund por babi do të jetë gjithmonë pranë teje".

I dha forcë dhe siguri pëlqimi edhe mamit, e cila hezitonte për këtë gjë. Por im atë si burrë i mençur dhe fjalë pak vendosi dhe në vdekje për të mirën e vajzës të tij .

Unë mora jetë prej tij dhe mora peng edhe dashurinë e tij.Të gjitha këto xhaxhi babi i bëri për mua për të më lehtësuar sa më shumë jetën. Unë sot xhaxhi jetoj me mamin, tim shoq Azemin dhe kam dy vajza dhe një djalë; Eliza, Gisela dhe Andi...

Sot është forca e Hamitit dhe dashuria e mamit që janë themeli i jetës time.

I dashur xhaxhi unë, mami dhe familja ime ju mirëpresim me shumë kënaqësi tek ne. Mami të takojë miqtë e saj fisnikë dhe imatë të presë lule molle nga miku i zemrës.

Babait tim ju bë një varrim madhështor dhe me të gjitha ndëret që një shqiptari, një profesori, një bashkëshorti dhe një babai mund ti bëhej. Sigurisht guri i rëndë në vend të vet, por im at atë varr e bëri mal për mua. Ju përqafoj me plot mall unë, mami dhe fëmijët juve dhe teta Natashën e adhuruar.

Me respekt e juaja Imelda!"

Paris 14.07. 2012

Një letër që ma coptoi lotin e ma rrëshqiti brazdave të fytyrës, një dhimbje e një fëmije të malluar për prindin e për njerëzit në gjirin e të cilëve u rrit për të qenë simbol i dashurisë së fëmijës për prindërit.

Hamit Hodo, profesori i Bujqësores së Peshkopisë tretet larg Dibrës që e deshi po aq sa deshi Vlorën dhe Rradhimën e të parëve të tij. Tretet në dhè të huaj në pritje për një degë "Lule molle" nga miqtë dhe nxënësit e tij. Në këtë 7 mars 2017 do të desha që Këshilli Bashkiak i Dibrës ta vinte në piedestalin e njerëzve që i dhanë Dibrës shpirtin e tyre, të mësuesve që lanë gjurmë në edukimin e një brezi të madh të rinjsh e të rejash. Hamit Hodo e meriton një respekt të shkruar nga Dibra.





Pasioni dhe korrektësia, zelli reformator janë trinomi i shëmbëllimit të Vasfi Cibakut si mjeshtër i mësimdhënies dhe i drejtimit arsimor. U rrit udhëve të dijes, u rrit nëpërmjet studimit, shëmbëllimit metodik shkencor e organizativ.

Vasfi Cibaku, mësuesi i përkushtuar **i Sohodollit**

Nga MEVLUD BUCI



Puna në arsim mund të krahasohet me rrezatimin e dritës, me rrezatimin hyjnor. këtë e tregon me punën dhe shembullin e tij Vasfi Cibaku, zëvendëdrejtori i shkollës së Sohodollit.

Puna dhe veprimtaritë e tij, takti e shpirti reformator, lidhja e ngushtë me problemet e shkollës e të komunitetit përbëjnë vërtet një model të ri që rrallë kund e gjen. Udhët e Vasfi Cibakut janë udhë të dijes, të shëmbëllimit, të gjurmëve të ndritura në mësimin dhe edukimin e brezave...

GENI ÇEL GENIN...

Fisi Cibaku e çdo fis në Sohodoll ka plot fisnikëri, plot prova djerse e diturie, prova që dëshmojnë për gjurmët e punës, për shpirtbardhësinë e udhët e dijes. Vërtet në Sohodoll dëshmohet ajo që thotë urtësia çidhnake "geni çel genin". Ja disa fakte: Babai i Vasfiut, Bexhet Osman Cibaku, mësues i talentuar, ish normalist i pedagoges së Elbasanit, kjo e dyta shans edhe Marjana Cibaku (Xhediku, bashkëshortja e Vasfiut) normaliste e dalluar, mësuese dhe edukatore e përvojave, bija e Dali dhe Shkurte Xhedikut të dalluar në prova pune e përkushtimi në Sohodoll e gjetkë.

Babai i Vasfiut, Bexhet Osman Cibaku, modeli i intelektualit e i zemërbardhësisë, metodisti e organizatori i frontit arsimor pasohet nga bijtë e vet, të gjithë të arsimuar e të thjeshtë, të ditur, të vendosur e ballëdritë para kohës.

Bexhet Cibaku (Abdiu) rriti dhe edukoi fëmijë të urtë, të palodhur e shpirtdritë: plot 6 fëmijë. Fejziu (Zooveteriner), Sanien (mësuese), Shkëlqimin (mësues), Vasfiun (mësues), Teftën (edukatore) dhe Qeramin (financier i lartë, studiues, shkrimtar e master në shkencat ekonomike); të gjithë me shëmbëllim, profesional, me dritë përkushtimi e diturie. S'ka si të ndodhë ndryshe. Në Dibër, Shkodër, Tiranë e gjetkë në veprimtari shumëkush i ka thënë Vasfi Cibakut: Ku je, o Prof.Dr. Nuri Abdiu?! Me të drejtë i thonë, sepse i ngjan 100% këtij korifeu (vëllai i nënës së Vasfiut, Prof. Dr. Nuriu) si në pamje edhe në dritësimin psiko-pedagogjik e drejtim arsimor.

SHQIPJA FLUTURON ME KRAHË...

Sigurisht që kjo shprehje e stërthënë këtu merr një kuptim të ri, sepse ka të bëjë me ata mësues e mësuese të palodhur të Sohodollit, me ata bijë e bija të dritës së diturisë, të cilët e nderojnë e vlerësojnë dhe e krenojnë në shpirt Vasfi Bexhet Cibakun.

E veçanta e mjeshtrit të pedagogjisë, të mësimdhënies e të drejtimit arsimor Vasfi Cibaku është se ai mëson e krenohet me nxënësit, me kolegët, me njerëzit arsimdashës të Sohodollit. Guri i rëndë peshon në vend të vet. Këtu peshon, këtu ndrit Vasfi Cibaku.

Drejtori i shkollës gati veterani i arsimit Sulë Abdiu, me 42 vite punë vëren tek Vasfi Cibaku; Makarenon e kohës së re, mësuesin e drejtuesin reformator. I miri vlerëson të mirin se është vëlla me xhevahirin, i zoti vlerëson të zotin se lartëson vlerat dhe fundos të kotin... kjo është sentencë vërtetësie, reale, bashkëkohore.

DRITA E MËSUESISË

Në Sohodoll kushdo që shkon, ndjen në shpirt peshën e rëndë të brezave të diturisë. Intelektuale me plot përkushtim, me rrezatim mirësie e diturie, me prova për jetën, traditat e të vërtetat historike, për breznitë. Vasfi Cibaku flet në nderim për Rabie Veliun, Xheme Cibakun, Jonuz Ramku, Mimoza Mërdinin, Ogerta Cibaku, Burbuqe Cibaku, Renisa Kadriun, Hava Shehu, Zade e Shqipe Methasani, për idhullin e tij Qatip Cibaku. Nga urtia e saktësia e prof. Vasfiut mëson për përvojat, shembullin reformator të kolegëve, nderimin për të tjerët. Nga ky zv.drejtor i përkushtuar mësuam shumë për mësuesit e shquar bashkëshortet Hava e Shaban Shehu për koordinatoren e dalluar të Qeverisë së Nxënësve, mësuese e anglishtes Erlinda Shahu (Merdini) për Hasime Xhilagën, Vera Hysën (edukatore) e dalluar e Borovjanit. Drita e përkushtimit mësimor edukativ shpirti krijues, drita e taktit në drejtim, drita e kolegëve në shkollë rrezatojnë atë që nuk vyshket kurrë – dritën e mësuesisë.

UDHË TË RRITJES, UDHË TË PROVAVE...

Pasioni dhe korrektësia, zelli reformator janë trinomi i shëmbëllimit të Vasfi Cibakut si mjeshtër i mësimdhënies dhe i drejtimit arsimor. U rrit udhëve të dijes, u rrit nëpërmjet studimit, shëmbëllimit metodik shkencor e organizativ.

Biografia e shkollimit dhe e punës se Vasfiut përbën një model reformues, mjeshtër të taktit e të komunikimit në mësimdhënie e drejtim. Këtu në vendlindje ku sot drejton me urti e kompetencë, këtu u shkollua me fëmijërinë e parë. Pas përfundimit të gjimnazit në Peshkopi dhe stazhit një vit në ish-kooperativën bujqësore shërben mësues në Kala të Dodës, më pas ushtar në repartin 1390 si radio-ndërlidhës në Tiranë, më pas student në Universitetin e Shkodrës në fakultetin e ciklit fillor. Në vitet 1985-2001 Vasfi Cibaku shembëllen si mësues në shkollën 9-vjeçare në Kastriot. Puna me nxënësit, takti edukativ, lidhja në komunitetin, respekti për nxënësit, mësuesit (kolegët) e prindërit e bënë me emër, dëshmuan provat në udhët e dijes, në udhët e rrezatimit arsimor.

Kurdoherë kërkues ndaj vetes, ndihmës e dashamir ndaj kolegëve, i thjeshtë, këmbëngulës e veprues. Vasfiu dallohet edhe në punën gjurmuese, studimore. Më 2001 së bashku me ish rektorin Shezai Rrokaj e studiuesen e talentuar të Institutit Pedagogjik Mimoza Gjokutaj punoi për abetaren eksperimentale. I përkushtuar, ndihmues ndaj mësuesve të rinj, kurdoherë udhëve të djersës e të vetëveprimit si mësues në Sohodoll në vitet 2001-2003 si drejtor i shkollës së Kastriotit në vitet 2003-2006 më pas mësues në Kastriot e Sohodoll dhe nga viti 2014-2016 zv. Drejtor në shkollën e fshatit të lindjes, në Sohodoll.

Familjen e Vasfi Cibakut përbën një minikëshill pedagogjik. Vëllezërit, motrat, dajallarët, babai -normalisti i shquar Elez Bexhet Cibaku, bashkëshortja e Vasfiut Marjana Cibaku (Xhediku) ish normaliste, sot mësuese (edukatore) e dalluar, të shquarit e mësuesisë Sania, Shkëlqimi, Tefta, studiuesi e shkencëtari Qerami, fëmijët e edukuar e të zotë për dije e kulturë, të mirëedukuar nga Marjana e Vasfiu: Rovena diplomuar për filozofi; Jurisana, diplomuar për historigjeografi kurse djali i vetëm Endri Vasfi Cibaku vazhdon vitin e 3 të gjimnazit "Seid Najdeni" në Peshkopi. Provat në familje e në fis, provat në udhët e dijes, dekorimet me "Mirënjohje" si reformator i edukimit qytetar, mirënjohja nga ish Drejtori i Drejtorisë Arsimore Dibër, z. Gëzim Koçi janë një simbolikë mirësie. Takti i vetëveprimit, forca krijuese, realizimi mjeshtëror i etikës e propagandës pedagogjike në shkollë, motivimi i kolegëve, roli aktiv për ta bërë shkollën vatër të edukimit komunitar, janë prova të zv.drejtorit Vasfi Cibaku.

Së fundmi, një veprimtari masive për liderin. Vasfiu, së bashku me kolegët me Qeverinë e Nxënësve, demonstruan përvojën, traditat dhe ecuritë bashkëkohore. Këtu morën pjesën edhe përfaqësuesit e DAR-Dibër inspektor Defrim Kaleci, zv. Drejtori i shkollës së Mesme të Kastriotit Artur Hasi, drejtori i shkollës së Vakufit Halit Doda, drejtor i shkollës Vrenjt Indrit Shehu, menaxherja e organizatës "World Vision", Valentina Hysenaj, veprimtarë të komunitetit. U pa dhe vlerësua, puna me librin, kultura pedagogjike e mjedisit, u diskutua nga nxënësit e talentuar, u bënë recitime, u pasqyrua thjesht e qartë ecuria reformuese: "Shkolla qendër komunitare". Aty u pa sesi zv.drejtor Vasfiu, si kurdoherë, flet aq sa bën dhe bën atë që thotë, kurdoherë kërkues, veprues, organizator, i papërtuar dhe dashamirës, udhërrëfyes për shkollën e përparimin.

Edhe prindërit Bilbil Tafa e Artur Hasan Xhediku, thonë fjalët më të mira për Vasfiun. Pasqyrë e arritjeve me mbi tri dekada në frontin mësimor-edukativ. Faktet veprimtaritë, nderimi komunitar e mbi të gjitha nderimi i nxënësve, kolegëve, e eprorëve në Dibër dëshmojnë se Vasfi Cibaku ka prova diturie, organizimi, prova në udhët e rritjes e përkushtimit në arsimin shqiptar.

BISEDË ME ING. SHABAN BITRIN, AUTORIN E LIBRIT *"JETË NË VEPRAT E MËDHA"*

Libri "Jetë në veprat e mëdha" është një autobiografi e një inxhinieri, i cili largohet fëmijë nga vendlindja dhe gjithë jetën është në ndërtim të veprave të mëdha, hidrocentrale, rrugë, hekurudhë, ura etj.

Në librin e botuar është jeta e tij në hidrocentralin e Fierzës, ku punoi mbi 9 vjet, dhe më pas në HEC e Komanit mbi 4 vjet, janë shokët, kolegët, miqtë, familja, Dibra dhe dibranët, me të cilët ka punuar në ato vepra të rëndësishme, me të cilët ka ndarë gëzimet, vështirësitë, ka diskutuar e debatuar për problemet dhe shqetësimet e jetës dhe punës. Një bisedë me Shaban Bitrin është gjithmonë e ngrohtë, e paqtë, por edhe me mendim dhe frymëzim.

- Inxhinier, meqë jemi në prag të festës së Mësuesit, si i kujtoni mësuesit tuaj?

- Shkollën fillore e kam kryer në fshatin tim, Blliçe, ku mësimet e para i mora nga mësuesit e përkushtuar në edukimin tonë Aqif Spata, Selman Tota e Sul Koltraka... Më pas, në vitin 1961, vazhdova 7-vjeçaren në Fushë Alie. Ishim një grup nxënësish që nga klasa e pestë deri në të shtatën që punonim me pasion e dashuri për të mësuar, duke nxjerrë kuadrot e parë që vazhduan studimet në shkollën e lartë në degë të ndryshme, si Munir Hoxha, Ismet Kuta, Sakip Dauti, Lazam Nezha, etj. Kjo traditë vazhdoi edhe në vitet më pas, duke nxjerrë breza me rezultate të shkëlqyera, duke nxjerrë mësues të mirë, agronomë, mjekë, ekonomistë, inxhinierë, zooteknikë, ushtarakë, gazetarë, artistë e shkrimtarë... Mund të përmend disa prej tyre, si Muhamet Bitrin, Vesel Hoxhën, Maliq Bitrin, Zylfi Spatën, Rruzhdi Bitrim, Xhetan Kutën, Rushit Bitrin, Uzri Hoxhën, Sadin Bitrin, Bilbil Bitrin, Rushit Markun, Arian Bitrin, Xhevdet Kacanin, Halit Hoxhën, Pajtim Përnezhën, Nexhbetin Markun, Mentor Hoxhën e shumë të tjerë, të cilët sot shkelqejnë në fushat e profesionet e tyre ku pnojnë dhe kontribuojnë,

Shkollën e mesme e mbarova në Teknikumin e Ndërtimit Tiranë, si konviktor, me një grup nxënësish të përkushtuar ndaj mësimit si Hasan Demiri, Mevlan Balliu, Asllan Lala, Sulejman Cani etj.

- Nga shkolla e mesme, në punë dhe pastaj në universitet?

- Po. Puna ime nisi si teknik ndërtimi në Pukë, ku nuk mund të harroj kryeinxhinierin e ndërmarrjes Vito Koçi dhe kolegun Robert Zajmi për ndihmën që më kanë dhënë. Pas përvojës praktike në Pukë, në vitin 1970 dyert e universitetit do të hapeshin për mua, duke iu futur kështu profesionit të bukur të inxhinierisë.

Gjatë periudhës 4-vjeçare si student, krahas përkushtimit për të realizuar programin mësimor, rritëm edhe shoqërinë tonë studentore me shokë shumë, mes të cilëve kujtoj Vangjel Detin, Mevlan Balliun, Kujtim Bejtajn, Aleksandër Angjeliun, Robert Zajmin, Anesti Stillon, me të cilët ndamë bashkë gëzimet e shqetësimet.

- Pas universitetit ju priste Fierza...

- Jetën time të rinisë e fillova në HEC e Fierzës në Gusht të 1974 dhe punova aty deri në përfundimin e tij në vitin 1983, duke kaluar më pas në Koman, ku punova deri në vitin 1986. Për më shumë se 14 vite me radhë, punë në këto vepra më bëri më të fortë për të përballuar vështirësitë e mëdha që kishte puna dhe jeta. Më rriti profesionalisht, më mësoi të punoja me njerëzit, të diskutonim e t'u jepnim zgjidhje problemeve, pasi në një vepër kaq e madhe, asnjë punë nuk fillonte pa kaluar më parë përmes diskutimit, konsultës dhe marrjen e vendimeve së bashku. HEC i Fierzës është një vepër e madhe energjetike jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan.

- A ishte e vështirë puna në hidrocentral?

- Një nga vështirësitë e kësaj vepre ishte ndërtimi i digës me bërthamë argjili, material vendi. Për përgatitjen e argjiles dhe hedhjen e saj në vepër u deshën me mijëra analiza, të cilat kërkonin kohën e nevojshme. Ajo u mor afër qytetit të Bajram Currit, rreth 20 km larg nga diga. Përqindja e lagështisë së saj i kalonte kërkesat e projektit, ndaj argjila u vendos në një fushë afër hidrocentralit dhe u bë kavalet. Atje hidhej një shtresë zhavorr, një argjil, deri në përcaktimin e lagështisë optimale, sipas kërkesave që kërkonte projekti. Dhe për këtë u deshën mbi 5 muaj derisa provat laboratorike provuan se tashmë argjila ishte gati për në digë.

Por paralelisht punohej me intensitet në të gjitha objektet e tjera: në përgatitjen e bazamentit të digës,

intervistë

Unë punova mbi 40 vjet si inxhinier ndërtimi, në hidrocentrale dhe vepra të tjera të mëdha, por asnjëherë nuk m'u dha mundësia të punoj e të kontribuoj në vendlindjen time, Dibër. Por kudo ku kam punuar Dibrën e kam pasur me vete, duke u përpjekur ta nderoj e përfaqësoj sa të mundem.

Një jetë mes **veprash të mëdha dhe** kolegësh **të talentuar**

galerive nëntokësore në aksin e digës. Në këto fronte puna, një kontribut shumë të madh ka dhënë brigada e minatorëve që drejtohej nga Shaban Gjoka. Për punën e madhe që bënte kjo brigadë u quajt nga ne inxhinierët si "brigada e zjarrfikëses". Këtë emër e mori pasi ajo të nderonte në çdo front pune dhe të zbardhte faqen për kryerjen e punimeve në kohë reale.

Një nga problemet e mëdha në Fierzë kanë qenë ndërtimi i kullave të tuneleve të shkarkimit. Në momentin kur punimet ishin drejt përfundimit, ku po bëhej pastrimi i bazamentit në ajër me presion, erdhën drejtues të lartë të Ministrisë së Ndërtimit, drejtori i përgjithshëm i hidrocentralit. Ata na lavdëruan për punën që kishim bërë. Ne vazhdonim të punonim më dy turne për 24 orë rresht në ditë, por një shi i madh na detyroi ta ndërprisnim punën. Lamë njerëz që vëzhgonin me kujdes skarpatet për rast rreziku shembjeje. Ata, nga vrojtimet, panë se lëvizja e gurëve ishte më e shpeshtë dhe dhanë alarmin për largimin e të gjithë mjeteve e makinerive nga objekti. Gjatë gjithë natës vazhdoi një shi i dendur. Në mëngjes pamë se një masiv shkëmbi, rreth 15 mijë m2, kishte rënë mbi bazamentin e kullës.



Kur më është dhënë mundësia të punoj në punë që kanë pas të bëjnë drejtpërdrejtë me Dibrën, jam përpjekur të bëj më të mirën e mundshme, sepse ajo më ka dhënë shumë gjatë jetës, ndërsa unë ndjehem borxhli ndaj saj...

- Si u menaxhua situata?

- Gjendja e krijuar nga shembja iu bë e ditur drejtuesve kryesorë të ndërmarrjes, dhe erdhën në objekt specialistë të ndërtimit si edhe ing. gjeologë Nuro Dhima dhe drejtuesit e tjerë të ndërmarrjes. I pranishëm ishte edhe drejtori i përgjithshëm, Ismail Ahmeti, i cili mblodhi kolektivin e sektorit dhe ndër të tjera tha: "Jeni të gjithë mirë? S'ka asnjë dëmtim tek njerëzit? Kjo është kryesorja, pasi në veprat e mëdha ndodhin ngjarje të tilla, por ne duhet të jemi të interesuar në radhë të parë, të mos gërvishtet asnjë gisht. Pasi kujdesi për të siguruar dhe mbrojtjen e punonjëse është në plan të parë. Por, tani duhet të lëmë pas këtë ngjarje dhe duhet të mobilizohemi për të realizuar sa më shpejt evadimin e kësaj shembjeje." Për gati 10 ditë bazamenti u bë gati për hedhjen e betonit.

Në vepër punohej më intensitet edhe në të gjitha objektet e tjera, sidomos në sektorin e digës, ku punohej për ndërtimin e bazamentit të digës e galerive nëntokësore në aksin e digës, me qëllim që më pas të punohej me intensitet për çimentimin e shkëmbit ose siç thuhet, ndërtimi i digës së nëndheshme. Thellësia e çimentimit të shkëmbit shkonte mbi 50ml. Me përfundimin e ndërtimit të galerive, puna fillonte në ndërtimin e bazamentit të digës, hedhjen e argjilës, ndërtimin e bërthamës së digës, etj.

Për ndjekjen e këtyre punimeve, mbushjen e bërthamës me argjil, granil, çakull dhe gur, ishte një grup projektuesish që qëndronin në terren, që drejtoheshin nga ing. Farudin Hoxha dhe projektues të tuneleve si: Egon Gjadri, Gëzim Struga, Stavri Peci, prof. Petrit Radovicka e shumë kolegë të tjerë.

Për teknologjinë e hedhjes së argjilës nuk kishte asnjë mangësi ose neglizhencë. Shtresat hidheshin me trashësi 20 cm dhe bëhej rulimi me rula gome me peshë mbi 60 ton dhe zbatoheshin rregulla për rulimin dhe spërkatjen me ujë të saj, për të pasur lagështinë optimale të përcaktuar në projekt.

- Kur flisni me kaq saktësi, do të thotë që puna nuk lejonte tolerime?

- Jo. Nuk tolerohej. Nuk mund të fillohej shtresa pasardhëse pa dalë rezultatet laboratorike nga laboratori fushor, i cili ishte vendosur në objekt. Vetëm kur jepej miratimi nga laboratori, atëherë mund të fillonte vazhdimi i shtresës pasardhëse të argjilës. Kur kishte raste që spërkatja me ujë nuk ishte uniformë, hiqej shtresa e argjilës në ato pjesë. Cilësia e çdo procesi pune ishte e patolerueshme.

Për punën e madhe që bëhej në HEC e Fierzës, mund të themi se të gjithë ishin heronj, por puna e secilit bënte dallimin. Mund të përmend heronjtë si Shaban Gjoka, Haxhi Mandreka, Hashim Zyberi dhe brigadier të tjerë si Zhem Peca, Isuf Kaca, Zeqir Ndreka, Dali Lika, Haxhi Billa, Bajram Lala si edhe specialist Hamit Rasha, Osman Ndreu, Isuf Elezi, Rifat Sinani, si edhe një armatë e tërë specialistësh të profesioneve të ndryshme si minatorë, karpentier, shoferë, manovrator, montator, sondist, mekanik e shumë profesione të tjera, të cilët me punën e tyre lanë gjurmë në ndërtimin e kësaj vepre të madhe. Nuk mund të lë pa përmendur kolegë dhe shokë të mi si, Kujtim Bejtaj, Genc Ajazi, Jani Peta, Jani Mako, Sali Domi, Milo Konomi, Rami Majmari, Vladimir Zëra, Anesti Stillo, Andrea Panazaqi, Mevlan Balliu, Gjergji Note, Shpëtim Kalaja, Alush Bushpapaj, Kristaq Thanasi, Ilir Prevazi, Ramiz Plaku, Iqmet Bramo, Hysen Dervishi, Ilir Metohu, Gligor Toslluku, Gani Kaceli, Petrit Kovaqi si edhe teknikët e mesëm të cilët mbajtën peshën kryesore në zbatimin për ndërtimin e objekteve të veprës nga të cilët mund të përmendim: Misto Thomagjini, Spiro Koçini, Gaspër Shelqeti, Ramadan Kadria, Jak Gjeçi, Jorgo Kristo, Ziso Xhaferi, Thoma Babi, Kozma Pjetri, Pashkë Bungaja etj.

Puna ndiqej me të njëjtin përkushtim edhe në fronte të tjera si në tunelet e turbinave, të shkarkimit, veprës së marrjes, kullave të shkarkimit, sallës së makinerive, nënstacionin elektrik. Për këtë mund të përmendim projektuesit si prof. Egon Gjadrin, Gëzim Struga, Stavri Peçi, Met Hadëri etj.

Për projektimin e HEC Fierzë punonte një armatë e tërë inxhinierësh që merreshin me projektimin e objekteve të hidrocentralit. Instituti i Veprave Hidroenergjetike ishte nga institutet më të mira në atë periudhë. Dua të theksoj se puna voluminoze për projektimin dhe zbatimin e tyre në vepër, një rol kryesor kishte drejtori i përgjithshëm z. Ismail Ahmeti, i cili ishte një drejtues me vizion, me aftësi drejtuese e menaxhuese. Ishte shumë i përgatitur, këmbëngulës e serioz. Niveli i lartë profesional e bëri atë një person me personalitet, autoritet e komunikues, por edhe me një zemër të madhe.

- Në një kuptim, Fierza ishte "shkolla e madhe" e edukimit profesional?

- Fireza ishte shkollë e madh e edukimit profesional. Aty zhvilloheshin kurse të vazhdueshme profesionale, si: minator, karpentier, sondist, betonist, hidraulik, elektricist, montator, mekanik, xhenerik e pompist, por gjithashtu funksiononte edhe shkolla e mesme profesionale për degët ndërtim, elektrik e mekanik, ku përgatiteshin kuadrat e mesme për këto punë. Inxhinierët testoheshin nga komisione të veçanta dhe në bazë të formimit të tyre, bëhej vlerësimi profesional dhe rritja e pagës sipas vlerësimit për inxhinierë të kategorisë së parë, të dytë edhe të tretë. Unë, si inxhinier i ri, u vlerësova në vitin 1978 nga komisionet e kualifikimit si "inxhinier i Klasit të Parë". Në Fierzë u përgatit një armatë e tërë specialistësh, që do të punonin më pas në Koman edhe në vepra të tjera energjetike.

Në Fierzë, në ndërtimin e kësaj vepra të madhe hidroenergjetike të vendit, kanë punuar mbi 20.000 punonjës me intensitet të lartë në të gjithë sektorët e veprës. Realizimi i punimeve u bë nga teknikët dhe inxhinierët shqiptar, që punonin në çdo objekt të kësaj vepre me përgjegjësi, përkushtim e sakrifica të mëdha. Të gjithë specialistët e të gjitha fushave punonin pa u lodhur, duke kaluan rininë e tyre në këtë kantier të madh ndërtimi.

Në muajt e parë të vitit 1981 ndërmarrja u transferua në HEC e Komanit. Në Fierzë ngeli një kantier i fuqishëm me rreth 1000 punëtorë. Unë u largova i fundit nga inxhinierët për në Koman, në Mars 1983, pasi vepra iu dorëzua Ministrisë së Energjetikës. Punimet në Fierzë kanë përfunduar rreth 35 vite më parë, por gjatë kësaj periudhe, për arsye shëndetësore, nga sëmundje të ndryshme ka nga ata të cilët nuk jetojnë më. Dhe po përfitoj nga rasti t'i ngushëlloj familjet e tyre, si edhe të rënëve t'u prehet shpirti në paqe.

- Si ishte të kaloje me punë nga Fierza në Koman?

- Në Koman fillova punë si drejtues i laboratorit, ku bashkë me kolegët bëmë një punë shumë të madhe për të përmirësuar recetat e betonit, duke rritur cilësinë e tyre, por ndërkohë kursyem mbi 5% e sasisë së çimentos për m2. Gjithashtu u bënë shumë studime të tjera në fushën e rritjes së cilësisë të materialeve të ndërtimit që hidheshin në vepër. Për punën e madhe të bërë nga personeli inxhinieroteknik i laboratorit është vlerësuar nga ekspertë dhe specialist të Institutit të Ndërtimeve si edhe ekspertë të Ministrisë së Ndërtimit, pasi cilësia e prodhimit të betonit ishte e një cilësie të lartë që garantonte cilësinë e veprës. Në këtë angazhim të madh nuk mund të lë pa përmendur kolegun tim, inxhinier Fitim Mata si edhe teknikë të laboratorit që punonin me përkushtim, si: teknik Viktor Gaci e Prek Bisha, Dod Doçi, i cili kishte dëshirë dhe vullnet për të studiuar, që më vonë shkoi në shkollën e lartë dhe sot është një biznesmen i suksesshëm.

Në këtë angazhim për realizimin e këtij objektivi patëm mbështetjen e drejtuesve të ndërmarrjes, si të kryeinxhinierit Kujtim Bejtaj, si edhe na inkurajuan dhe na mbështetën edhe kolegët si ing. Jani Mako, Shqefen Zefi, Bashkim Shehu, Hysen Dervishi etj.

Në hidrocentralin Koman punova edhe në kantierin e prodhimit si kryeinxhinier kantieri dhe në janar 1986 u transferova në hekurudhën Milot-Rrëshen.

- Nga hidrocentralet në hekurudhë. Më pas në ndërmarrjen e ndërtimit në Shkodër? Si e përjetua ndryshimin e frontit të punës?

- Në hekurudhën Milot-Rrëshen-Klos, në atë kantier të madh, mbulonim peshën më të madhe për ndërtimin e të gjitha urave si edhe ndërtimin e një pjese të trasesë së hekurudhës. Punohej në shumë fronte njëkohësisht ku punimet drejtoheshin nga ing. dhe teknikë. Këtu mund të përmend ing. Ramadan Bumçi, teknik Pertaq Dajçi etj.

Me transferimin tim më rrethin e Shkodrës, unë punova në N.N rrugëve Shkodër ku objekt kryesor ishte ndërtimi i rrugës Fushë Krujë-Milot me gjatësi 24 km. Ishte një objekt i vështirë, pasi për herë të parë, zbatoheshin punime në rrugë të klasit të parë me shpejtësi 80 km/orë. Unë kryeja detyrën e drejtuesit teknik dhe kryeinxhiner i ndërmarrjes dhe për realizimin e punës në këtë objekt të madh pata mbështetje nga projektuesit e kësaj vepre të drejtuar nga prof. ing. Faruk Kaba si edhe nga kolegët e mi: Milo Konomi, Nazmi Juka, Kujtim Kastrati, Gazpër Shelqeti e Gëzim Mezini si edhe shumë kolegë të tjerë.

- Si ishte të lije punën shtetërore dhe të kaloje në biznesin privat? Si i ke pasur raportet me Dibrën gjatë kësaj përvoje?

- Me zhvillimin e proceseve demokratike, në vitet e para të pluralizmit unë kalova si subjekt privat në fillimin e vitit 1994, ku vazhdoj edhe sot. Për periudhën mbi 20 vjeçare të shoqërisë ALMO konstruksion të cilën e drejtoja, ka pasur ngjitjet dhe uljet e saj. Për rritjen dhe zmadhimin e shoqërisë kam pasur mbështetje nga kolegët dhe miqtë e mi, si: Genc Ajazi, Ram Geci, Ndue Kola, Faruk Kaba, Xhevahir Muçokllava, Bujar Makishti, Reshit Këllezi, Arbert Lenja e shumë të tjerë. Për të gjithë periudhën time si inxhinier ndërtimi për mbi 42 e vjet, u jam mirënjohës të gjithë kolegëve dhe miqve të cilët me këshillat, sugjerimet dhe ndihmesën e tyre, më bënë që të jem më i aftë në profesionin tim, si inxhinier.

Në rritjen e biznesit tim, më kanë inkurajuar vazhdimisht miqtë e mi si Nuri Abdiu, Lefter Kashta e Manol Tasillari si edhe shumë shokë e miq të tjerë.

Unë punova mbi 40 vjet si inxhinier ndërtimi, në hidrocentrale dhe vepra të tjera të mëdha por asnjëherë nuk mu dha mundësia të punoj e të kontribuoj në vendlindjen time, Dibër. Por kudo ku kam punuar Dibrën e kam pasur me vete, duke u përpjekur ta nderoj e përfaqësoj sa të mundem. Ndërsa kur më është dhënë mundësia të punoj në punë që kanë pas të bëjnë drejtpërdrejtë me Dibrën, jam përpjekur të bëj më të mirën e mundshme. Sepse ajo më ka dhënë shumë gjatë jetës, ndërsa unë ndjehem borxhli ndaj saj.

Sot jam pensionist mbi 3 vjet, që prej Janarit të vitit 2014, dhe biznesin sot e drejtojnë dhe e menaxhojnë djemtë e mi, Edmondi dhe Alfonsi.

Bisedoi: **Bujar Karoshi**

Rruga e Arbërit nr. 130

Ndërsa ky numër përgatitej për botim, autori i këtij tregimi u nda nga jeta. Redaksia u shpreh ngushëllimet familjes së Xhelal Roçit! Xhelal ishte një mik i gazetës dhe një bashkëpunëtor i mirë i saj. Shkrimet e tij për figurat historike të Dibrës, rolin e Teqesë bektashjane në historinë dhe traditat e zonës, etnografinë e krahinës së Zerqanit e Grykës së Madhe, do të mbeten vazhdimisht në memorien e lexuesve.

Dosja "gjarpri"

Nga **XHELAL ROÇI**

(vijon nga numri i kaluar)

Sigurimi i Shtetit ka qenë një ndër institucionet e kohës komuniste më të errëta dhe më të egra.

Shumë nga krimet e asaj kohe janë gatuar në ato zyra dhe sot, pas 25 vjetësh, loja me hapjen e tyre vazhdon. Pjesë-pjesë ato janë hapur, sipas orekseve të politikës, ndërsa në tregimet e jetuara të Xhelal Roçit ato "hapen" të plota: tregohen detaje, ngjarje, biseda. Por Xhelali nuk ka marrë përsipër t'i tregojë dhe zbulojë dosjet, por i sjell për lexuesit në formën letrare, si dëshmi të asaj që ka ndodhur.

Por edhe si mesazh se e kaluara nuk duhet përsëritur dhe brezat e rinj duhet t'i njohin siç kanë ndodhur ngjarjet. Vetëm kështu e kaluara nuk do të përsëritet.

"Qentë brenda avllisë bënin zhurmë të madhe, çudi që ti nuk i paske ndjerë. Desha t'u lëshoja një zë dhe të pyes për bagëtitë, por ishte shumë vonë. Atë natë dhe të nesërmen kam kërkuar bagëtitë", - i thashë.

Kamberi mendueshëm tha: "Hall është në këtë botë, edhe në shtëpinë tënde nuk të lenë rehat..."

Kryetari mbajti shënim thëniet e Saliut. E falënderoi për vigjilencën që kishte treguar, si dhe për informacionin që i dha. Ai në vazhdim i bëri kritika Saliut se ishte i vonuar, duhet të vinte menjëherë, që të nesërmen për ta takuar, qoftë edhe në shtëpi, mbasi ata njiheshin që më parë. Gjithashtu ai i dha disa këshilla Saliut, që ai t'i kishte parasysh për të ardhmen.

Ndërsa kryetari i Degës po studionte, diku nënvizonte dhe analizonte fjalë për fjalë, duke nxjerrë përfundime për secilën të dhënë që ndodhej në dosje. Ai, nisur nga ato pak të dhëna, por të besueshme, mendonte se nga ku mund të nisej puna për të çuar përpara problemin "Gjarpri". Në moment, në sallon u dëgjua një zhurmë hapash që po afrohej drejt derës së zyrës së kryetarit dhe ja, dikush trokiti.

- Hyr! – u përgjigj kryetari. Menjëherë dera u hap dhe brenda në zyrën e tij u fut punonjësi i Sigurimit të Shtetit për terrenin, efektivi i kësaj dege, Luan Kulla.

Luani, mbasi mbylli derën, mori drejtqëndrim gatitu. Kryetari i Degës menjëherë u ngrit nga vendi, kaloi në të djathtë të tavolinës dhe i zgjati dorën Luan Kullës. Ata u përshëndetën me njëri-tjetrin dhe u ulën përkarshi. Kryetari i zgjati paketën për t'i dhënë një cigare, të cilën Luani nuk e mori, duke e falënderuar.

- Besoj e kupton përse të kam thirrur.

- Si urdhëron, - u përgjigj Luani.

- Mirë atëherë, le të bisedojmë.

Luan Kulla ishte rreth 25 vjeç. Kishte trup të gjatë, të imët dhe ishte i shkathët. Kryetari e kishte njohur Luanin që gjatë jetës partizane. Në atë kohë ai ishte më i riu në moshë, doli partizan dhe u bashkua me forcat e batalionit që komandohej nga Baba Fajë Martaneshi.

"E kam në moshë të re djalin, i kishte thënë i ati i Luanit, Baba Fajës. Këtë vit ka shti pak shtat e është zgjatur."

"I priftë shëndeti! – kishte uruar Baba Faja. - Do ta mbaj me vete, mos ta keni merak se do të qëndrojë pranë meje."

I ati e përqafoi në oborr të shtëpisë Luanin dhe i tha: "T'u bëftë pushka top, or bir, në luftë kundër armiqve! Kujdes, të mos na turpërosh!"

Ishte muaji shkurt 1944, bora ishte pa shkrirë. Nga veriu frynte erë e ftohtë që të përcëllonte fytyrën. Luani akoma nuk kishte lëshuar brisk në fytyrë. Ai kishte veshur një palë brekushe prej leshi, një xhaketë dhe një palë opinga prej lëkure. Pjesëtarët e tjerë të familjes i ndiqnin me sy ata burra që kalonin tehut të kodrës dhe do të dilnin në rrugë kryesore. Pas tyre shkonte Luani i ngarkuar në krah me një torbë ku kishte futur gjërat personale, ndërsa në supin tjetër mbante pushkën që ia kishte dhënë i ati. Ditët kalonin. Luani mori pjesë në disa aksione në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër armiqve, deri në çlirimin e qytetit të Tiranës e të gjithë Shqipërisë, gjithmonë pranë Baba Fajë Martaneshit. Në raport me moshën që kishte, ai shquhej për guxim e trimëri në të gjitha aksionet. Pas çlirimit të vendit, Luan Kulla vazhdoi kursin për oficer i ushtrisë popullore në Tiranë. Në kurs doli me rezultate shumë të mira. Ai u shqua për shkathtësi, zgjuarsi dhe guxim. Pas dy vjetësh mori plevit të rëndë. Nga detyra u dërgua për mjekim në spitalin e Tiranës dhe, mbasi u përmirësua, me kërkesën e tij u çlirua nga ushtria për të filluar një punë tjetër në jetën civile. Për disa kohë qëndroi në fshat dhe filloi të merret me bujqësi.

Në fillim të vitit 1948 Luan Kullën e thirrën në organet e pushtetit dhe e caktuan nëpunës në minierën e kromit Bulqizë, e cila sapo kishte filluar të funksionontë. Ai është pranuar në ushtri që në radhët e Partisë Komuniste dhe si i tillë, ai duhej patjetër t'i bindej thirrjes së Partisë e të punonte ku do të kishte nevojë atdheu.

Puna e re i pëlqente. Aftësitë, zgjuarsia, dëshira dhe vullneti për punën nuk i mungonin. Ai shkonte e vinte në punë me bashkëmoshatarët e tij.

Kishte kaluar pothuaj një vit, kur, në muajin shkurt të vitit 1949, Luan Kullën e thirrën në Komitet të Partisë së Rrethit dhe kërkuan nga ai që, për interesat e atdheut, të ndërronte sektorin dhe vendin e punës. Përgjegjësi i zyrës së kuadrit i tha që ai do të transferohej në organet e Sigurimit të Shtetit, me detyrë oficer.

Luani u përpoq të argumentonte se akoma ishte i sëmurë dhe vetëm kohët e fundit kishte filluar të merrte veten. Nëpunësi i tha: "Unë kam porosi që mbas pesë ditësh ti duhet të paraqitesh në Ministrinë e Punëve të Brendshme".

Atje ishin thirrur dhe të tjerë. Ata i priti vetë ministri dhe u parashtroi nevojën që kishte vendi në këtë situatë, për të plotësuar boshllëkun me kuadro të reja në organet e Sigurimit të Shtetit. Atyre u thanë se me datën 1 mars 1949 do të fillonte një kurs i shkurtër kualifikimi, i cili do të zgjaste tre muaj dhe do të ktheheshin në detyrë ku i prisnin punë të mëdha. Luan Kulla, si kuadro, edhe në kurs shkëlqeu. Ai tregoi edhe këtë herë aftësinë e tij në përvetësimin e programit mësimor, në përgatitje fizike dhe ushtarake.

Mbas kursit ai u kthye menjëherë në detyrë. Filloi punën si punëtor i Sigurimit në zonë e brez kufitar. Në këtë pjesë të territorit të vendit tonë veprimtaria agjenturore e zbulimit të huaj ishte më e zhvilluar dhe më e mprehtë sesa në zona të tjera të rrethit. Ishte ballë për ballë me shtetin kundërshtar, me të cilin marrëdhëniet në këtë periudhë ishin acaruar shumë. Në bazë të analizave që bëri, Luan Kulla përcaktoi disa drejtime favorizuese për zbulimin e huaj. Në bazë të këtyre të metave do të përcaktoheshin detyrat dhe do të ndërtohej puna kundërzbuluese.

Banorët e këtyre anëve brenda vendit kishin lidhje të shumta familjare, miqësore e shoqërore me banorët e matanë kufirit. Zbulimi jugosllav, për të realizuar qëllimet e tij dhe për të organizuar punën zbuluese kundër Shqipërisë, kishte ndërruar taktikë, ai shfrytëzonte këta lidhje, shfrytëzonte zakonet e traditat e mira të popullit shqiptar si: besën e dhënë, bujarinë, trimërinë, guximin, përdorte kompromitimin moral e politik si dhe paranë kur e shikonte se jepte rezultate. Ky zbulim kishte punuar që më parë, me synimin për të ndërtuar punën zbuluese në drejtim të Shqipërisë. Ai kishte arritur të kompromotonte shumë njerëz, kryesisht ata me qëndrim të mirë politik e moral. Në këtë drejtim, më parë e kishin ndihmuar marrëdhëniet e mira në mes dy shteteve dhe lufta e përbashkët për çlirimin e dy vendeve të tyre. Gjithashtu, zbulimi jugosllav kishte shfrytëzuar edhe propagandën që ishte bërë më përpara nga qeveria shqiptare në favor të Jugosllavisë, për të forcuar dashurinë e miqësinë me popujt e këtij shteti e në veçanti me shqiptarët që banonin në ata vise nën frymën e parullës "Bashkim e vëllazërim". Aërsia kufitare me shtetin tonë i favorizonte zbuluesit e atij shteti për të organizuar takime direkte me agjenturën e tyre në Shqipëri.

Elementi kundërshtar kishte marrë revansh. Ata flisnin e propagandonin hapur se Shqipëria ka ngelur e izoluar, se në Shqipëri i erdhi fundi çdo gjëje, se qeveria shqiptare i ka ditët e numëruara. Këto shprehje shoqëroheshin me veprime demonstrative nga shteti kundërshtar. Gati çdo ditë e natë kishte provokacione e incidente në kufi, futje njerëzish ilegalisht, individë e grupe të armatosura për qëllime zbulimi e akte terroriste në vendin tonë, shpërndarje fletushkash me përmbajtje armiqësore kundër shtetit shqiptar, veprime e përplasje me armë, dëmtime në ekonomi, organizim arratisje për jashtë shtetit të personave me familje dhe me grupe personash. Të gjitha këto bëheshin për të krijuar frikë, panik, pasiguri dhe prishje uniteti në popull. Puna e organeve të Sigurimit të Shtetit, për t'iu përgjigjur kësaj situate të krijuar, ishte me mangësi të mëdha.

Forca zbuluese mungonte dhe ajo ekzistuese nuk ishte në nivelin e duhur. Ajo nuk dinte se çfarë bënte, ishte e çorientuar dhe kërkohej kohë për ta vënë në punë konkrete. Në këto kushte dhe në këtë situatë e mori detyrën Luan Kulla, në zonën ku u caktua të punojë. Atij i duhej të përmirësojë format e metodat e punës që ishin përdorur deri në atë kohë. Nga ai kërkohej punë intensive, studime të reja nga radhët e elementit kundërshtar, për të ngritur forcë të re zbuluese në radhët e këtyre personave.

Zbulimi jugosllav bënte veprime për të dezinformuar organet e Sigurimit të Shtetit. Ata, për të realizuar synimet e tyre, përdornin forma e metoda të ndryshme të veprimtarisë armiqësore. Me anën e agjenturës së tyre shpifnin e krijonin fakte të rreme kundër elementeve të shëndoshë, me qëllim që ata të goditen nga pushteti i atëhershëm popullor. Ky zbulim kërkonte që të depërtonte me agjenturën e tij në radhët e organeve të Sigurimit të Shtetit, duke u servirur atyre kandidatë për bashkëpunëtorë që t'i rekrutonin. Ata, me këto veprime, kishin qëllim që të goditnin elementet e shëndoshë, të largonin vëmendjen nga elementi armik e kundërshtar që ishte në shërbim të atij zbulimi, të ruanin agjenturën e tyre të vjetër në ata vende ku e kishin të ngritur e të ngrinin agjenturë të re, për llogari të atij zbulimi.

Gjithashtu, synonin të kompromentonin njerëz me vese e me qëndrim të ulët moral e politik dhe t'i vinin në shërbim të tyre. Në këto kushte luante rol edhe ekonomia. Në vendin tonë kishte varfëri, mungonin sendet elementare të ushqimit e të veshmbathjes. Elementi kundërshtar këto mungesa i shfrytëzonte jo vetëm për të bërë propagandë kundër shtetit shqiptar, por edhe për të kompromotuar njerëz të ndryshëm dhe për t'i vënë në shërbim të tij.

Me këto probleme në zonë ishte përplasur Luan Kulla që në ditët e para të punës së tij. Ai, në çdo moment, ishte në krye të detyrës. Korrekt, vepronte me shkathtësi e me guxim për të kryer secilën punë në kohën dhe në vendin e caktuar. Iniciativa nuk i mungonte. Aftësitë tekniko-profesionale që kishte fituar në kurs i shërbyen shumë për të ngritur punën në cilësi e në nivel më të lartë shkencor në atë periudhë të vështirë.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Nga shkrimi mbi gur tek universitarët

(vijon nga faqja 15)

Dhe ja ku u zhvillua mësimi nga data 2 Maji 1945 nën mësim dhënjen e Kurt Hoxhes. Ende vazhdonte jeta plotë mjerim skamje e vuajtje edhe për bukën e gojës e muhurrakëve. Gjithashtu akoma parregullsi në organizim dhe mungesë investimesh, e prandaj shkollimi do të vazhdonte të lëviste nëpër konaqet e fshatarëve muhurrak.

Ndërsa në Hurdhë Muhurr më 1937 u ndërtua shkolla tek kodra e Gjergjit me investimet e Dine Hoxhës. Ndwrsa nw Bulaç fillimisht shkolla u hap *në shtëpinë e Rexhep Zhuzhit e më më pas në atë të Sinan Bushit. (f.*58). Ndërsa për Vajmëdhej u ndërtua shkolla në Kalivaç, ku funksionoi nga viti 1947-1958.

Fshatarët e Rrethit të Kale si fillim fëmijët i dërgonin në Muhurr ose Vakuf. Libërshkruesi Sami Doda në bazë të dokumenteve shkruan: *''Vetëm në vitin shkollor 1961-1962 u bë e mundur që edhe fshati Rreth Kale të kishte shkollën e tij. (f.*60) Edhe fshati Shqath nuk mbeti prapa në realizimin e ëndrrave të kahershme për të mëkuar fëmijët e tyre me kulture, edukatë dhe njohuri historike, letrare e natyrore. *"Fillimisht shkolla u hap në shtëpinw e Fali Veshit, kurse në vitin e dytë në shtëpinë e Mustaf Manit (f.*63)

Duke i thirrur kujtesës, duke lexuar më vëmnedje e rrjesht pas rrjeshti, librin historik të z. Sami Doda mund të arrijm në keto përfundime:

- Pavarsisht nga varfëria e tejskajshme, nga shtëpitë e ngushta përgjithësisht me qita, fshatarët e krahinës së Muhurrit sakrifikuan gjithçka, që fëmijët e tyre të shkolloheshin, deri edhe kthimin e dhomave te shtëpive të tyre në klasa, strehimin e mësuesve që vinin nga larg në shtëpitë e tyre për vite të tëra.

- Ato jo vetëm i prisnin e përcillnin, duke iu qeshur fëmijëve por edhe i mbanin pastër duke i pastruar, lyer, meremetuar, dhomat klasa.

- Por bulaçianët e kthyen xhaminë në mësonjëtore. Duke përmbysur, konceptin idenë që në xhami shkruhet arabisht e këndohet po kështu. Patriotizmi dituria mbi gjithëçka kjo është manifestuar në këtë rast.

- Ndërsa Rreth Kalasit, përshtatën stallën e pulave në mesonjëtore. Duke vëne mbi të gjitha shkrimin e këndimin e femijëve. Pra duke e vënë diturinë në altarin e shejt të mendimit e veprimit të tyre, pra mbi gjithëçka.

LULET E PRILLIT DHE DITURIA

Mësuesit që shërbyen në krahinën e Muhurrit, që nga mejtepet në vitin 1909 e deri më ditët tona, hodhën themelet e një jete të re, hapën syte e mëndjes brezave të tëra muhurrakësh për të njohur botën që i rrethonte, për të transformuar vetveten e natyrën në dobi të tyre, për të mësuar më shumë se si jetohet e zhvillohet kultura ekonomia, natyra.

I pari mësues i gjuhës shqipe në Muhurr është Hafiz Zabit Kodra, me katër gjuhë të huaja, njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe. Në vitin 1925- 1926 vjen mësues Edip Cami nga Dibra e Madhe. Kemi një shkëputje prej disa vjetësh, kështu që shkolla rihapet më 1929 - 1930 me mësues Selim Qyshkja nga Kruja. Më 1931- 1932 rikthehet mësues Zabit Kodra dhe më pas jep mësim Irfan Roni (Barçi).

Ne vitet1932 - 1933 përsëri një mësues i ri paraqitet në shkollën e Fushë Muhurrit, tani është Asllan Zeneli nga Zerqani, i pasuar nga Abaz Shehu nga Brezhdani në periudhën 1936-1937. Kurse Gafurr Rada nga Golloborda jep mësim në vitet 1937-1938 duke u ndjekur në vazhdim nga Myslim Shehu nga Peshkopia, Hysen Hoxha nga Elbasani dhe Tofik Balla nga Okshtuni i cili i binte mjaft mirë violinës.

Një figurë tjetër mësuesi zbret familjarisht në Muhurr (1941-1942), ishte Sami Gonxhe nga Dibra e madhe, i cili kompozoi edhe dhjetë këngë patriotike e rrjeshtore. Ai pati një tjetër bashkë punëtor, ishte Ismail Lufta nga Elbasani. Më datën 2 prill 1945 Muhurraku Kurt Hoxha hap shkollën pas çlirimit të vendit me këmbënguljen e tij, duke ushtruar edhe një herë profesionin e shenjtë të mësonjëtorit.

Më pas vijnë në Muhurr, babë e bijë, Gani dhe Lirie Keta ku u strehuan në shtëpinë e Jonuz Lalës (1946-1947). Më pas vjen nga Shkodra mësues në Muhurr Ndoc Çurçia, ku u strehua tek Berishët. Selman Biba nga qafë Murra fillon të jap mësim, në periudhën, 1947- 1948, jep mësim mësuesi i ri që sapo mbaroi një kurs në Shkodër, Muhurraku Tahir Mëziu, ndërsa Adem Përhati nga Qafë Murra në vitin shkollor 1948-1949 ndodhet pranë fëmijëve muhurrak për tu mësuar shkrim e këndim. Dhe së fundi vijne bashkëshortët Bardhyl e Suzana Hakani për vitet 1951-1952. Më pas vijnë mësuesit Rruzhdi Balliçi nga Elbasani dhe Ramadan Osman Lika nga fshati Vajmëdhej.

Dhe më pas vazhdojnë të ushtrojnë mësuesinë edhe mjaft muhurrak e të fshatrave përreth, duke u shtuar klasat, numri i mësueseve, numri nxënësve, për të cilët nuk po zgjatemi.

(Botuar me shkurtime. Të plotë mund ta lexoni në linkun www.rrugaearberit.com

skicë

Koha e triskave



*Skicë nga Orhan Sakiqi**

Hamdi Dizdari ishte komshiu ynë. Kishte qenë tregtar i suksesshëm me dyqane e shtëpi, sigurisht të shtetëzuara. Tani ishte kthyer në karrocier që na sillte drutë e zjarrit. I jepnim triskat e druve dhe ai me karrocën e tij, na i sillte në shtëpi. Kjo na kursente kohen për të shkuar në fushën e baltosur të druve. Z. Hamdiu, siç i thërriste nëna ime, ishte një burrë i gjatë, i shëndoshë, faqekuq. Mbante një kapele të vjetruar republike, rripin poshtë barkut të fryrë, xhaketë të shkurtër meshini dhe çizme gome të Durrësit, që i jepnin një pamje groteske midis një karrocieri dhe një tregtari. Me kapele të mire e pa çizme ishte tregtari, kurse në gjendjen e sotme karrocieri i druve. "Nuk është turp puna", thoshte. "Me karrocë e kam filluar tregtinë, dhe tani përsëri erdha te ajo, po arsyen s'po e di", dhe qeshte me gjithë zemër. Më bënte përshtypje se kalin e mbante 'dritë', i shndriste qimja me zilka dhe me mburoje sysh, ai dukej si kalë garash sportive. "Kalin s'para e shohin, por mua diçka të re të vesh më thonë: Paska rezerva tregtari", dhe përsëri qeshte. "Punoj, thoshte, dhe jo keq, por me një tufë fëmijësh është halli te triskat"...

Mbasi sillte drutë Hamdiu dhe si me nuhatje pas tij vinte druvari lumian, Selmani. Një burrë i imët, me mollëza të dala, i parruar dhe i pafjalë, e kundërta e Hamdiut që ishte gjithë humor. Në një trastë kishte një arsenal veglash pune, sharra, sopata, pyka , çekiçë. Drutë, me gjithë kujdesin e komshiut Hamdi, nuk ishin gjithmonë të përdorshme për sobë. Kisha dëshirë të shikoja Selmanin trup vogël se me sa lehtësi e çante trungun e madh, duke i ditur damarët, siç thoshte vetë. Te damari vendoste pykën nga ku krijohej çarja, për t'i hapur rrugë pastaj sopatës. Pazari dihej, 100 lekë dhe dreka. "Punoj, thoshte, dhe jo keq, por me një tufë fëmijësh në Lumë është halli te triskat"...

Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, triskë është një fletë e vogël e ndarë në lata, ku shënohet sasia e ushqimeve , e druve, e qymyrit, e artikujve të veshmbathjes etj., që mund të marrë njeriu apo familja (në sistemin e shpërndarjes në formë të caktuar). Por triskë është edhe një dokument për anëtarësim ose lidhje me një detyrë si triskë fronti, triskë rinie, triske partie...

Fjala "triskë", brezit tonë, nuk i është ndarë gjithë jetën, shoqërues i përhershëm. Me të në dorë paraqiteshim çdo ditë te dyqani i bukës, një herë në dy javë te dyqani i ushqimeve, një herë në muaj në fushën e druve, diçka me radhë te ai i veshmbathjes. Pastaj qumështi që ishte një histori më vete.

Më të rëndësishme ishin sigurisht triskat e bukës. Çdo anëtar i familjes kishte një të tillë që e merrte kryefamiljari në qendrën e tij të punës. Triskat e bukës ishin ndarë në kategori: fëmijët dhe të moshuarit 400gr. dhe quhej ordinere, nëpunësit 600 gr. e quhej e mesme, punëtoret 800gr e quhej triskë e rëndë. E lehtë, e mesme, e rëndë, sikur të ishin pesha për boksierë. Por, mirë e kishin menduar, ajo jetë ngjante një ring boksi, vetëm me një ndryshim, se boksi vazhdonte 9 minuta, tre raunde nga tre minuta, kurse triskat aq sa minuta ka viti dhe vitet...

Triska e bukës ishte një fletë me përmasa 7x7cm, ku sipër shënohej emri dhe poshtë ishin datat e muajit që quheshin lata. Çdo latë kishte një ditë. Shitësja e bukës priste latën me gërshëre dhe e ngjiste në një fletë më të madhe, sipas kategorisë që i kushtonte kohë dhe shkaktonte shtimin e radhës. Buka ishte e zezë dhe e fortë që mezi pritej. Shumë herë zëvendësohej me misër që ngjante si një pllakë tallashi. Për të sëmurët, shumica me TBC, kishte një 'favor', buka e grurit nuk zëvendësohej me misrin.

Triska kishin të drejtë të merrnin vetëm ata që ishin në punë shteti. Hamdiu, Selmani e shumë të tjerë jo. Po të hoqën nga puna, mbete pa triska, mbete pa bukë. Buka ishte apoteoza, ishte riti. Regjimi kishte në dorë bukën, pra kishte jetën. E merrte atë e ta hidhte në fermë si punëtor, pavarësisht se ti ishe agronom, ta hidhte në një qytet tjetër pa pyetur se kishe rrënjë aty ku ishe, ta hidhte në kantier si punëtor pavarësisht se ishe inxhinier, ta hidhte ku të donte ti shkoje nga prapa. Rrugë tjetër nuk kishte, ndryshe quheshe 'parazit'.

Ishte edhe triska e qumështit. Jepej për fëmijë dhe për të sëmurë. Qumështi shpërndahej vetëm në një dyqan për gjithë Tiranën, që ishte aty ku sot është bar "Guva" në rrugën këmbësore . Radha për burrat mbahej për një , dhe fillonte nga Teatri Popullor gati 150 m. Nga ana tjetër , ishin gratë, kurse në mes hynin pa radhë familjet e dëshmorëve. Në rradhë shumica ishim fëmijë që detyroheshim të rrinim me orë për 1 kg qumësht.

"Radhë, radhë, radhë - refren i përditshëm i jetës", - siç shkruan kolegu im Kolevica.

Dyqani i bukës i lagjes sonë ishte në rrugën e Kavajës, pranë Ministrisë së punës sot. Shkonim me shokun tim, Besnikun, drejt dyqanit kur na grishën disa shokë për të luajtur në fushën e Shallvares. Mbas loje u drejtuam drejt dyqanit, por Besniku nuk po gjente triskat. Kërkuam në pantallona e triko që i kishim vënë si porta, por ato ishin zhdukur. Ku të shkonim? Besniku, një djalë i gjatë e i hollë me ballë të gjerë, rreth 12 vjeç, u zverdh i tëri. Qukat që kishte në fytyrë i kuqëlonin më shumë.

Çfarë do t'i them tani babës? Për fat, ishte fund muaji. U mblodhëm shokët, e me lejen e prindërve, i dhamë nga një triskë për familje. Shkuam të gjithë te shtëpia e tij, buzë Lanës së vjetër dhe i shpjeguam babait të Besnikut se si ishte puna. Mbasi bisedoi me prindërit tonë u bind. Ishte besimtar. "Zoti ju bekoftë!", na tha.

Fëmijë që u rritëm në radhë, fëmijë që u rritëm me triska. Por, nuk mjaftonin triskat e nevojave të përditshme. Kishte edhe triska të tjera ideologjike, si e Frontit, e Rinise dhe e Partisë. Triska e Frontit e dalë nga Konferenca e Pezës që predikonte bashkimin e popullit, nuk u jepej të gjithëve. Atë e jepte këshilli i lagjes. Ke qenë tregtar, nuk e merr; ke qenë në burg, jo e jo. Mirëpo, triskat ishin të lidhura zinxhir me njëra-tjetrën. A e ke triskën e Frontit? - Jo! Atëherë të pret vetëm puna e krahut, ndryshe nuk merr triskat e ushqimit.

Pastaj duke u rritur vinte triska e Rinisë. Familja që nuk ka triskën e Frontit nuk merr atë të Rinisë.

Thotë Xhorxh Uruell te libri "Ferma e kafshëve": "Të gjitha kafshët janë të barabarta , por disa kafshë , janë më të barabarta se të tjerat".

Këta më të barabartët sundonin në emër të barazisë, që për këtë barazi nga fillimi i viteve '80 triskat i zëvendësuan me tullona.

Tiranë, 8 janar 2017

Dr. Orhan Sakiqi, ish-këshilltar, kryetar i këshillit Bashkiak të Tiranës, anëtar i "Këshillit të të Urtëve" në Shoqatën "Bashkësia Dibrane"

Nekrologji

Ndahet nga jeta biznesmeni i familjes Doçi të Lurës, **Preng Llesh Doçi**



Më 6 shkurt të vitit 2017 u nda nga jeta njeri nga shokët më të mirë të Gjeologjisë së Tiranës, biznesmeni i familjes Doçi të Lurës, Preng Llesh Doçi. Me ndarjen nga jeta të Prengës familja Doçi, humbi njeriun më të shtrenjtë të familjes së tyre, kushurinjtë, të afërmit, miqtë e shokët e punës humbën kushuririn, mikun e shokun e tyre më të mirë, Preng Llesh Doçin.

Prenga lindi në lagjen Sumaj të Arrmollës së Lurës në familjen Doçi të Lurës. Rrjedh nga një familje e fis me zë për zgjuarsi, veprimtari të herëshme patriotike, besë e bujari në krahinën e Lurës, Dibrës e Mirditës, nga fisi Doçi i Lurës. Historia e këtij fisi fillon me Llesh Nikoll Doçin e "300 duvakëve" të Lurës që mposhti e sfidoi hordhinë turke në Fushë të Kastriotit me 300 djemtë e rinj të Lurës të hypur mbi kuaj, të armatosur e të mbuluar me duvakë si nuse, betejë të cilën populli e përjetësoi në këngë :

"Llesh Nikoll Doçi i tha Sulltanit,
Nusja u nis por çoi fjalë dhëndërrit...
... Vesh si nuse janë 300 burra.
Për tek Pasha i ka nis Lura...
... Prej duvakëve rruga skuqet,
Dil or pashë e priti nuset...
...Jam Llesh Doçi djal Bajraku,
Erë baruti ka duvaku,
300 nuse e 300 krushq ,
Kanë la në gjak mbi 1000 turq"

Nga ky trung kanë dhënë jetën Kol Bib Doçi kundër ushtrisë austriake, Dod Doçi e Zyber Doçi në vitet 1916,1917 dhe heroi i popullit Gjok Doçi në vitin 1944 në luftë për çlirimin e vendit. Në këto troje e kushte duke ndjekur gjurmët e të parëve lindi edhe mësuesi i urtë e patriot, pushtetari trim e i zgjuar, punëtori i palodhur, figura fisnike e Lurës, Dibrës dhe Mirditës, Llesh Zef Doçi, i cili me zgjuarësi e burrëri qëndroi në këmbë e i palëkundur duke punuar me devotshmëri e duke sfiduar furtunat e sistemit të kaluar. Në këto kushte e troje kryetari i kësaj familje të madhe rriti dhe edukoi djemtë e tij, Gjetën, Prengën, Dodën, Dedën e Gjonin të cilët ecën në gjurmët e prindërve të tyre.

Prenga, arsimin fillor e 7 vjeçar i kreu në vendlindje, në Arrmollë të Lurës. Shkollën e mesme e kreu për markshejderi në Teknikumin e minjerave e të Gjeologjisë në Prrenjas të Librazhdit, me rezultate shumë të mira. Pas mbarimit të shkollës së mesme filloi shkollën e lartë në Fakultetin e Gjeologjisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, të cilin e ndërpreu në vitin e dytë për arësye se filloi punë në Gjeologjinë e Tiranës për të mbajtur e arsimuar vëllezërit e tij më të vegjël që kishin filluar punën që fëmijë në Hidrocentralet që ndërtoheshin në veri të vendit. Kështu Prenga sapo mori shtëpi nga gjeologjia në Kodër Kamëz, tërhoqi në Tiranë tre vëllezërit më të vegjël, Dodën, Dedën e Gjonin të cilët i strehoi në shtëpinë e tij të vogël 1 dhomë e një guzhinë ku jetonin bashkë me bashkëshorten Lezen e fëmijët e tij të vegjël, duke i ndihmuar deri sa mbaruan arsimin e lartë.

Në gjeologjinë e Tiranës Prenga ishte një nga topografët më të mirë të grupit të topografisë së kësaj ndërmarje ku ka punuar në ekipet më të vështirë si, në Gjazuj e Kthellë të Mirditës, Shebenik e Babje të Librazhdit, Polis e Shpat të Elbasanit, etj. Kudo ku punoi ai u dallua për punë me devotshmëri e cilësi të lartë. Ai me punën e sjelljet e tij fitoi respektin e ndërmarjes dhe kolegëve me të cilët punoi deri kur doli në pension të parakohshëm në vitin 1992. Ai si pasardhës i një familje arsimdashëse e patriotike, që kur ishte në punë në ekipe mbante me vehte "Lahutën e Malësisë" të Gjergj Fishtës, duke arritur të recitonte përmendësh pjesën më të madhe të vargjeve të kësaj kryevepre të të madhit Fishta.

Në fillimet e viteve të demokracisë vëllezërit Doçi, me ne krye Prengën e Dodën, me inisiativën e Dodës që kreu edhe një trajnim në fushën e ndërtimit në Danimarkë, krijuan kompaninë e ndërtimit "Lura" e cila nga viti në vit e shtoi aktivitetin e saj në fushën e ndërtimit të banesave, rrugëve, urave , tuneleve e objekteve të tjera ndërtimore. Në vitin 1996 kjo kompani filloi ndërtimin e kompleksit turistik "Lura 1" në gjirin e Lalzit dhe tani vazhdon ndërtimin e kopleksit turistik "Lura 2".

Prenga ka qenë edhe aktivist i dalluar shoqëror në ndihmë të aktiviteteve të shoqërive civile. Ai ka qenë anëtar i Komisionit organizativ të Kuvendit Tekniko Shkencor të Rrugës së Arbërit të organizuar nga Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" në maj të vitit 1997, ku kompania "Lura" sponsorizoi edhe një pjesë të këtij aktiviteti.

Djemtë e Llesh Zef Doçit, pavarësisht se u stabilizuan në Tiranë, nuk e harrojnë vendlindjen e tyre dhe paraardhësve të tyre, ato sytë dhe mendjen vazhdojnë t'i kenë nga Lura. Kështu u krijua shoqëria "Erdat" Shp.k. me drejtues Preng Doçin e cila në baashkëpunim me një shoqëri italjane në 6 mujorin e parë të vitit 2012 përfunduan dhe vunë në funksionim tre hidrocentrale , "Lura 1, 2 e 3" me fuqi energjitike 17 MW që i japin energji jo vetëm Lurës por janë të lidhur edhe me sistemin energjitik unik të Republikës.

Me ndarjen e parakohëshme nga jeta të Prengës, në kohën kur kishte akoma mundësi për t'i dhënë familjes e shoqërisë, familja e të afërmit humën njeriun e tyre më të shtrenjtë e të dashur, ndërsa shoqëria biznesmenin dhe njerin nga shokët më të mirë të tyre.

Bashkim Lleshi

Tiranë 20 shkurt 2017

Iku Mentori i Zeralinjëve të Dibrës...



Në kujtim të një dibrani, një njeriu që i dha Dibrës dashurinë, i dha Atdheut përkushtimin e intelektualit dhe shpirtin praktik të specialistit...Në kujtim të inxhinier Mentor Zeraliut, profesorit të Universitetit të Tiranës dhe drejtorit të një prej ndërmarrjeve më të mëdha të kohës së tij, NSHRAKU-t të Tiranës.

Në kujtim të një njeriu që është pak, shumë pak, për ti dhënë titullin "Mjeshtër i Madh"

Mentor Zeraliu iku i përcjellë nga njerëz që e donin dhe e nderonin, nga familja e tij e mrekullueshme, nga shokët dhe kolegët, nga ata që e deshën dhe i deshi...Në kujtim e në vlerë të tij po përcjell bisedën që kam bërë më se një vit më parë...

Në nëntor 2016 e lamë që të bëjmë një bisedë të dytë për vëllain e tij, Besnikun e Zeralinjëve, partizan i Brigadës së Parë, pedagog i Universitetit të Tiranës, një ndër pionierët e elektrifikimit të Shqipërisë...

Më vjen keq që nuk munda ta fiksoj në diktofon zërin dhe kujtesën e tij në 95 vjetët e jetës së tij. Mbase ka shkruar diçka, megjithëse sytë i ishin lodhur...

I qoftë i lehtë dheu i Tiranës...
Abdurahim dhe Natasha Ashiku

Athinë, 20 shkurt 2017

Një bisedë me Mentor Zeraliun mund ta lexoni ne linkun e mëposhtëm:http://rrugaearberit.com/2016/11/20/mentori-i-zeralinjve-te-dibres/



Dita e Verës

Nga **ALBAN TUFA**

Dita e Verës është një festë me origjinë të lashtë. Kjo festë konsiderohet si arbëreshe dhe në thelbin e vet, pagane. Festimi kryhet në nderim të tokës dhe natyrës së bukur shqiptare, bimësisë që merr jetë në këtë këtë periudhë kohore, pas një dimri të fortë dhe të acartë . Tashmë kjo festë është bërë edhe ditë kombëtare pushimi, duke i dhënë kështu rëndësinë dhe hapsirën e duhur. Shqipëria, ndalet dhe feston ardhjen e pranverës.

"Është dita në të cilën stërgjyshit tanë, kur skish lindur edhe krishterimi, kremtonin bashkë me romakët dhe me grekët e vjetër, perënditë e lulevet, të shlegjevet. Kur shkrin dimri, kur qaset vera buzëqeshur, e hollë dhe e gjatë si në pikturë të Boticelit, zemra e njeriut shkarkohet nga një barrë, shijon një qetësi, një lumtëri të ëmbël. Në këtë gëzim, stërgjyshërit tanë ndienin një detyrë t'u falën perëndivet që sjellin këto mirësira. Dhe ashtu leu festa hiroshe që e quajnë Dita e Verës. Në pakë ditë në Shqipëri, besnikët e fundmë të paganizmit, besnikët pa dashur dhe pa ditur, do të rrethojnë me verore degët e thanave, të dëllinjavet, të dafinavet, të gjitha shelgjevet të nderuara. Do të këputin degë të gjelbra dhe do t'i vënë përmbi kryet e shtëpivet. Të mos i lëmë të humbasin këto festa të vjetra të racës sonë. Nuk i bëjnë dëm njeriut. Sjellin një gëzim të kulluar në shtëpi. Një vend ku jeta e të vegjëlvet është aq e trishtuar, djelmuria dhe vajzat kanë një rasë të rrallë për të dëfryer. Për të mëdhenjtë, Dita e Verës ka një shije poetike të hollë e të rrallë." Kështu shkruante dikur Faik Konica mbi Ditën e Verës.

Ndërsa at Berdardin Palaj më vonë, për Ditën e Verës në zonat e veriut, shkruante: "Shtëpi më shtëpi në ditët e veravet, pjesëtarët e familjes bashkoheshin rreth zjarrit për me lidhë shtrigat, mgjillcat, llungjat, rrollcat e të gjitha shtazët dëmtuese : gjarprin mos ti nxajë, lepurin mos t'u hajë loknat e bathën, e shpendin emën për emën e krimbat e tokës mos t'u mbajnë dam ndër ara. Tri ditë përpara veravet duhet me mshefë shoshat, sitat, furkat e me çartë krojet, në mënyrë që mos me i pamë këto sende asnjë rob i shtëpisë, pse për ndryshej nuk lidhet gja. Këto ditët e veravet bijnë gjithmonë ndër ditët e para të marsit. Mbas darkë, të gjithë pjesëtarët e shtëpisë bashkohen rreth zjarmit. I zoti i shtëpisë merr një pe të zi leshi, e lidhë për vergue një nyje e thotë këto fjalë. Lidhe Zot nata e mojt e dita e verave! Unë pak e Zoti shum ! Po lidhim shtringat. Kështu përsërit këtë veprim për secilin shpirt damtues, sëmundje, krimba e kodra që don me lidhë".

Ndërsa në Dibër, Dita e Verës, fillon që me fundin e shkurtit. Këto kohë zakonisht bora fillon të shkrijë dhe natyra transformohet në ngjyra të ndryshme. Ditën e verës në fundin e shkurtit e nisin fëmijët, ata të një moshe relativisht të madhe duke nisur nga 15 deri në 20-vjeç. Kështu, ata zgjohen herët pa zbardhur, mblidhen në qendra të fshatrave dhe luajnë lojra nga më të ndryshmet: kryesisht kukafshehti deri me të gdhirë. Pasi dita vjen, ata ndërrojnë lojë, ku më e preferuara është Kalaja dibrançe. Vjen nje çast kur dielli del dhe ata ose i kthehen shkollës, ose ndonjë pune që sugjeron kjo kohë. Në Dibër nëse do, merresh me diçka kur toka është e zezë.

Këta fëmijë i japin gjallnimin e munguar gjatë muajve të dimrit, tashmë dhe natën. Ndaj të gdhirë, të gjithë të ndarë në grupe tre-katër vetë vërshojnë në fshat dhe mbyllin nga jashtë dyert e pahapura, portat e avllive me tela e litarë. Mandej jo rrall herë dëgjon zëra burrash që bërtasin, të tjerë që rreken të hapin dyert.

Ndërsa tek vajzat ekziston një mënyre tjetër dallimi i ardhjes së kësaj feste. Ato vihen vetiu në një garë se cila do dalë para në krua, pasta cila është e para që fshin rrugicën e saj. Ajo që del e para është me zonja, më fismja, ndërsa ajo e fundmja vetkuptohet që konsiderohet më pazonja, më gjumashja.

Kjo lloj kulture iu është kultivuar nga nënët dhe kryesisht gjyshet e tyre. "Nëse të gjen Dita e Verës në gjumë, atëherë e gjithë vera ka me të shkue përgjumësh.", mbaj mend t'i thote ime më motrës. Këtë do ia kish thënë dhe gjyshja asaj kur do ketë qenë e re.

Kështu hyjnë ditët e para të marsit. Ritualet janë thuajse të njëjta. Natyra gjallon kudo, me të gjallon dhe jeta e shtatit pas një gjumi thuajse letargjik. Në rastet e një dëbore të harruar që vetëm prish punë dhe bëhet pasojë për çdo vonesë në punët e fshatit Dita e Verës vjen më e plogësht, për të mos thënë se nuk ndjehet, pavarësit imitimeve e sajimeve që mundohen dibranët t'i bëjnë.

Trembëdhjeta e marsit i gjen shtëpitë me nga një mullarth dëllinjash përpara në oborr, ose goma makine të ruajtura nga fëmijët: në rastin më të mirë në lëmat e fshatit, ku lagjeja ose fshati gëzojnë një harmoni të trashëguar. Këtë e quajmë vëllallëk. Familjet maten me njëra tjetrën, se cila e bën zjarrin më të madh. Kjo ndodh edhe mes lagjesh e fshatrash. Tënxheret janë me vezë të ziera: herë me gjethe qepe, herë me çaj mali, ku marrin një njyrë thuajse të kuqërremtë. Të gjitha gatitjet i duhen mbrëmjes.

Pas muzgut, kur dielli zhytet poshtë në Vargmalet e Lurës, dëllinjat ndizen, gomat marrin flakë e rretherrotull tyre familijarët qëndronë buzqeshur sepse aty "rruhen" (zihen) vezët. Kush ia thyen tjetrit ia merr. Mandej dikush nën dritën e flakëve këndon: Zjarrmi jonë fishek baruti, zjarrmi atyne si grumbull m**ti. Kjo këngë këndohet mbi naltësinë e flakëve. Shkëmbehen aty për aty vizita te zjarret e njëri-tjetrit. Rruhen vezët. Humbet. Fitohet. Komentohen zjarret rrotull dhe bëhet një agjendë për të nesërmen, sepse ajo është has Dita e Verës. Pastaj konsumohen ushqime tipike, të tilla si petulla, flì, kuleçë me sheqer, pulë me jufka dhe llageja.

Me të dalë drita e parë, vajzat si gjithnjë janë zgjuar të parat. Rrugët ndrijnë nga pastërtia dhe janë të spërkatura me ujë. Pastaj ato mbidhen në grupe të vegjël dhe iu këndojnë atyre vajzave që nuk janë zgjuar akoma: "Ka ra dielli o kep e m'kep, kjo filanja akoma n'dyshek.".

Pastaj siç janë nisen e mbledhin lulet e dit'veres dhe i vendosim mbi dyer e porta. Kthejnë shpejt dhe i vendosin lulet aty mbi porta e mbi dyer. Punët i kanë bërë herët e janë gati të shkojnë në lëmë e të luajnë.

Lëma është gjithëherë e mbushur me fëmijë të moshave të ndryshme. Të vegjlit i kanë mbush qeset me ushqime tipike për Ditën e Verës. Kjo gjë është thuajse piknik. Luajnë të gjitha lojrat, të gjitha moshat. Nuk mungojnë ngacmimet e vajzave nga ndjemtë, në më të rrallë dhe e anasjellta. Shumica i konsiderojnë motra, por një pjesë nuk e bëjnë këtë dhe kjo shëndërrohet në një fushëbetejë dashuriçkash.

Në qoshe të lëmës kanë ardhë edhe të panjohur. Janë miq, nipër në fshat por edhe të tjerë nga fshatrat rrotull. Aty kanë ardhë të shofin ndonjë cucë për nuse: atë më të urtën, më të pjekmen, atë që dëfton karakter. Në një rast ndryshe, ia kanë sugjeruar të afërm dhe tashmë ky është çasti më duhur për ta pas nën vrojtim. Në këto lëma kanë lind martesa dhe dashuri sa të harruara, sa të kurorëzuara. Gjithçka e filluar si lojë, çel të tjera degë sikur çelin degët e reja të pemëve. Dreka vjen, herë ndihet e herë jo.

"Nuk rri saçi pa u djegë për Dit'vere" thoshte imja gjyshe. Nënkuptonte se duhej gatuar një fli ose një petë. Kjo e karakterizon drekën e Ditës së Verës, e më të rrallë petulla malësie ose të ardhme.

Mbrëmja qaset shpejt. Dielli ikën e hëna vjen. Me ardhjen e hënës thonë që fillojnë edhe punën plakat e veja. Ato shpirtligat. Fillojnë punën ato që merren me qoftëlargun. "Duhet me u prujt për Dit'vere", këshillojnë plakat tona, sepse "ato" këtë natë presin. Magjia e zezë dhe e bardhë i atribuohet më së tepërmi kësaj nate, ku paramendohet se është më i madh efekti. Këtë mund ta lidhim me thelbin pagan të kësaj feste, duke mos pas një shpjegim më të qartë. Megjithatë Dita e Verës në Dibër është ndër festat që shijonjë më së shumti fëmijë.



Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për këtë website: **info@rrugaearberit.com**
Informacioni për gazetën: **rrugaearberit@gmail.com**
Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.
Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës.
Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky website është komplet një kontribut (donacion) në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

© Copyright Rrugaearberit.com & Gazeta "Rruga e Arbërit". Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.